

Republika e Shqipërisë

Gjykata e RRETHIT GJYQËSOR TIRANE

Nr.1862 REGJ.THEM.

NR.2900 vendimi

VENDIM

“Në EMër Të rEPUBLIKës”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë prej :

GJYQATAR -ARTAN GJERMËNI

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ornela Balla**, në Tirane, sot me datë **18.12.2019** mori në shqyrtim ne seancë gjyqësore publike, me gjykim të zakonshëm, çështjen penale me: **KËRKUESE**:Prokuroria pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane e perfaqësuar nga prokuroret **Genci Qana** dhe **Kolë Hysenaj**.

NDAJ TË PANDEHURËVE:

Albert Veliu, i biri i Eqerem dhe Abe, i dtl. 19.01.1967, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Lagjia “4 Heronjtë”, Rruga: “Isa Boletini”, Pall.1004, Shk. I, Kat. II-të, Vlorë, me arsim 10 klasë, i martuar, me dy fëmijë, hetuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg” në mungesë, i deklaruar në mungesë ne gjykim (i ikur) i mbrojtur nga mbrojtësja e caktuar kryesisht **Elona Ullorja**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale “**Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror**” dhe “**Kallzimi i rremë**” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 297, 305 e 25 të K.Penal .

Fredi Alizoti, i biri i Elmaz dhe i Ildize, i dtl.13.04.1973, lindur dhe banues në Fier, Lagjia “1 Maji”, i divorcuar, me arsim 8-vjeçar, i pranishëm ne gjykim, i hetuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg”, i mbrojtur nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij **Ilir Dode**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “**Kallzimi i rremë**” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Jetmir Oлдashi, i biri i Tahir dhe i Fatime, i dtl. 30.05.1981, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Mikel Maruli”, i padënuar, i divorcuar, me arsim të lartë, hetuar me masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, i deklaruar në mungesë në gjykim, përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur **Indrit Sefa**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “**Kallzimi i rremë**” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Ervin Salianji, i biri i Bujar dhe Shegë, i dtl. 16.01.1988, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Asim Vokshi”, i padënuar, me arsim të lartë, hetuar në gjendje të lirë, i mbrojtur nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij **Ledio Braho**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “**Kallzimi i rremë**” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

VIKTIMA/KALLËZUES: **Geron (Agron) Xhafaj**, i biri i Seza dhe Elpiniqi, i dtl.

08.06.1975, lindur e banues në Vlorë, Lagjia: “Isa Boletini”, Rruga “Mehmet Petoshati”, Nd. 45, H. 3, Apt. 32, në mungesë, i përfaqësuar nga Av.Ardian Visha dhe Av.Arben Prenga (sipas Prokurës Nr. 2554 Rep., Nr. 717 Kol., dt. 15.05.2018).

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve dhe mori provat e nevojshme, dëgjoi përfundimisht palët që kërkuan:

Perfaqësuesit e Prokurorisë kërkuan:

1-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Albert Veliu** për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale “**Kallzimi i rremë**”, parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.

Deklarimin fajtor të pandehurit **Albert Veliu** për kryerjen e veprës penale “**Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror**”, parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.

Duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 55 të Kodit Penal për caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e të pandehurit **Albert Veliu**, me 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Albert Veliu**, të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

2-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fredi Alizoti**, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale “**Kallzimi i rremë**”, parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Fredi Alizoti**, të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

3-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervin Salianji**, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale “**Kallzimi i rremë**”, parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim**.

Në lidhje me këtë të pandehur, prokurori Genci Qana ndryshe nga prokurori Kolë Hysenaj kërkoi që në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, të bëhet pezullimi i ekzekutimit të vendimit për një periudhë 3 (tre) vjeçare, duke urdhëruar të pandehurin që të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

4-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Jetmir Oлдashi**, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale “**Kallzimi i rremë**”, parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.

Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i pandehuri Jetmir Oлдashi të përmbushë një punë në interes publik, për një kohë prej 200 (dyqind) orë.

5-Bazuar në nenin 190, pika 1, gërma “ç”, të K.Pr.Penale, një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637 dhe një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091, t’i kthehen të pandehurit Fredi Alizoti.

6- Shpenzimet procedurale në shumën prej 50000 lekë dhe 13547 GBP (paund britanik), të kryera gjatë hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore në masën që do të përcaktohen nga Gjykata, t’i ngarkohen solidarisht të pandehurve.

Mbrojtësja e të pandehurit Albert Veliu kërkoi:Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Albert Veliu.

Mbrojtësi i të pandehurit Fredi Alizoti kërkoi:Denim me të ulët.

Mbrojtësi i të pandehurit Jetmir Oлдashi kërkoi: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, pasi fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si veprë penale bazuar në nenin 388/1(a,c).

Mbrojtësi i të pandehurit Ervin Salianji kërkoi: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, pasi fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si veprë penale bazuar në nenin 388/1(a,c).

I pandehuri Ervin Salianji kërkoi:Deklarimin e pafajshëm.

Gjykata, pasi dëgjoi pretendimet e palëve në seancë gjyqësore dhe si shqyrtoi në tërësi provat e marra në gjykim në lidhje me çështjen,

VËRËN:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën për gjykimin e çështje penale në ngarkim të të pandehurit Albert Veliu i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, dhe “Kallzimi i rremë i kryer në bashkëpunim” të parashikuara nga nenet 297, 305 e 25 të K.Penal, si dhe në ngarkim të të

pandehurve Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñji, të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Kallzimi i rremë i kryer në bashkëpunim" të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Me Vendimin Nr.1940 Regj.Them. ,datë 12.04.2019, gjyqtari i seancës paraprake, pasi është njohur me kërkesën për gjykim dhe aktet e dosjes së këtij procedimi penal, ka disponuar për dërgimin për gjykim të çështjes penale objekt trajtimi gjyqësor.

Gjykata konstatoi se në seancën paraprake, i pandehuri **Fredi Alizoti** dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij Av.**Ilir Doda** kanë parashtruar kërkesën për të proceduar me gjykim të shkurtuar të çështjes penale në respektim të nenit 403/1 të Kodit të Procedurës Penale.
Përpara çeljes së shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, i pandehuri i pranishëm konfirmoi para kësaj Gjykate qëndrimin e tij për të vijuar me gjykim të shkurtuar të çështjes duke u lëvruar edhe vecimi i çështjes.

Gjykata me vendim e saj të ndërmjetëm të datës 12.06.2019 në zbatim të neneve 93 e 405 të K.Pr.Penale disponoi të mos e panojë kete kerkese, duke vlerësuar se çështja në ngarkim të të pandehurit Fredi Alizoti nuk mund të zgjidhet në gjendjen e ndodhur të akteve në dosje, për shkak se gjykimi penal zhvillohet ndaj disa të pandehurve, ku pjesa tjetër nuk e kanë parashtruar këtë kërkesë dhe akuzat për kryerjen e veprës penale "Kallzimi i rremë" është e cilesuar me elementin e kryerjes në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal për të gjithë të pandehurit (pengese ligjore kjo e specifikuar në nenin 93/c të K.Pr.Penale) dhe ndarja e çështjes do të sillte një dëm hetimit gjyqësor si dhe vertetimit të fakteve objekt gjykimi.

Referuar shqyrtimit gjyqësor, rrethanat e faktit të çështjes lidhur me këtë procedim penal kanë rezultuar si vijon:

Në datën 14.05.2018, rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrisë të Brendshme të kohës).

Publikimi është bërë nga i pandehuri Ervin Saliñji dhe shtetasi Enkelejd Alibeaj në cilësinë e deputetit, si dhe shtetasi Gazmend Bardhi në cilësinë e funksionarit të PD-së. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambivalent dhe i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si "Bashkëpunëtori X", i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim "audio" të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar "Bashkëpunëtori X" dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim "video" prej 6 sek. që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat "Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrisë të Brendshme, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë".

Mbi bazën e këtij publikimi, në datën 17.05.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka regjistruar Procedimin penal Nr. 95, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal dhe hetimet e mëtejshme në kuadër të këtij procedimi nuk lokalizuan ndonjë të dhënë apo indicie inkriminuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñji, në bashkëpunim me njëri tjetrin dhe nisur nga motive personale të ndryshme, kanë krijuar një provë të rreme në formën e një "audio-regjistrimi", me qëllim ngritjen e një dyshimi se nga shtetasi Geron (Agron) Xhafaj, ishte konsumuar një veprë penale në fushën e narkotikëve. Rreth muajit Tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë takim me të pandehurin Ervin Saliñji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike. Në këtë takim, i pandehuri Albert Veliu i ka bërë të ditur të pandehurit Ervin Saliñji se donte të çonte në burg shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, pasi kishte një inat të mëparshëm me të, për shkak të një qëndrimi në burg në Itali. Ai është vetëofruar dhe ka garantuar, se kishte mundësinë që të grumbulloste të dhëna kompromentuese për aktivitetin kriminal në fushën e narkotikëve që shtetasi Geron (Agron) Xhafaj, ushtronte në rrethin e Vlorës. Në bisedë midis tyre, i pandehuri Ervin Saliñji i ka premtuar të pandehurit Albert Veliu se do të përfitonte një shpërblyem në vlerë prej 200 mijë eurosh, në rast se do të sillte të dhënat që inkriminonin shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në vijim, i pandehuri Ervin Saliñji ka mundësuar kontaktin midis të pandehurit Albert Veliu dhe të pandehurit Jetmir Olldashi, i cili në atë kohë punonte si gazetar investigativ tek emisioni "Të paeksponuarit" pranë televizionit "News 24".

Mbasi janë takuar me njëri tjetrin, të pandehurit Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi, kanë vendosur që të shkojnë në qytetin e Vlorës, me qëllim që të regjistronin shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe të shkonin në vendet ku ky i fundit mendohej se ushtronte aktivitetin kriminal. Në mëngjesin e datës 24.10.2017, të pandehurit Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi, janë nisur për në qytetin e Vlorës me një automjet që i pandehuri Jetmir e kishte marrë me qira dhe së bashku me ta ka qenë edhe dëshmitari Arnedo Selmanaj, si kameraman i emisionit investigativ "Të paeksponuarit". Mbasi kanë arritur në qytetin e Vlorës, i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek lokali në pronësi të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, por nuk ka mundur që t'a takojë dhe komunikojë me të, mbasi nuk ndodhej aty. Në vijim, ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë ecur me makinë në drejtim të fshatit Radhimë dhe Tragjas të rrethit Vlorë, për të marrë kontakt me personat që mund të dispononin lëndë narkotike dhe të kryenin filmimet e nevojshme. Me pas, ata janë rikthyer në qytetin e Vlorës dhe me gjithë përpjekjen e bëra, nuk kanë mundur që të kontaktojnë shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, apo të bëjnë ndonjë regjistrim bisede me të.

Nisur nga fakti që deri në atë kohë nuk kishte arritur që të realizonte ndonjë regjistrim me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, në datën 23.11.2017, rreth orës 16:00, i pandehuri Albert Veliu në marrëveshje me të pandehurin Ervin Saliñji, ka shkuar në zyrën e dëshmitarit Besim Hajdarmataj, me detyrë drejtues i Prokurorisë pranë Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Në këtë takim, i pandehuri Albert ka pretenduar se kishte informacione që në ditët e ardhshme do të trafikohej një sasi lëndë narkotike për në Itali dhe se personat që do të bënin trafikimin ishin punonjës policie si dhe shtetas Geron (Agron) Xhafaj, vëllai i Ministrisë të Brendshme të asaj kohe.

Në datën 24.11.2017, rreth orës 10:00, dëshmitari Besim Hajdarmataj ka mundësuar takimin në zyrën e tij, të të pandehurit Albert Veliu me dëshmitarët Albert Tuci dhe Eduard Martini, me detyrë punonjës të SHISH. Mandej punonjësit e SHISH-it kanë vijuar me procedurat duke e pajisur të pandehurin Albert Veliu, me një pajisje përgjimi në formën e një pulti automjeti.

Rreth orës 15:00'-15:30', të datës 24.11.2018, punonjësit e SHISH dhe i pandehuri Albert Veliu kanë arritur në qytetin e Vlorës, ku ky i fundit u ka shpjeguar se, me personat do të takohet tek lokali "2 Palmat". Mbas rreth gjysmë ore, i pandehuri Albert Veliu ka telefonuar punonjësit e SHISH-it me qëllim për t'u dhënë pajisjen përgjuese dhe në momentin e takimit u ka thënë se kishte takuar një person me emrin Agron, por pa u thënë mbiemrin. Ai gjithashtu u ka thënë se nuk e kishte përfunduar bisedën për trafikimin e narkotikëve pasi kishte lënë një takim ditën e nesërme me një shtetas të quajtur Ermal dhe për të kryer ndonjë regjistrim të mundshëm, punonjësit e SHISH-it i kanë lënë një tjetër mjet përgjimi të kamufluar si "usb". Ndërkohë që, e kanë porositur se në momentin që do merrte kontakt me Ermalin, t'i njoftonte për vendin dhe orën e takimit.

Në datën 25.11.2017, rreth orës së drekës i pandehuri Albert Veliu ka telefonuar punonjësit e SHISH-it dhe u ka kërkuar të shkonin në Vlorë. Mbasi është takuar me ta në rrugë tek "Lungomare", ai u ka shpjeguar se ishte takuar me Ermalin, por nuk kishte regjistruar bisedë me interes për çështjen, mbasi kishte patur edhe persona të tjerë në tavolinë. Ai u ka kërkuar dhjetë mijë lekë të reja për të ngrënë një drekë me Ermalin dhe aty të bënte edhe përgjimin e bisedës, por kjo kërkesë është refuzuar nga punonjësit e SHISH-it. Në vijim, i pandehuri Albert Veliu u ka kërkuar që të shkonin tek vendet ku mbahej hashashi apo mjetet, kërkesë që i është plotësuar nga punonjësit e SHISH-it. Komunikimi i të pandehurit Albert Veliu me punonjësit e SHISH ka vazhduar deri në datën 30.11.2017 dhe në përfundim të gjithë procedurës së kryer nuk rezultoi asnjë e dhënë inkriminuese (proceduriale apo informative) për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Në rrethanat kur nuk po mundte që të realizonte ndonjë regjistrim kompromentues me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të pandehurin Fredi Alizoti me të cilin kishte një njohje të vjetër dhe shumë miqësore. Në takimin midis tyre, i pandehuri Albert Veliu i ka kërkuar ndihmë të pandehurit Fredi Alizoti për të realizuar një regjistrim bisede midis tyre, ku ky i fundit do të luante rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, mbasi do të shpërbleheshin në shumën prej 200 mijë eurosh nga i pandehuri Ervin Saliñji. Përveç përfitimit material, i pandehuri Albert Veliu dhe familja e tij do të përfitonin edhe përfitimin e azilit politik në ndonjë shtet.

Fillimisht, i pandehuri Fredi Alizoti ka hezituar dhe nuk ka pranuar që të kryejë veprimin e kërkuar, por pas disa ditësh ai ka rënë dakort, i ndikuar nga këmbëngulja e të pandehurit Albert Veliu si dhe joshja nga përfitimi financiar në shumën prej 100 mijë eurosh (gjysma e shumës prej 200 mijë eurosh) që ai do të kishte. Të dy të pandehurit kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin Janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar i tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu j'a ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliñji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Publikimi i "audio-regjistrimit" të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018, nga i pandehuri Ervin Saliñji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkelejd Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambivalent dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, është vazhduar me një regjistrim "audio" të një bisede ambientale të

realizuar nga i pandehuri Albert Veliu në rolin e "Bashkëpunëtori X" dhe i pandehuri Fredi Alizoti në rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, duke imituar zërin e këtij të fundit. Në fund, materiali i fabrikuar pason me një regjistrim "video" prej 6 sek, që tregonte pamje të një truge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat "Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë". Publikimi i materialit solli më pas edhe regjistrimin e një procedimi penal dhe kryerjen e hetimeve nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, të cilat në përfundim të tyre rezultuan pa ndonjë implikim për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj duke pasqyruar edhe pushimin e çështjes penale sipas vendimit nr 53 date 12.4.2019, te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane

Në zbatim të planit të mëparshëm të tij, në datën 24.05.2018 i pandehuri Albert Veliu është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë duke kaluar në territorin e Republikës së Kosovës, jashtë vendeve të përcaktuara për kalimin e kufirit shtetëror. Në datën 28.05.2018, ai është paraqitur në policinë e Republikës së Kosovës dhe në datën 29.05.2018, ka kërkuar azil pranë zyrës përkatëse. Në vijim, mbasi është pajisur me certifikatën e statusit të azilkerkuesit me nr.1311, është lënë i lirë nga policia dhe aktualisht ndodhet i arrestuar nga autoritetet e Mbretërisë së Belgjikës, duke i'u nënshtruar procedurave të ekstradimit.

Sa më sipër, u provua në gjykimin e çështjes me provat e specifikuara më poshtë të paraqitura nga organi i akuzës dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, pjesë e fashikullit të gjykimin, ku theksohen dhe analizohen në fuqinë e tyre provues si vijon:

-Procesverbali për kryerjen e kqyrjes dt.14.05.2018, me anë të të cilit dokumentohet publikimi i materialit në daljen publike të dëshmitarëve Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi, si dhe të pandehurit Ervin Saliqij;

-Procesverbali për sekuestrimin e sendit dt.15.05.2018, me anë të të cilit dokumentohet fakti se shtetasit Enkeled Alibeaj i është sekuestruar një "DVD" në të cilën është i regjistruar materiali i publikuar në daljen publike të datës 14.05.2018;

-Procesverbal për sekuestrimin e sendeve dt.06.10.2018, me anë të të cilit dokumentohet fakti se të pandehurit Fredi Alizoti, i janë sekuestruar një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637 dhe një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091.

-Procesverbali për marrjen e dokumentit dt.15.05.2018, me anë të të cilit dokumentohet fakti se shtetasit Geron (Agron) Xhafaj i është marrë me cilësinë e dokumentit një regjistrimi "video" që ndodhet tek një "USB" e markës "VERBATIM", në një "folder" në formatin "MP4", i emërtuar (Deklarate PD).

-Procesverbali për marrjen e dokumentave dt.23.05.2018, me anë të të cilit është marrë në cilësinë e dokumentit një fotokopje e "Kontratë qiraje autoveturë", e datës 23.10.2017, me palë "qirramaës" të pandehurin Jetmir Olldashi dhe "qirradhënës" Iris Jaupaj dhe objekt dhënien me qira të automjetit me targë AA 283 SD. Pikërisht ky është automjeti, me të cilin të pandehurit Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi, së bashku edhe me dëshmitarin Arnedo Selmanaj, kanë udhëtuar për në Vlorë, në datën 24.10.2017.

-Procesverbali për këqyrjen e sistemit TIMS dt.05.10.2018, nga ku dokumentohet se dalja e fundit për të pandehurin Albert Veliu nga territori i Republikës së Shqipërisë ishte regjistruar në datë 28.09.2017 dhe nuk evidentohet ndonjë shënim për dalje të tij në datën 24.05.2018.

-Shkresa Nr.4857 Prot., datë 05.06.2018, e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, me anë të të cilës është përcjellë fotokopje e regjistrimit të shërbimit të sallës se komandimit të DVP Fier. Nga të dhënat e fletës rezultojnë se në datë 01.06.2018, ora 16.00', i pandehuri Fredi Alizoti ka telefonuar nga numri telefonik 0676494091 dhe komunikimet vazhdojnë edhe në orën 16.30' dhe 16.48'.

-Shkresa Nr.FRS/2094/ES, datë 21.05.2018, e shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë të gjithë numrat telefonikë të kësaj shoqërie dhe që janë përdorur nga abonenti Albert Veliu;

-Raporti (ekspertimi) mbi krahasimet shkencore të folësve dt.6/09/2018, në të cilin është ekspertuar materiali i publikuar në datën 14.05.2018, duke e krahasuar me modelet e zërit të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, si dhe shtetasve Geron (Agron) Xhafaj dhe Agron Hyseni. Ky Akt ekspertimi i shqyrtuar dhe administruar me cilësinë e provës ka konkluduar se:Regjistrimet nuk janë regjistrime origjinale. Regjistrimi video ishte marrë nga pamjet e mediave. Ajo përbëhej nga dy video, shkrim dhe dy biseda të regjistruara. Këto dy biseda janë fokusi i analizës së ekspertit. Nuk ka qenë në gjendje të marrë regjistrimet origjinale të këtyre bisedave.

Biseda e parë: Biseda e parë ndodh në minutën 1 e 4 sekonda të kohës së videos dhe zgjat për 14 sekonda. Ajo duket të jetë një pjesë e një thirrjeje telefonike dhe folësit janë emërtuar 'Bashkëpunëtori' dhe 'Agroni'; megjithatë, vetëm e folura që i atribuohet 'Bashkëpunëtorit' është e dëgjueshme (e kapshme) dhe për këtë arsye ekspertja ka ekzaminuar 'Bashkëpunëtorin' por jo 'Agronin' nga kjo bisedë.

Biseda e dytë: Regjistrimi i dytë, i cili është një bisedë e bërë ballë për ballë, ndodh në minutën 1 e 25 sekonda të kohës së videos. Ajo zgjat 1 minutë dhe 46 sekonda. Përsëri, ajo është një bisedë midis burrit të quajtur "Bashkëpunëtori" dhe "Agroni". Në këtë regjistrim e folura nga të dy palët është e dëgjueshme (e kapshme). Ndërsa shumica e bisedës është midis 'Agroni' dhe 'Bashkëpunëtorit' ka shenja (të dhëna) që në sfond është edhe zëri i një burri të tretë. Regjistrimi nuk e përmban bisedën e plotë. Nuk ka hapje të bisedës apo përsëritjeje, gjëra të cilat për dikë janë të pritshme, si fillim kur palët takohen. Biseda vetë, është shumë e shkurtër dhe gjithashtu shfaqen ndryshime shumë të papritura, sa i takon temave të bisedës. Dy janë shpjegimet e mundshme: a) regjistrimi është një pjesë/pjesë të mbledhura nga një regjistrim më i gjatë, ose b) vetëm një pjesë e bisedës është regjistruar.

- Gjendet mbështetje e fortë në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar "Bashkëpunëtori" në bisedën e parë është Albert Veliu;
- Gjendet mbështetje e fortë e moderuar në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar "Bashkëpunëtori" në bisedën e dytë në fjalë është Albert Veliu;
- Gjendet mbështetje e fortë në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar "Agroni" në bisedën e dytë në fjalë nuk është Agron Hyseni; Vërehen ndryshime të rëndësishme forensike midis zërit të 'Agroni' dhe atij të z. Hyseni.

Kampioni i bisedës në regjistrimin "Agroni" në bisedën e dytë, objekt ekspertimi, nuk është i përshtatshëm për të arritur në konkluzion (pozitiv ose negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj, Kampioni i ligjëratës (të folurit) në 'Agroni' nuk është i mjaftueshëm (adekuat) për të arritur në konkluzion (pozitiv apo negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj. Kampioni "Agroni" është i një cilësie shumë të dobët. Arsyetja pse ekspertja ishte në gjendje të arrinte në një konkluzion negativ për z. Hyseni në lidhje me atë, lidhje me faktin se ai dhe "Agroni" kishin shumë dukshëm zëra të ndryshëm. Kjo nuk ishte kështu në lidhje si me z. Alizoti ashtu edhe z. Xhafaj. Ata janë zëra të ngjashëm si me njëri tjetrin ashtu edhe me "Agroni", të paktën për sa ky i fundit mund të analizohet. Ekspertes do i duhej një regjistrim i një cilësie më të mirë të të folurës së "Agroni" për të arritur në një konkluzion (pozitiv ose negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj.

Sikurse vihet re, përfundimet e arritura në këtë ekspertim duke u parë në raport me deklaratimet e të pandehurit Fredi Alizoti dhe provat e tjera të marra gjatë këtij gjykimi e të analizuara gjatë këtyre konkluzioneve, tregojnë bindshem se zëri i subjektit "Agroni" nuk është zëri i shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

-Nga regjistrimet e përgjimeve të komunikimeve me telefon dhe transkriptet për numrat telefonikë 0698612599, 0695793764, 0695366327, 0696177770, 0685692692, 0695187565, 0676494091, 0692151212, 0694024321, 0697808251, 0685579637 dhe 0698621974, evidentohet se:

Në datë 18.05.2018, ora 13.13, përdoruesi i nr. të tel. 067 64 94 091 (i identifikuar më pas si i pandehuri Fredi Alizoti) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) dhe bëjnë këtë bisedë: 599- Alo, ore vella; 091-Ore ça po ben?; 599-Po ik o se jam ne prokurori mos mer o; 091- Eee?; 599- Hajd mos mer ne telefon vlla hajde.

Në datë 18.05.2018, ora 21.14, përdoruesi i nr. të tel. 067 64 94 091 (i identifikuar më pas si i pandehuri Fredi Alizoti) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) dhe veç të tjerash bëjnë edhe këtë bisedë: 091- po ato b...q...at do japin nai leke ata apo tja kthejme ndryshe ne?; 599- Ça thua e do i q...to motra prit te percjell dhe djalin o Fredi po me zien truri per djalin mua; 091- Ej – ore une te kam vella degjo mua, degjo mua, degjo nje minut le mua te mbaroj degjo mua; 599- He!?!; 091- Une nuk jam bukeshkale shpine time e ke hapur une ca te bej ty po une i qi e di ci bej atyre kurvave do japin nai leke apo jo une kaq po them; 599- Te percjelle njehere djalin e vogel pastaj flasim; 091 –Po te percjellim djalin se ja q... motren qe neser une; 599- Fredi nuk eshte muhabeti me te q... Fredi; 091-Jo jo ore; 599-Une nuk shkatërroj dy njerez qe kam lene lart ne fund te dynjase Fredi te kam vella te vejen ata ne ... pastaj flasim; 091- O vlla une te kam vlla dhe prape nuk e ve ne dyshim; 599- Atehere ca jane kto muhabetet; 091 – Jane muhabetet se ne e kupton vete ti;

Në datë 19.05.2018, ora 15.47, përdoruesi i nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 53 66 327 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 599- E flori ca ben ti? 327- Po rrimë po ngrohim veze; 599- Mire e motra e mora vesh qe po rri degjo se jam dhe me kte zoterine ktu une e mos kini merak fare se do behen te gjitha brenda dy diteve mbarojne e hotelin e pagojne kta neser mos kini merak. 327- Deri neser ne 12 e kam paguar une. 599- Na na fol njeçik vete me kte na fol vete (flet person tjetër jo poseduesi i numrit telefonik) Alo.....

Në datë 20.05.2018, ora 09.25, përdoruesi i nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 61 77 770 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 599- Ku do takojme pime nje kafe? 770- Te thashe dhe dje do te marim vete. 599- O vlla une jam ne mes te kater rrugeve ne rregull e skam çap mes te tani vllai jot se jam shume i stresuar dhe i lodhur ka dhe te tjere per lart e per poshte sdua te flas ne telefon ka mundesi te takohesh pak 5 minuta”.....

Në datë 20.05.2018, ora 09.37, përdoruesi i nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) i dërgon sms përdoruesit të nr. të tel. 069 20 85 947(i pandehuri Ervin Salianji) me këtë përmbajtje: Mirmengjes duet te me takosh patjetr.

Në datë 20.05.2018, ora 19.55, përdoruesi i nr. të tel. 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 53 66 327 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 692- E me thuaj se tani po ulem po flas me lart mos flas shume une tani ca te thane ata zoterinjtë aty? 327- Ata zotrinjte ishin ane shoqerore e juaja nga ana e atit tjetrit? 692- Po e atit shokut tim po shokut tim nga Vlora po vazhdo. 327- Bravo vetem njeri nga ata edhe erdhen dy edhe thane ne kemi si urdher qe ik e gjejnini nje shtepi nje muaj tha pastaj gjera te tjera jo. 692- Gjera te tjera sbejne asnje gje ata vetem shtepi nje muaj? Kaq te tha? 327-Po po pastaj ne nuk dime tha se as njeri as tjetri nuk na kane sqaruar asnje gje.....692-Ka dhene urdher dikush te vijne t'ju marrin t'ju sistemojne e te gjitha ça te duan kshu eshte puna. 327- T'ja them hapur atyre? 692- Po me kane derguar thuaj e di vete ti emrin E-ja me L-ne.. 327- Nuk e di Berti kush na ka shkruaje me mesazh. 692- L-ja eshte ai i madhi krushku im E-ja eshte ai poshte. 327- Shkruaje nje mesazh Ledios Ledio te na e shkruaj nje. 692- L si Luli jot shoqa jote. 327- Puna eshte kush duhet te flas une te flasnin ata gojarisht dhe ata te jene se une kur ica ika me urdher. 692-Mos fol shume ne telefon Luli me Ervinin kaq e di vete ai. 327-Kush? 692-Luli me Ervinin kaq.....

Në datë 22.05.2018, ora 17:01:51, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+692: Hajd te vendi vlla he hajde. +091: Ku në ç vend?”.

Në datë 22.05.2018, ora 21:09:57, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+692: O vlla ik te dhoma se po vimë ngavash ngavash aty se ktu jemi po presim ne edhe do vimë te dhoma te ...ik te hoteli ngavash ngavash. +091: E mirë hajd. +692: Hajde vlla...”.

Në datë 23.05.2018, ora 10:22:18, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 069 53 66 327 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+692: Sa të vi djali të veni direkt për azil politik. +327: Mirë mirë mirë. +692: Aty ambjenti mirë duket? +327: Mirë o Berti aman të keqen jemi brenda...”.

Në datë 24.05.2018, ora 19.35, përdoruesi i nr. të tel. 069 41 01 289 i dërgon sms përdoruesit të nr. të tel 067 64 94 091 me këtë përmbajtje: “Do të të marë mbas nja dy oresh se paska kalu deri ne maqedoni”

Në datë 22.05.2018, ora 17:01:51, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+692: Hajd te vendi vlla he hajde. +091: Ku në ç vend?”.

Në datë 27.05.2018, ora 21:17:08, përdoruesi i numrit telefonik 069 94 23 771 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+091: Ej po se, po s'fol me ty nuk flas me asnjëri në botë, dëgjo mua. +771: Po. +091: Më është afruar një gjë e mirë nga një pala tjetër e kupton tani muhabetin. +771: Po. +091: Janë të gjitha, unë i kam me... e ke parasysh?”.

Në datë 28.05.2018, ora 12.32, përdoruesi i nr. të tel. 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i nr. të tel. 068 20 29 700 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 700- Ej e more vesh? 091-He? 700-I arrestun ne Kosovo ato shokun tend me djalin.....

Në datë 28.05.2018, ora 19:42:36, përdoruesi i numrit telefonik 068 20 29 700 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+700: Ej nuk e kam problem unë se ky shoku jonë që ishte sot ky ky i vje keq pak. +091: O vllai i thashë, o Salë i thashë unë ca të jenë i thashë unë ndajme të tre, në rregull në rregull po pse t'i lëmë këshu imotrën. ai duhet ta ulë në tavolinë e di si është muhabeti t'ja jap me...e ke parasysh ti?”.

Në datë 29.05.2018, ora 17:17:22, përdoruesi i numrit telefonik 068 20 29 700 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+700: Edhe tha hajde tha, thuj Fredit hajd ta takojmë e të shkoj ta takoj vetë atë me dur të lidhje, ti thojmë o kshu o të fillojmë në krahin tjetër. +091: Po në rregull në rregull. +700: Më mirë kshu më mirë kshu tha Saliu, shkoj unë e takoj. +091: O vlla unë ju kam vllëzër e unë. +700: E di Fredi, Fredi jemi shokë ne jemi shokë po shko tako Saliu e shkoni, tako atë”.

Në datë 29.05.2018, ora 21:00:02, përdoruesi i numrit telefonik 069 20 62 000 (i rezultuar gjatë bisedës si shtetasi Erzen Breçani) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 (i rezultuar në tërësinë e bisedave të përgjuara si i pandehuri Fredi Alizoti) dhe, gjatë bisedës u fol: për premtimin që duhej të mbante dikush që e kishte dhënë atë: “...+000: ...unë nuk kam ditë gjo fare, as u kam thon hajdeni as hiç, por ai që ju ka premtue, ça u ka than, duhet t'u rri tek kamit e me ja marr. +091: Nuk kemi marrë asgjë akoma, po do llafosim, do pimë kafe dhe do të sqaroj unë...+091: Jo me se me premtun diçka ktu, prit, eee e kupton ti...”; për dënimin e Fredit rreth të dhënave që me shumë gjasë kanë lidhje me çështjen: “...+091: Çunat po e mbajnë nga brenda se thesin e kam unë, po ta hap unë thesin mbaron çdo gjë... e kupton vetë ti muhabetin...”; për vlerësimin nga Shkëlzen si gabim, nëse gjithçka ishte organizuar për të përfitur para: “+000: Në qoftë se i ka hy për lek, ka bo gabimin më të madh, e mo, o shoku jem, po ça boni o burr...”; për çënimin e gjithçkaje të trilluar, të stisur, të pohuar si të tillë nga Fredi: “...+091: ...unë prap po rri fisnik, ato që janë premtuar...nuk kam marrë asgjë...edhe unë një llaf tani dhe përmbysat bota, kthehet nga e para e del çdo gjë falco...kupton...+091: Janë falco, janë falco, po ta them me shpirt. +000: Eni pra mos u bini në qafë njerzve kur janë falco, mos u bini në qafë njerzve kot o vlla”; për mundësinë e lidhjes së gjithçkaje të trilluar me synimin e marrjes së azilit: “...+000: Atë ditë e takova rastësisht Babalen dhe i thashë...vetja i thashë, ke hi i merr në qafë robt kot. +000: Me i bo letrat për azil, nuk e di si i boni kto punë. +091: është e vërtetë kjo ke vllai, është e vërtetë...”.

Në datë 01.06.2018, ora 16.50, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) i telefonon nr. 355129 dhe bëjnë këtë bisedë:091-dëgjo mua, dëgjo mua..je, një sekondë do më dëgjosh me vëmendje, a më dëgjon? 129-po ju dëgjoj zotri fol 091-ajo dëshmi e babales është fallso, edhe unë jam ai originali. 129-mirë, mirë, ja po të merr drejtori në telefon tani lëre atë e di un....

Ne datë 01.06.2018, ora 16:52:23,përdoruesi i numrit telefonik 069 41 10 316 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 (ndërsa më parë midis tyre ishin realizuar disa komunikime ku i kërkohet përdoruesit të numrit telefonik 069 41 10 316, i rezultuar drejtues i policisë në Qarkun Fier, nga komunikuesi takim për diçka shumë të rëndësishme) dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...091- ajo që është bërë mes telefonave dhe përgjimi kam qenë unë që e kam bërë atë..... Ai që është bërë në përgjime.....ajo që është bërë me babalen në përgjime....kam qenë unë që e kam bërë..... 316- me kë ke qenë kur e ke bërë? 091-me babalen, me asnjë tjetër. 316-nuk ke qenë ti nuk ke qenë bashkë me Agronin? 091-jo, jo ka qenë babalja unë kam qenë në vend të Agronit. 316- je i sigurt për këtë? +091: Jam i sigurt, më dëgjo mua do më dëgjosh me vëmendje, më dëgjo mua, edhe do të flisja me fakte...na premtuan 200 (dyqind) mijë Euro unë s'kam marrë asgjë, i mori Berti 70 (shtatëdhjetë) mijë Euro dhe iku e kupton, jam i sigurt dhe me dorë në zjarr...”.

Në datë 01.06.2018, ora 16:56:52, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 068 20 29 700 dhe, zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “+091: E morën vesh se ja thash gjitha unë historin, tani te marim ndonjë ej, aa do e shikosh në televizor, mua hajd ik, kalofsh mirë...”.

Në datë 05.06.2018, ora 14:32, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 069 94 23 771 dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....771-ani vlla, ej i thashe une dicka atyne-I thashe me duket se po ja kerret anej nga ana tjetere. 091-jo, ja kercita une ja kercita. 771- ej me tha ai me gisht te keputun thuj te vije te me takoj s di gje thashe une s ma ka hap telefonin.

Në datë 05.06.2018, ora 18:47, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dyshohet te jete i pandehuri Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: “..... 272-e mire shume mire hajde vlla hajde-edhe degjo vetem kaq mendo per femijet e mi asgje ne bote ca takon mbaro punen e mendo per femijet e mi qe kam rugeve po je vellai im. 091-e kam lene per me vone me ate pune. 272-po mire e mire dakort mendo per femijet e mi kaq. 091-e ore e mos e vri mendjen nga ajo pune tip o ejj I ka gati ato ai?,,,,,

Në datë 05.06.2018, ora 21:05, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 0694101289 dhe zhvillojnë këtë bisedë: “..... 091-mire mo ne rregull po sonte ku do rri une si keni marre masat mire ku do rri sonte. 289-ku do rrih sonte? 091-po 289-po fol ijer me Saliu mos ashu rri ke Saliu sonte rri ke Saliu sonte fol ma Saliu njehere.....

Në datë 05.06.2018, ora 21:33, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dyskohet te jete i pandehuri Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: “..... 272-po mire e neser ne mengjes mere Salen iken mer ca te takojne te gjitha i di vete gjerat ti mos te flas shume ne telefon te kam vlla dhe une jam i shqetesuar, e beson qe po ha buke azili, po ha buke azili me vdekshin te dy djemte. 091-se ve ne dyshim.”

Në datë 06.06.2018, ora 21:33, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dyskohet te jete i pandehuri Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....091-e takova jo ktej jo andej jam keq po dridhej. 272-ore thuj bej likuidimin qe kemi lene thuj kaq asgje ne bote o Fredi vllai se me ate s kam lidhje fare kontakti besome se jam ne azil per shpirt te plakes-une flas me ane te tjetrit me kosovarin me ate – thuj e vlla me bej likuidimin si e lame thuj.....”

Në datë 06.06.2018, ora 13:49, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dyskohet te jete shtetasi Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....091-fol njeher me ata miqte e vlla se une sdola dot andej poshte mua me erdhen me degjeneruan dy here ne mengjes me mbajten kater ore aty me benin presion mendo dhe per mua i q.. motren...272-ore po sbehet llaf po rri rehat tani bol tani. 091-ai miku qe ti njehe me thoshte mua fol hap gojen sa do ore une sikur e kam....”

Në datë 10.06.2018, ora 09:30, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 069 94 23 771 dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....771-mire, ca thojne kto gazeta e vlla? 091- ne s do mbajmë atë në kurriz unë i dola nga borxhi. 091- ne sdo mbajmë atë në kurriz unë i dola nga borxhi.....”

Në datë 12.06.2018, ora 12:55, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 069 86 21 974 dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....091-muhabeget nuk e ke digjeguar ne televizor ti me shtegjet me shtogu po fola unë gjëra e ai muhabegeti jam une e kape ti filmi e?.....091-une begera sikur kisha vllagai i atit e ke parasysh-degjon e? 974-he 091- begera sikur igisha vllagai i atit e kupton ti qe dogoj kshu e kupton do migirim nga nje qikinshe e kupton ti. 974-eee 091-pa kela re burre po s ishte e mire ajo gje kupton ti nga nje qiginshe erdhi muhabeti prit re nga nje qigince per njer dyqigin e me tha mua nuk marim dyqigin me tha mua do magarim njeqike ore mire I thashe une mendogova une vari k... 091- dgjo ree e me thaga mua do magarim nji iqikince me tha mua nuk japin dyqind une e kuptova edhe e pashe qe po me devijonte e ke parasysh vete ti se ca tipi ka ai. 974-e di une e di. 091-edhe i thashe mire i qikince i thashe une nem nje njezetetet mua nje zeget une viki andej levizja e kupton vlla-as njezetet asgjeje vlla ikuqe ky muhabet...”

Në datë 19.06.2018, ora 11:46, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonon përdoruesin e numrit telefonik 0685296508 dhe zhvillojnë këtë bisedë:“.....508-Hic ca te bej ne ship-mer lexo Gazeten Shqiptare mere. 091-ca thote? 508-e he fortune. 091-ca thote? 508-fortune, arrestime ca thote pranaj pot e them lexoje gazeten. 091-e po ku mar vesh une. 508-ca bone ti? 091- kur e dha kur e dha? 508-sot sot. 091-ca thote e ca thote. 508-arrestime thote priten arrestime.....”

Në datë 19.06.2018, ora 15:00, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 0685296508 dhe zhvillojnë këtë bisedë:“.....508- ne ship ku te jem – E pe ate gazeten? 091-jo se pashe, ca thoshte, ca thoshte? 508-po hic e do arrestohen po pak e pashe une po smora gazete-nuk mora gazete e pashe vetem me njes te gazetaz qe dalin ne gazete-priten arrestime edhe 100 milion jane mare 100 milion leke nga deshmitari nga Novosela thote qe eshte paraqitur te krimet e renda. 091-si ka marre 100 milion qe jane marre? 508-jo jo qe jane mare 100 mije euro jan mar qe ka marre babalja.Nga pergjimet e sipercituara vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas bërjes publike të regjistrimit të bisedës që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara.

Në bisedat e zhvilluar të pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkon të pandehurit Fredi Alizoti, që të “duronte” dhe pak sa të rregulloheshin punët.

Në asnjë bisedë që ka patur konteks çështjen e shpërbllimit, i pandehuri Albert Veliu nuk ka kundërshtuar të pandehurin Fredi Alizoti dhe për më tepër që ka aprovuar në heshtje.

Nga analizimi i përgjimeve telefonike vihet re se i pandehuri Albert Veliu u “kërkon llogari” personave të tjerë për sistemimin e familjarëve të tij.

Midis të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, ka shumë komunikime pas bërjes publike të regjistrimit të bisedës që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Ne vijim ka rezultuar e provuar denjia, pjesëmarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Salianji me të pandehurit e tjerë ne kryerjen e veprës penale të atribuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a. me anë të së cilës janë përcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji.

Nga këto tabulate evidentohet se:

- Në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda;
- Në datën 20.10.2017, ora 10:23:36, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 6 sekonda;
- Në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 23 sekonda;
- Në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 12 sekonda;
- Në datën 21.10.2017, ora 19:49, numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 84 sekonda;

Këto të dhëna vërtetojnë të çdo dyshimi se, është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi.

-Po kështu nga administrimi i Shkresës me nr.prot.4434/1, datë 18.9.2018, të shoqërisë Altelecom sh.a, dokumentohet fakti se numri 0676494091, është në përdorim të abonentit Fredi Alizoti. Më sipër janë pasqyruar edhe regjistrimet e përgjimeve të këtij numri celular.

-Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.2740/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Altelecom sh.a, dokumentohet se numri celular 0692151212, është në përdorim të abonentit Jetmir Olldashi.

-Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate vihet re se nga numri i tel. 069 93 24 140, në përdorim të pandehurit Albert Veliu, është telefonuar numri i tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, në datën 09.10.2017, ora 19.32, biseda ka zgjatur 69 sekonda dhe në datën 10.10.2017, ora 13.38, biseda ka zgjatur 121 sekonda.

Në datën 24.10.2017, ora 14:27, numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të të pandehurit Albert Veliu ka telefonuar numrin e tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe biseda ka zgjatur 20 sekonda. Në momentin e thirrjes, qeliza e transmetimit e numrit celular 0699477182 në përdorim të shtetasit Albert Veliu, është “KRAPSI-S” dhe “MIFOLI-N”.

Në datën 24.10.2017, ora 14.50', numri i tel. 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj ka telefonuar numrin e tel. 069 94 77 182 në përdorim të pandehurit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 29 sekonda. Në momentin e hirjes, numri telefonik 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, ka loguar në zonën "Mbrostari Ura B", Fier.

Në datën 24.10.2017, numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të pandehurit Albert Veliu ka realizuar thirrje telefonike me numra të tjerë celularë, në orën 15.06' me qelizë transmetimi "PESHTAN-N" dhe "FIER SOUTH-N", në orën 15.57' me qelizë transmetimi "KAVAJE-SE" dhe në orën 16.38' me qelizë transmetimi "NEW RING ROAD 3-SE" (Unaza e Re).

Këto të dhëna, evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë. Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjedin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

-Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vërtetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

-Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Saliani. Nga të dhënat telefonike të administruara, vërtetohet se:

-Në datën 24.11.2017, ora 09.01', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 13 sekonda. Kjo bisedë është zhvilluar rreth një orë më parë, nga momenti kur i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek zyra e dëshmitarit Besim Hajdarmataj;

-Në datën 24.11.2017, ora 16.30', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 22 sekonda. Kjo bisedë është realizuar rreth 4 minuta më pas nga kontakti telefonik që shtetasi Albert Veliu ka patur me punonjësin e SHISH-it, dëshmitarin Eduart Martini.

- Në datën 25.11.2017, ora 10.21', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 69 sekonda.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa me shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

-Nga Shkresa me nr.prot.53/1, datë 10.01.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a, evidentohen numrat telefonikë që ka përdorur i pandehuri Fredi Alizoti.

-Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e trasmetimit (antenat) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

-Me Shkresën me nr.FRS/0458/LP, datë 31.01.2019, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet telefonike dhe qelizat e trasmetimit për numrin telefonik 0694024321, në përdorim të dëshmitarit Agron Hyseni, për komunikimet e kryera në datën 24.11.2017. Nga këto të dhëna vihet re qartë se atë ditë (pra në dt.24.11.2017) ai ndodhej në qytetin e Vlorës, ndonëse është me banim në Tiranë.

Sipas vendimit Nr 53 data 12.4.2019 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane eshte vendosur ;'Pushimi i hetimeve te procedimit penal nr 95/1 te vitit 2018 per vepren penale te "'Trafikimit te narkotikeve"' parashikuar nga neni 283/a K.Penal,pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonje e dhene inkrimiuuese per shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

-Nga materialet e përcjella me Shkresën me nr.32/2 Prot./BK, datë 24.01.2019, të Ministrisë së Drejtësisë, dokumentohet se i pandehuri Albert Veliu ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në datën 24.05.2018. Në datën 28.05.2018 ai është paraqitur në policinë e Republikës së Kosovës dhe në datën 29.05.2018, ka kërkuar azil pranë zyrës përkatëse. Mbasi është pajisur me çertifikatën e statusit të azilkerkuesit me nr.1311, i pandehuri Albert Veliu është lënë i lirë nga policia.

-Në gjykim në funksion të këtij procedimi kanë dëshmuar dëshmitarët Ermal Sadiraj, Ermal Kodhima dhe Ermal Hitoalaj, me detyrë efektive në Komisaritet në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Në dëshmitë e dhëna përpara Gjykatës ndër të tjera ata shpjeguan që nuk kishin as njohje dhe as kontakte si me të pandehurin Albert Veliu ashtu dhe me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Të gjithë dëshmitarët mohuan që ndonjë prej tyre të ishte personi me emrin "Ermal" që përmendet në materialin e publikuar në datën 14.05.2018.

Ne vijim, ne gjykim dëshmitari Ermal Haxhi, dëshmoi përpara Gjykatës se në periudhën Gusht 2017 – Nëntor 2017 kishte qenë shef i Stacionit Policisë Kufitare Dhërmi dhe nuk kishte as njohje dhe as kontakte si me të pandehurin Albert Veliu ashtu dhe me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Për këtë rast ai ishte vënë në dijeni pas bërjes publike të regjistrimit dhe mohoi që të ishte personi me emrin "Ermal" që përmendet në materialin e publikuar në datën 14.05.2018.

Po kështu dëshmitari Eriton Demiri, dëshmoi përpara Gjykatës se njihej ndryshe edhe me nofken "toto qorri". Ai shpjegoi kishte në pronesi të tij një lokal të ndodhur në "lungomare" Vlorë dhe të pandehurin Albert Veliu e njihte si person problematik dhe me të kishte marrëdhënie si gjiton që ishin. Ai mohoi kategorikisht që i pandehuri Albert Veliu të kishte drekuar ndonjëherë në lokalin e tij dhe pas daljes së regjistrimit edhe stafit i lokalit i kishin konfirmuar që Albert Veliu nuk kishte qenë ndonjëherë në lokalin e tij.

Edhe dëshmitarët Besim Hajdarmataj, Robert Tuci dhe Eduard Martini, dëshmuar përpara Gjykatës për fakte që evidentuan mënyrën se si secili prej tyre kishte kontaktuar me të pandehurin Albert Veliu, informacionin që ai pretendonte se dispononte, mënyrën se si ishte proceduar më tej dhe faktin që nga gjithë procedura e kryer nuk kishte rezultuar ndonjë e dhënë implikuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Ne gjykim dëshmuar rreth fakteve objekt procedimi edhe dëshmitarët Enkelejd Alibeaj dhe Gazmend Bardhi, të cilët shpjeguan përpara Gjykatës rrethanat se si ishin vënë në dijeni të materialit që u publikua prej tyre dhe të pandehurit Ervin Salianji, në daljen publike të datës 14.05.2018. Nga dëshmia e tyre, u evidentua qartë se kishte qenë pikërisht i pandehuri Ervin Salianji që ishte marrë parapikshimit me materialin që ishte publikuar.

Ne gjykim dëshmuar rreth fakteve objekt procedimi edhe dëshmitarët Albert Nushi dhe Andon Marko, të cilët kanë qenë përkatësisht në detyrë e drejtorit dhe zv/drejtorit të DVP Fier, në periudhën kur është publikuar "videopërgjimi". Të dy këta dëshmitarë, shpjeguan në mënyrë të hollësishme përpara Gjykatës, lidhur me rrethanat se si janë kontaktuar nga i pandehuri Fredi Alizoti dhe veprimet që kanë kryer më pas me të.

Ne séance gjyqësore në dëshminë e dhënë në gjykim, shtetasi Arnedo Selmanaj shpjegoi përpara Gjykatës se në rolin e kameramanit dhe për llogarit të një emision investigativ për çështje në ndjekje të parcelave të hashashit, kishte udhëtuar për në qytetin e Vlorës së bashku me të pandehurin Jetmir Olldashi dhe me një person që thirrej "babale". Në qytetin e Vlorës kishin takuar shumë individë por nuk kishin faktuar aq sa donin.

Në dëshminë e tij të dhënë në gjykim shtetasi Ylli Rakipi, shpjegoi përpara Gjykatës se si drejtues i emisionit "Të paeksponuarit" kishte miratuar kërkesën e të pandehurit Jetmir Olldashi për të kryer një investigim për çështje droge në qytetin e Vlorës. I pandehuri Jetmir nuk i kishte referuar ndonjë emër konkret, por i kishte premtuar se do sillte video. Kur i pandehuri është kthyer në Vlorë, dëshmitari është vënë në dijeni për materialin dhe meqënëse nuk kishte asnjë vlerë nuk e kishte marrë dhe shfrytëzuar për ndonjë emision.

Sikurse rezultoi si gjatë hetimit dhe gjykimit, i pandehuri Jetmir Olldashi nuk dorëzoi në asnjë moment regjistrimet origjinale që ai pretendon se janë bërë në Vlorë në datën 24.10.2017.

Në gjykim dëshmitari Erzen Breçani, konfirmoi përpara Gjykatës bisedat telefonike që kishte kryer me të pandehurin Fredi Alizoti dhe kontekstin e tyre. Në komunikimet me të pandehurin ai i kishte thënë se nuk ishte ai personi i duhur dhe të mos merrnin më qafë njerëzit.

Po kështu dëshmitari Nertil Mehmetaj, shpjegoi përpara Gjykatës se administronte lokalit "Vila del Sol", që ndodhej në qytetin Vlorë, në të cilin kishte të punësuar edhe shtetasin Klevis Veliu, djali i të pandehurit Albert Veliu. Ditën që është publikuar materiali i përgjimit është njoftuar nga një i njohur i tij, i cili i kishte thënë që personi i thirrur "Bashkëpunëtori X" dyshonte se ishte shtetasi Bert Veliu. Pas këtij momenti, kishte komunikuar me të pandehurin Albert Veliu, i cili i kishte pohuar që personi në bisedë ishte ai. Të nesërmen e asaj dite, Klevisi i kishte thënë që do e linte punën, pasi do të ikte larg.

Në gjykim dëshmitari Agron Hyseni dëshmoi përpara Gjykatës se kishte aktivitet biznesi në Vlorë dhe për këtë shkak, shpesh herë shkonte atje.

Në respektim të kërkesave të nenit 369/2 të K.Pr.Penale gjatë shqyrtimit gjyqësor u lexuan edhe deklaratimet e dhëna gjatë hetimeve paraprake nga shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe procesverbalit përkatës u bë pjesë e fashikullit të shqyrtimit gjyqësor. Në deklaratim e bëra prej tij përpara prokurorit, ky shtetas ka mohuar kategorikisht që të kishte kryer ndonjë bisedë me të pandehurin Albert Veliu, e për më tepër bisedë për ndonjë trafikim të mundshëm lëndësh narkotike.

Ne deklaratim e dhëna në gjykim përpara Gjykatës i pandehuri Fredi Alizoti, (në respektim të nenit 166 të K.Pr.Penale) shpjegoi në mënyrë të hollësishe gjithë mënyrën se si kishin vepruar ai dhe bashkëpunëtorët e tjerë në realizimin e veprës penale, faktin e kryerjes se kesaj veprimtarie i motivuar nga një përfitim material i premtuar, etj.

Ne gjykim u administruan edhe Procesverbalet me deklaratim e dhëna gjatë hetimit paraprak të të pandehurit Albert Veliu (i proçeduar ne mungese ne gjykim, konform nenit 370/2 të K.Pr.Penale), i cili megjithëse u njoftua nga Gjykata nëpërmjet Letërposisës për zhvillimin e këtij gjykimi dhe akuzat ndaj tij, nuk paraqiti asnjë kërkesë lidhur me gjykimin. Në lidhje me deklaratim e tij të mëparshme Prokuroria eidentoi disa pasaktësi si më poshtë:

I pandehuri Albert Veliu në deklaratim e tij në Prokurori ka rrëfyer të dy udhëtimet e tij në Vlorë të datave 24.10.2017 dhe 24.11.2017 në një deklaram. Është e vërtetë që ai ka shkuar në Vlorë i shoqëruar nga i pandehuri Jetmir Olldashi në datë 24.10.2017, ku dhe ka kryer komunikime telefonike në këtë datë në rrethinat e Vlorës referuar logjimeve të antenave me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj por nuk rezultoi që të jetë takuar me këtë shtetas. Gjithashtu, i pandehuri Albert Veliu ka qenë në Vlorë dhe në datë 24.11.2017, i shoqëruar nga punonjësi të SHISH-it ku ka regjistruar një bisedë me shtetasin Agron Hyseni. I pandehuri Albert Veliu në deklaratim e tij i referohet datës 24.11.2017 e cila është disa ditë para përmbajtjeve. Në këtë datë ai nuk ka asnjë komunikim me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe ka kryer regjistrimin e bisedës me shtetasin Agron Laver Hyseni. Gjithashtu, lokali i pretenduar në deklaratim e tij "2 Palmat" është lokali ku ai ka kryer bisedën i shoqëruar nga punonjësit e SHISH-it me shtetasin Agron Laver Hyseni. Gjithashtu në deklaratim e dhëna prej tij lidhur me pajisjen ai i referohet pajisjes së përdorur kur ka qenë i shoqëruar nga punonjësit SHISH-it.

I pandehuri Albert Veliu në deklaratim e tij i referohet udhëtimit në Vlorë me punonjësit e agjencisë ligjzbatuese në datë 24.11.2017, datë e cila përkon me atë që përmend në deklaram, rreth katër ditë përpara se të binin shirat e mëdha në Vlorë. Ka mospërputhje rreth një muaj midis udhëtimit me të pandehurin Jetmir Olldashi në Vlorë në datë 24.10.2017, me udhëtimin me punonjësit e SHISH-it në datë 24.11.2017.

Personat e përmendur nga i pandehuri Albert Veliu nuk rezultoi të kenë qenë të pranishëm në bisedë. Për më tepër që, emri "Ernal" përmendet dhe në bisedën e realizuar me punonjësit e SHISH-it.

I pandehuri Albert Veliu pranon që kishte "qejfmbetje" të vjetër me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj pasi sipas tij ai nuk ishte interesuar për problemet e tij.

Këtë fakt e pranon dhe i pandehuri Jetmir Olldashi në deklaratim e tij sipas të cilit Alberti kishte ndjenjë të fortë hakmarrjeje për njerëzit për të cilët fliste, midis tyre dhe për Geron (Agron) Xhafajin.

I pandehuri Albert Veliu përmend në deklaratim e tij që ka komunikuar me shtetasin Edmon Hyseni ndërkohë që ky i fundit e mohoi një fakt të tillë. Gjithashtu pretendon që ka drekuar në lokalit e "toto qorrit". Ky i fundit i identifikuar si dëshmitari Eriton Demiri e mohoi një fakt të tillë përpara Gjykatës. I pandehuri Albert Veliu, pas publikimit të audiopërgjimit ka larguar fillimisht familjarët e tij jashtë vendit dhe më pas është larguar dhe vetë duke kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovë.

Mbi bazën e këtyre fakteve, nga përfaqësuesit e organit të akuzës u kërkua deklarimi fajtor i secilit prej të pandehurve Albert Veliu, Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliانji për veprat penale të atribuara ne kete gjykim, si dhe denimi i secilit prej tyre me burgim ne masat e percaktuara ne pjesen hyrese te ketij vendimi, duke u kerkuar aplikimi i nenit 63 të Kodit Penal për të pandehurin Jetmir Olldashi (ku prokurori G.Qana kerkoj aplikim të nenit 59 të Kodit Penal ndaj te pandehurit Ervin Saliانji). Perfaqesuesit e akuzes parashtruan se të pandehurit me veprimet e tyre të kryera me dashje kane konsumuar elementet e ketyre veprave penale, duke kerkuar nga Gjykata qe ne caktimin e llojit dhe te mases se denimit ndaj secilit prej te pandehurve te marre ne vleresim rrezikshmerine e veprave penale, faktin qe vepra penale e parashikuar nga nent 305-25 është kryer në bashkëpunim, rrezikshmërinë e vetë të pandehurve dhe rrethanat individuale, sociale e familjare te secilit prej te pandehurve si me siper jane evidentuar.

Mbrojtësia e të pandehurit Albert Veliu ne konkluzionet e fundit kerkoj deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Albert Veliu për veprat penale të atribuara duke i evidentuar pretendimet kontestuese me shkrim.

Mbrojtësi i të pandehurit Fredi Alizoti kerkoj caktimin e një mase dënimi më të butë ndaj tij, për shkak të qëndrimit pohues e pendues të tij ndaj akuzës dhe bashkëpunimit të treguar me organin procedure në zbulimin e të vërtetës.

Mbrojtësi i të pandehurit Jetmir Olldashi kerkoj deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprën penale të atribuuar me pretendimin se fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si vepër penale bazuar në nenin 388/1(a,c), duke i evidentuar pretendimet kontestuese me shkrim.

Mbrojtësi i të pandehurit Ervin Saliانji kerkoj deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprën penale të atribuuar me pretendimin se fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si vepër penale bazuar në nenin 388/1(a,c), duke i evidentuar pretendimet kontestuese me shkrim.

Vetë i pandehuri Ervin Saliانji u shpreh dakord me mbrojtësin e tij duke kërkuar pafajësi.

Vlerësimi, arsytimi dhe disponimi i Gjykatës.

Interpretimi i dispozitave penale, analiza e provave lidhur me akuzën respektive të atribuuar secilit të pandehur.

Referuar faktit penal te sipercituar dhe teresise se provave te shqyrtuara e administruara ne gjykim, Gjykata çmon se në veprimet e të pandehurit **Albert Veliu** janë të pranishëm të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elemente të figurave të veprave penale të "Kallëzimit të rreme, të kryer në bashkëpunim" dhe të "Kalimit të paligjshëm te kufirit shtetëror", të parashikuara nga nenet 305 e 25 dhe 297 të K.Penal. Gjithashtu Gjykata çmon se në veprimet e secilit prej të pandehurve **Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliانji** janë të pranishëm të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elemente të figurës së veprës penale të "Kallëzimit të rreme, të kryer në bashkëpunim", të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Në nenin 305 të Kodit Penal përcaktohet se: "*Kallëzimi për kryerjen e një krimi që dihet se nuk është kryer ose për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer atë, si edhe, krijimi i provave të rreme me qëllim që të bëhen ndjekje penale, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*"

Në analizë të kuptimit, elementeve të bashkëpunimit dhe rolit të bashkëpunetoreve, si dhe referuar praktikës së Gjykatës së Lartë e konkretisht vendimit unifikues penal Nr.4, date 15/04/2011 qe te ekzistojte bashkepunimi ne kryerjen e nje vepra penale detyrimisht duhet te bashkeekzistojne si kushte "*sine qua non*" njeherazi keto 4 elemente:

- Dy ose me shume subjekte (pluralitet personash);
- Realizimi i faktit kriminal ne te gjithë elementet e tij materiale;

- Dhenia e nje kontributi rlevant ne kryerjen e vepres penale nga seicili prej bashkepunetoreve;
- Ana subjektive, qe eshte dijenia e bashkepunetoreve per te bashkepunuar me te tjeret ne kryerjen e faktit kriminal.

Ndersa ne permabajtjen e nenit 297 te K.Penal, sanksionohet se: *“Kalimi i paligjshem i kufijve shtetore perben kundervajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne dy vjet.”*

Sipas nenit 152/1 te K.Pr.Penale: *“Çmuarja e provave eshte percaktimi i vertetesise dhe i fuqise provuese te tyre. Çdo prove i nenshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlere te paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes se formuar pas shqyrtimit te tyre ne teresi.”*

Gjykata vlereson se, nisur nga rrethanat e ngjarjes, nga shqyrtimi i provave të analizuara më sipër, të administruara ne funksion te ketij procedimi qe japin hollesi dhe tregojne rrjedhën kronologjike të veprimtarisë së të katër të pandehurëve në kryerjen e veprave penale të atribuara, të kohes kur ka ndodhur krimi, menyres se si eshte fabrikuar audiopergjimi i rreme ne permabajtje dhe i rreme për subjektin që referon si nje nga protagonistët e tij (shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, nderkohe qe subjekte te vertete të tij janë të pandehurit Albert Veliu e Fredi Alizoti), te perdorimit të kësaj prove të rremë si bazë e një deklarimi publik e mediatic për kryerjen e një nje krimi të rëndë ne fushen e narkotikëve, tërësisht i sajuar (i planifikuar kohë më parë nga të pandehurit në bashkëpunim mes tyre, duke qene se te pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti rezultuan të kishin njohte te mepareshme, ndërsa të pandehurit Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñji kane krijuar njohte për shkak të këtij bashkëpunimi me të pandehurit, të rezultuar nga komunikimet mes tyre dhe më tej takimet), mjetet qe jane perdorur ne kryerjen e ketij krimi (pergjues, media, etj.), shtuar ketu dhe faktin e pranuar ne gjykim nga vete i pandehuri Fredi Alizoti per bashkeautoresine e pohuar mbi kryerjen e këtij krimi me të pandehurit e tjerë, rezulton teresisht e provuar se fakti ka ndodhur ne variantin e percaktuar nga ana e Prokurorise, e vertetuar nga aktet provuese si me siper jane specifikuar, dhe Gjykata vlereson se ne teresine e veprimeve te kryera nga te pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñji cilesohet kryerja e vepres penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal dhe se autoret e kryerjes se ketij krimi jane pikërisht te pandehurit.

1. Për të pandehurin Albert Veliu.

Persa i perket elementeve te figures se vepres penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, per Gjykatën referuar arsyetimit vijues, duke u mbeshtetur ne provat e sipercituara rezultoi e provuar qe i pandehuri Albert Veliu ne bashkëpunim me të pandehurit Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñji jane autoret e kryerjes se kesaj vepre penale dhe veprimet e tyre te bashkëpunuar te kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqerore, kane cenuar objektin e vepres penale, marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e individit, objekt i nje procedimi penal te rregjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar per me teper ne sajimin e provave te rreme për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas percaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e vepres penale *“Kallëzim i rremë”* kryhet nëpërmjet: i) kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; ii) kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallëzohet; ose iii) krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të iniciohet ndjekja penale.

Rezulton e provuar qe i pandehuri Albert Veliu ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e ne bashkëpunim me te pandehurit e tjere Fredi Alizoti, Ervin Saliñji e Jetmir Olldashi, të cilat konsistojnë në planifikimin, pergatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te rreme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shperndarjen e ketij audiopergjimi dhe publikimin mediatic te tij duke i atribuuar kryerjen e nje vepre penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qellimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale ne vlere monetare per te pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti.

Gjykata konstaton se pervec perfitimt material i pandehuri Albert Veliu ka pasur si qellim tjeter ne kryerjen e vepres penale edhe ate te perfitimt te azilit politik per vete dhe familjaret e tij. Nga provat rezulton se ky qellim i te pandehurit Albert Veliu per azil politik per vete dhe familjaret e tij del qarte i provuar nga komunikimet e pergjimet telefonike gjate kohes kryerjes se vepres penale e pas saj,duke u ndihmuar ne kete qellim edhe nga bashkëpunehuri tjeter Ervin Saliñji ,deputet ne ate kohe i Partise Demokratike te Republikes se Shqiperise.Ky qellim i te pandehurit rezulton edhe nga veprimet e te pandehurit pas kryerjes se vepres penale.Nga aktet rezulton se i pandehuri Albert Veliu ka kerkuar strehim politik ne Mbreterine e Belgjikes ku eshte kapur per efekte ekstradimi drejt Republikes se Shqiperise. Nga ana e kesaj gjykate i eshte mundesuar te pandehurit Albert Veliu njoftimi per kete procedim penal objekte gjykimi, por i pandehuri rezulton qe ti fshihet drejtësisë pavarësisht se ishte ne dijeni te ketij procedimi penal.

Ka rezultuar e provuar qe të dy të pandehurit e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin Janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar i tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i'a ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliñji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Deklarimet e dhena ne hetim te bashketepandehurit Albert Veliu (subjekti inicues dhe protagonist ne audiopergjim, me precedente penale dhe i motivuar nga nje ndjenje qejfmbetje e dashakeqesie ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj te cilat vlerësohen me rezervë nga Gjykata për shkak të kontradiktoritetit të tyre në faktet e deklaruara me provat e tjera si me siper janë evidentuar, dhe deklarimet e te pandehurit Fredi Alizoti si ne hetim e gjykim (ku ky i fundit pohon pjesemarrjen e tij si nje prej subjekteve bashkebesedues ne kete audiopergjim duke simuluar rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj), e po keshtu permabajtja e bisedave sipas tabulateve telefonike per komunikimet e kryera midis te gjithe te pandehurve disa dite para realizimit te audiopergjimit, mungesa e cdo qellimi tjetër të mundshëm qe te shpjegoje komunikimet telefonike te shpeshta e zinxhir mes te pandehurve per gjate periudhes se realizimit te audiopergjimit e mbas tij, faktotjne e provojne bashkëpunimin e te pandehurve ne kryerjen e kesaj vepre penale dhe se ne muajin Tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë paraprakisht takim me të pandehurin Ervin Saliñji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike. Në vlerësim të nenit 152/3 të K.Pr.Penale, deklarimet e dhena ne hetim nga bashketepandehurit Albert Veliu e Fredi Alizoti përbëjnë prove, por vlerësohen në unitet me provat e tjera të specifikuar e të marra gjatë këtij gjykimi që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

Kështu nga dëshmitë e dëshmitarëve të pytur në gjykim nuk u vërtetua ekzistenca e personit me emrin “Ernal” që përmendet nga i pandehuri Albert Veliu në materialin e publikuar në datën 14.05.2018. Po kështu dëshmitari Arnedo Selmanaj shpjegoi përpara Gjykatës se në rolin e kameramanit dhe për llogari të një emisioni investigativ për çështje në ndjekje të parcelave të hashashit, kishte udhëtuar për në qytetin e Vlorës së bashku me të pandehurin Jetmir Olldashi dhe me një person që thirrej “babale”. Në qytetin e Vlorës kishin takuar shumë individë por nuk kishin faktuar aq sa donin.I pandehuri Albert Veliu në deklarimet e tij i referohet datës 24.11.2017 e cila është disa ditë para përmbytjeve. Në këtë datë ai nuk ka asnjë komunikim me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Publikimi i “audio-regjistrimit” të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Saliñji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiental dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisede telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiental i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si “Bashkëpunëtori X”, i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim “audio” të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar “Bashkëpunëtori X” dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim “video” prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat “Bashkëpunëtori X” ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë”.

Vlen per t'u theksuar se veprimtaria kriminale e te pandehurit Albert Veliu ka iniciuar me realizimin e audiopergjimit te sajuar ne bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, si dhe ka vijuar me bashkëpunimin e te pandehurit Ervin Saliñji ne parashtrimin publikisht ne media duke e adresuar drejtpërdrejt ne organet proceduese, si një kallëzim penal (duke bere deklarata publike e adresuar ne organet e drejtësisë fillimin e procedimit penal per veprimtari kriminale ne fushen e trafikimit te narkotikëve (te rreme) ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Kallëzimi publik e mediatic i bere dihet qe është realist i rreme, pasi në permabajtjen e tij nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkëpunim me te pandehurit Fredi Alizoti, Ervin Saliñji e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës, bazur në një provë audiopergjim të sajuar për kryerjen e një krimi (“Trafikimi i narkotikeve”, të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, i atribuuar nga te pandehurit Albert Veliu e Ervin Saliñji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale te sajua ne blerjen prej tij per trafikimi te nje sasive lende narkotike te deklaruara nga te pandehurit sikur jane kryer nga personi qe eshte cenuar nga ky kallezim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetas.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, paraqitja e këtij kallëzimi publik dhe mediatic i perseritur nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me të pandehurit e tjerë (duke sajuar kallëzimet të rreme, prova të rreme e cdo fakt tjetër ne themel të këtij kallëzimi të rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë per Krimet e Renda Tiranë si organet kompetente per shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes.

I pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me te pandehurit e tjere ka konsumuar vepren penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 te K.Penal me veprime aktive te kunderligjshme, te cilat konsistojne ne realizimin e nje veprimtarie ne kuader te bisedave telefonike audio te perguajara, teresisht te rreme, duke kallezuar publikisht ne media e me te j duke investuar organet e ndjekjes penale, si subjekt te nje veprimtarie kriminale ne fushen e narkotikeve, shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Ky i pandehuri nepermjet kesaj veprimtarie te paligjshme rrjedhimisht ka adresuar nje kallezim penal drejtuar Prokurorise se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, kallezim i cili dihet qe eshte realisht i rreme, pasi ne permbajtjen e tij nga i pandehuri jane dhene informacione qe nuk i perqijigjen te vertetes per kryerjen e nje krimi (Trafikim i narkotikeve, te parashikuar nga neni 283/a i K.Penal Shqiptar) qe ne te vertete nuk eshte kryer, i atribuar nga i pandehuri shtetasit te kallezuar Geron (Agron) Xhafaj, me qellim qe organet e drejtesise te fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese te sipercituara dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale qe kjo veper penale te jete konsumuar nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me te pandehurit e sipercituar. Bashkeautorësia e tij ne kryerjen e kesaj vepre penale provohet si nga transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara, ku ka komunikuar ky i pandehur me bashketepandehurit e tjere te ketij procedimi, nga deklarimet pohuese te bashkeautorësise ne pjesemarrjen si subjekt ne kete audiopergjim e te pandehurit Fredi Alizoti, ashtu edhe me rezultatet negative te Raporit të zërit dhe deshmite e deshmitareve, të cilat japin fakte konkrete te perfshtirjes se te pandehurit Albert Veliu ne kete veprimtari kriminale. Konkretisht rezultojne nje numer i konsiderueshem bisedash telefonike midis te pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike te perguajara te detajuara ne rrethanat e faktit vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës kompromentuese që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklarimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara. Në bisedat e zhvilluara me të pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkon të pandehurit Fredi Alizoti, që të “duronte” dhe pak sa të rregulloheshin punët. Pavaresisht që bisedat ndër të tjera kanë patur kontekst çështjen e shpërlimit për punën e kryer, i pandehuri Albert Veliu nuk ka kundërshtuar të pandehurin Fredi Alizoti dhe për më tepër që e ka aprovuar në heshtje. Nga analizimi i përgjimeve telefonike vihet re se i pandehuri Albert Veliu u “kërkon llogari” personave të tjerë për sistemin e familjarëve të tij.

Ne vijim ka rezultuar e provuar dijenia, pjesemarrja, kontributi dhe bashkepunimi i të pandehurit Ervin Salianji me te pandehurit e tjerë ne kryerjen e vepres penale të atribuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë përcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji. Nga këto tabulate evidentohet se: -në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda;

-në datën 20.10.2017, ora 10:23:36', numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 6 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 23 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 12 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:49', numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 84 sekonda;

Këto të dhëna janë tregues qe faktojnë perfshtirjen aktive te bashketepandehurit tjetër Ervin Salianji ne kryerjen e vepres penale ne bashkepunim me te pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vertetojnë veprimtarie aktive te tij ne perqatitjen e me te j fabrikimin e sajimin e provave te rreme, duke u angazhuar qe disa dite para se te realizohej audiopergjimi kompromentues i sajuar midis te pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate vihet re se nga numri i tel. 069 93 24 140, në përdorim të pandehurit Albert Veliu, është telefonuar numri i tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, në datën 09.10.2017, ora 19.32, biseda ka zgjatur 69 sekonda dhe në datën 10.10.2017, ora 13.38, biseda ka zgjatur 121 sekonda.

Në datën 24.10.2017, ora 14.27', numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të të pandehurit Albert Veliu ka telefonuar numrin e tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe biseda ka zgjatur 20 sekonda. Në momentin e thirrjes, qeliza e transmetimit e numrit celular 0699477182 në përdorim të shtetasit Albert Veliu, është “KRAPSI-S” dhe “MIFOLI-N”.

Në datën 24.10.2017, ora 14.50', numri i tel. 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj ka telefonuar numrin e tel. 069 94 77 182 në përdorim të pandehurit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 29 sekonda. Në momentin e thirrjes, numri telefonik 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, ka loguar në zonën “Mbrotari Ura B”, Fier.

Në datën 24.10.2017, numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të pandehurit Albert Veliu ka realizuar thirrje telefonike me numra të tjerë celularë, në orën 15.06' me qelizë transmetimi “PESHTAN-N” dhe “FIER SOUTH-N”, në orën 15.57' me qelizë transmetimi “KAVAJE-SE” dhe në orën 16.38' me qelizë transmetimi “NEW RING ROAD 3-SE” (Unaza e Re).

Këto të dhëna, evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë. Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levant duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjetin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vërtetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

Me shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka “bashkëpunuar” me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Salianji. Nga të dhënat telefonike të administruara, vërtetohet se:

-në datën 24.11.2017, ora 09.01', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 13 sekonda. Kjo bisedë është zhvilluar rreth një orë më parë, nga momenti kur i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek zyra e dëshmitarit Besim Hajdarmataj;

-në datën 24.11.2017, ora 16.30', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Velu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 22 sekonda. Kjo bisedë është realizuar rreth 4 minuta më pas nga kontakti telefonik që shtetasi Albert Velu ka patur me punonjës të SHISH-it, dëshmitarin Eduart Martin.

- në datën 25.11.2017, ora 10.21', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Velu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 69 sekonda.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Velu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa me shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Velu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Velu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Velu dhe se qelizat e trasmetimit (antena) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpëgon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Pikërisht veprimet aktive të të pandehurit Albert Velu në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, e njekoheshit të kundersligjshme lidhur me planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopërgjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Velu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e ketij audiopërgjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuar kryerjen e një veprë penale të rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve monetare për të pandehurit Albert Velu dhe Fredi Alizoti, e po kështu shfrytëzimin e ketij audiopërgjimi për realizimin e interesave politike për të pandehurin Ervin Salianji provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë shkakesore të veprimeve të bashkërenduara të secilit prej të pandehurve me pasojën e ardhur në fillimin e një procedimi penal ligjrisht të pabazuar dhe të mbeshtetur në prova të sajura e të rreme.

Eshtë një fakt i provuar nga aktet provuese, vecanërisht nga përmbajtja e transkripteve të bisedave telefonike të sipërvenditura midis të pandehurve, ku evidentohet dhe vërtetohet pjesëmarrja aktive e të pandehurit Albert Velu në të gjithë veprimtarinë e kundersligjshme së bashku me të pandehurit e tjerë Fredi Alizoti, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi lidhur me planifikimin e veprimeve të tyre në rend kronologjik e të miremenduar për realizimin e ketij audiopërgjimi nga përgatitja e kushteve, mjeteve, vendit, subjekteve e deri në mënyrën e publikimit mediatik të tij dhe servirjen si krim i rende i kryer nga shtetasi Geron(Agron) Xhafaj.

Referuar rrethanave të faktit, provave të administruara në hetim e gjykim, paraqitja e ketij kallëzimi nga i pandehuri bashkë me prova dokumentuese të sajura prej tij, kanë vënë në levizje organin procedues për kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e ceshtës (*duke harxhuar burimet njerëzore, vemendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme që i shërbejnë kesaj Prokurorie të Posacme për të hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtarie konkrete kriminale dhe jo ato të sajura*), por që nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të ketij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurit nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tij për të filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, për qëllime fitimi shumash të caktuara monetare. I pandehuri Albert Velu ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundersligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e njeriut objekt i procedimit penal si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 të Gjykatës së Shkalles së Parë për Krimet e Renda Tirane është vendosur: 'Pushimi i hetimeve të procedimit penal nr 95/1 të vitit 2018 për veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal, pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë inkrimuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të këtij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurve nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tyre në bashkëpunim me vullnet e ndërgjegje të plotë se po kryenin një veprimtari të kundersligjshme duke paraqitur të dhëna të rreme për të inicuar qellimisht një procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Nga ana subjektive kjo veprë penale është kryer nga i pandehuri Albert Velu në bashkëpunim me bashkëpandehurit e tjerë Fredi Alizoti, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi me faj, në formën e dashjes direkte, me qëllimin e posacem për të shkakuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive të dobta (për të perfutur shumën monetare të premtuara nga i bashkëpandehuri tjetër Ervin Salianji), veprime këto që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakesore me pasojën e dëshiruar prej të pandehurit, cka e bën të qartë se ky i fundit i ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij (kallëzimin e rreme në organin procedues dhe inicimin e procedimit penal ndaj shtetasit të kallëzuar Geron (Agron) Xhafaj) dhe njekoheshit ka dëshiruar ardhjen e këtyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qëllimin e posacem për të demtuar të drejtat e liritë e tij, reputacionin e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vëllait të tij ish-ministrit të brendshëm në kohën kur dhe është bërë publik ky kallëzim i rreme. Në rastin konkret, të pandehurit kanë bashkëpunuar me njeri-tjetrin neperimjet marrëveshjes paraprake të tyre për castin e volitshëm dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe ndarjen e roleve në këtë bashkëpunim Albert Velu dhe Ervin Salianji bashkeorganizatore, e njekoheshit i pari edhe ekzekutor e dy të pandehurit e tjerë njeri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (te katert kanë kryer veprime aktive në realizimin e audiopërgjimit kompromentues të rreme me qëllim adresimin mediatisht e publikisht të një kallëzimi të rreme për kryerjen e një krimi që nuk është kryer ndaj një shtetasi shqiptar për të inicuar procedimin penal ndaj tij e për të perfutur materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vëllait të të kallëzuarit, me çështinë e ish-ministrit të brendshëm të kohës kur ky fakt ka ndodhur). Megjithatë ata e parashikonin se një kallëzim i tillë publik e mediatik me një përmbajtje të tillë do të bënte që organet proçeduese kompetente të viheshin në lëvizje për të hetuar dhe proçeduar penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kanë lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e proçedimit penal për kryerjen e veprës penale të "Trafikimit të narkotikeve" të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Subjekt i kryerjes së kësaj veprë penale është i pandehuri Albert Velu, i cili, nga hetimi gjyqësor rezultoi të jetë i përgjegjshëm para ligjit penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Fajësia e të pandehurit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, veçanërisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqëritë e telefonisë celulare perkatese, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Velu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa me shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017 (disa dite para realizimit të vidiopërgjimit).

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Albert Velu ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të "Kallëzimit të rremë të kryer në bashkëpunim", të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

1. Në lidhje me elementet e figures se veprës penale të parashikuar nga neni 297 i K.Penal, per Gjykatën referuar arsyetimit vijues, rezultoi e provuar qe i pandehuri Albert Veliu ka konsumuar këtë veprë penale dhe ka cenuar objektin e kësaj veprë penale që janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar ligjshmërinë e kalimit të kufirit shtetëror. Në rastin konkret, i pandehuri Albert Veliu i cili me veprimet e tij të kundërligjshme, të drejtëpërdrejta dhe të vullnetshme ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar paprekshmerinë e integritetit territorial të vendit tone dhe rregullat e vendosura për të normuar veprimtarinë e daljes dhe hyrjes të çdo personi nga dhe drejt kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, nga veprimet kriminale, marrëdhënie keto të mbrojtura nga legjislacioni ynë penal.

Referuar neni 297 të Kodit Penal, figura e veprës penale “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” nga ana objektive kryhet nëpërmjet kalimit të kufirit shtetëror në mënyrë të paligjshme, pa dokumentacion të rregullt. Eshhtë e qarte që kjo është një dispozitë blankete, ndaj dhe lidhur me perkufizimin e kufijve shtetërorë dhe përcaktimin e rregullave ligjore të kalimit të territorit, Gjykata duhet t’i referohemi Ligjit Nr. 9861, datë 24.08.2008 “Për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit shtetëror”, i ndryshuar, ku në nenin 4 të këtij ligji nën titullin “Përkufizime” parashikohet shprehimisht: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: “...

– “Kufiri shtetëror” (më poshtë kufiri) është vija, e cila ndan territorin tokësor, ujërat e brendshme e territoriale dhe nëntokën e Republikës së Shqipërisë me shtetet fqinje, si edhe kufiri në territorin e pikave të kalimit kufitar, në aeroporte, aerodrome, porte detare, lumore, liqenore, nëpërmjet të cilave kryhet transporti ndërkombëtar...

– “Pikë e kalimit kufitar” është vendi i autorizuar nga autoritetet kompetente, ku kategori të caktuara personash mund të kalojnë kufirin gjatë orarit zyrtar të punës.

– “Kalim i kufirit shtetëror” është çdo lëvizje e njerëzve, e gjëse së gjallë, e sendeve vetjake dhe e mjeteve nëpërmjet kufirit.”.

Ndërsa në nenin 13 të këtij ligji nën titullin “Kalimi i kufirit” thuhet shprehimisht se: “1. Kalimi i kufirit bëhet vetëm në pikat e kalimit kufitar, brenda orarit të caktuar, me dokumente të vlefshme udhëtimi apo me dokumente që autorizojnë kalimin e kufirit; me një vizë të vlefshme, nëse kërkohet...”

Përsa i përket anes objektive të kesaj veprë penale dispozita kërkon detyrimisht qe keto veprime për t’u konsideruar të kundërligjshme dhe për të formuar kundervajtje penale, pra për të rene në penalitetet e kesaj dispozite të kryhen në një nga keto forma:

- nëpërmjet daljes nga kufiri shtetëror i Republikës së Shqipërisë nga pika apo vende të ndryshme të territorit dhe jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qëllim;
 - nëpërmjet hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qëllim, por nga vende të ndryshme të territorit;
- nëpërmjet hyrjes apo daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qëllim dhe pa dokumentet përkatëse identifikuese të nevojshme sipas normave ligjore shqiptare në fuqi, por në mënyrë të fshehtë duke iu shmangur autoriteteve kompetente që kontrollojnë dhe verifikojnë pajisjen apo jo të shtetasve me dokumentat e nevojshëm konform rregullave ligjore për të kaluar kufirin shtetëror;
- nëpërmjet hyrjes, kalimit, daljes në/nga ujrat territoriale të Republikës së Shqipërisë, në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të aplikueshem në fuqi për përcaktimin dhe respektimin e vijes kufitare detare, të liqenave dhe të lumenjve kufitare;
- nëpërmjet hyrjes, kalimit në hapësirën ajrore ku shtrihet sovraniteti i Republikës së Shqipërisë jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qëllim, në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të aplikueshem në fuqi për përcaktimin dhe respektimin e vijes kufitare.

Në rastin objekt trajtimi, ka rezultuar e provuar nga aktet provuese të administruara se i pandehuri Albert Veliu ka dale me date 24.05.2018 nga kufijte shtetërorë të vendit tone, pra është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë duke kaluar në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paligjshme, jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara ligjorisht për kalimin e kufirit shtetëror sipas normave ligjore shqiptare në fuqi, por në mënyrë të fshehtë duke iu shmangur autoriteteve kompetente që kontrollojnë dhe verifikojnë pajisjen apo jo të shtetasve me dokumentat e nevojshëm konform rregullave ligjore për të kaluar kufirin shtetëror, duke qenë i pandehuri në dijeni të faktit qe ndaj tij ishte caktuar një masë sigurimi personal shtrënguese “arrest në burg” në funksion të këtij procedimi. Në datën 28.05.2018, ai është paraqitur në policinë e Republikës së Kosovës dhe në datën 29.05.2018, ka kërkuar azil pranë zyrës përkatëse. Në vijim, mbasi është pajisur me certifikatën e statusit të azilkërkuetit me nr.1311, është lënë i lirë nga policia dhe aktualisht ndodhet i arrestuar nga autoritetet e Mbretërisë së Belgjikës, duke i’u nënshtruar procedurave të ekstradimit.

Në kryerjen e kësaj veprë penale i pandehuri, ka vepruar me dashje të drejtëpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të paligjshme, duke kaluar kufirin shtetëror pa dokumentacionin ligjor jo në pikat e ligjshme të kalimit të kufirit shtetëror.

Subjekt i kryerjes se kësaj veprë penale është i pandehuri Albert Veliu, i cili, nga hetimi gjyqësor rezultoi të jete i pergjegjshem para ligjit penal dhe ka mbushur moshen për pergjegjesi penale.

Pas shqyrtimit të akteve provuese, Gjykata konkludoi se i pandehuri Albert Veliu ngarkohet me pergjegjesi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të “Kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror”, të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Albert Veliu, Gjykata bazuar në nenet 47, 49,50, të K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që vepra penale e parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal që i atribuohet të pandehurit përbën një krim, ndërsa vepra tjetër penale perben kundervajtje, përcaktime keto që lidhen drejtëpërdrejt me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezultoi me precedentet të mëparshëm penalë, por i rehabilituar, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprave penale (dashje direkte), moshën dhe nivelin arsimor të tij, motivin për perfitim pasuror që e ka shtyrë në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, si dhe faktin qe i është fshehur drejtësisë duke iu shmangur procedimit penal.

Gjykata vlerëson se për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të marrëdhënieve juridike të cenuara nga kjo veprë penale (veprimtaria e rregullt e organeve të drejtësisë dhe të drejtat e liritë e njeriut), si dhe faktit që i pandehuri e ka kryer këtë veprë nisur nga motive të dobta (pasurore e politike), duke bërë që të ezaurohen në kohë, në vëmendje dhe në veprime procedurale të panevojshme shërbimet e Policisë Gjyqësore e të organeve proceduese, lloji i dënimit me burgim i kërkuar nga organi i akuzës për t’u caktuar ndaj të pandehurit për të dyja akuzat e atribuara, është ligjorisht i bazuar në dispozitën përkatëse penale.

Nga ana tjetër, lidhur me masat respektive dhe atë përfundimtare të dënimit me burgim të kërkuar nga organi i akuzës për të pandehurin Albert Veliu, Gjykata vlerëson se masat e dënimit të vlerësuara nga Gjykata në dispozitiv të këtij vendimi, përfshirë këtu dhe atë përfundimtare në zbatim të nenit 55 të K.Penal, i përgjigjen rëndësisë së faktit, veprave penale të kryera nga i pandehuri, si edhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, që të çmua në kompleksitet justifikojnë ligjorisht këtë masë përfundimtare dënimi dhe realizimin e qëllimit kompleks të dënimit penal lidhur me riedukimin dhe ndëshkimin e të pandehurit, por edhe qëllimin e parandalimit të përgjithshëm në shoqëri të kryerjes se kategorise se ketre veprave penale qe cenojne e drejtat dhe lirite e individit dhe devijojne veprimtarine e organeve proceduese te drejtësisë per te luftuar kriminalitetin real dhe ekzistues, në vend të atij të sajuar.

2. Për të pandehurin Fredi Alizoti.

Përsa i përket elementeve të figures se veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, per Gjykatën referuar arsyetimit vijues, duke u mbështetur në provat e sipërcituar rezultoi e provuar qe i pandehuri Fredi Alizoti në bashkëpunim me të pandehurit Albert Veliu ,Jemir Oildashi dhe Ervin Salianji janë autorët e kryerjes se kesaj veprë

penale dhe veprimet e tyre të bashkerenduara te kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqerore, kane cenuar objektin e veprës penale, marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e individit, objekt i nje procedimi penal te regjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar per me teper ne sajimin e provave te rreme për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas percaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e veprës penale “Kallëzim i rreme” kryhet nëpërmjet: *i*) kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; *ii*) kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallzohet; ose *iii*) krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të iniciohet ndjekja penale.

Rezultoni e provuar qe i pandehuri Fredi Alizoti ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e ne bashkepunim me te pandehurit e tjere Albert Veliu, Ervin Saliانji e Jetmir Olldashi, të cilat konsistojnë në planifikimin, pergatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te rreme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shperndarjen e ketij audiopergjimi dhe publikimin mediatik te tij duke i atribuar kryerjen e nje vepre penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qellimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale ne vlera monetare per te pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti.

Ka rezultuar e provuar qe të dy të pandehurit e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin Janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar në tipin stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i'a ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliانji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Deklarimet e bashketepandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti e po keshtu permbajtja e tabulateve telefonike per komunikimet e kryera midis te gjithe te pandehurve, faktotjne e provojne bashkepunimin e tyre në kryerjen e këtij krimi dhe se ne muajin tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë paraprakisht takim me të pandehurin Ervin Saliانji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike.

Publikimi i “audio-regjistrimit” të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Saliانji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiantal dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiantal i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si “Bashkëpunëtori X”, i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim “audio” të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar “Bashkëpunëtori X” dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim “video” prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat “Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë”.

Vlen per t'u theksuar se veprimtaria kriminale e te pandehurit Fredi Alizoti ka inicuar nga i pandehuri tjetër Albert Veliu duke u motivuar nga interesa teresisht pasurore duke u bërë Fredi Alizoti një nga protagonistët dhe subjekti i realizimit të audiopergjimit te sajuar, por kjo veprimtari është organizuar me bashkepunimin e te pandehurit Ervin Saliانji si në drejtim të fabrikimit të këtij audiopergjimi të rreme ashtu edhe në drejtim të parashtimit publikisht ne media duke e adresuar drejtperdrejt ne organet proceduese, si një kallëzim penal (duke bere deklarata publike e adresuar ne organet e drejtësisë fillimin e procedimit penal per veprimtari kiminale ne fushen e trafikimit te narkotikeve (te rreme) ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Kallëzimi publik e mediatik i bere dihet që është realisht i rreme, pasi në përmbajtjen e tij nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me te pandehurit Fredi Alizoti, Ervin Saliانji e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës bazuar në një provë audiopergjim të sajuar për kryerjen e një krimi (“Trafikimi i narkotikeve”, të parashkuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, i atribuar nga te pandehurit Albert Veliu e Ervin Saliانji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale te sajuar ne blerjen prej tij per trafikimi te nje sasive lende narkotike te deklaruar nga te pandehurit sikur jane kryer nga personi qe eshte cenuar nga ky kallëzim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetas.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, realizimi i një audiopergjimi të rreme nga të pandehurit Fredi Alizoti e Albert Veliu ne bashkepunim me të pandehurit e tjerë (duke sajuar kallëzim te rreme, prova te rreme e cdo fakt tjetër ne themel te ketij kallëzimi te rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së parë per Krimet e Renda Tiranë si organet kompetente per shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes. Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese te sipercituara dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale qe kjo vepër penale te jete konsumuar nga i pandehuri Fredi Alizoti ne bashkepunim me te pandehurit e sipercituar.

Bashkeautoresia e tij ne kryerjen e kesaj vepre penale provohet si nga transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara, ku ka komunikuar ky i pandehur me bashketepandehurit e tjere te ketij procedimi, nga deklarimet pohuese te bashkeautoresise ne pjesemarrjen si subject ne kete audiopergjim e te pandehurit Fredi Alizoti, ashtu edhe me rezultatet e Raportit të zërit dhe deshmite e deshmitareve, të cilat japin fakte konkrete te perfishirjes se te pandehurit Fredi Alizoti ne kete veprimtari kriminale. Konkretisht rezultojne nje numer I konsiderueshem bisedash telefonike midis te pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike te përgjuara te detajuara ne rrethanat e faktit vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës kompromentuese që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopergjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklarimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara. Në bisedat e zhvilluara me të pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkoi të pandehurit Fredi Alizoti, që të “duronte” dhe pak sa të rregulloheshin punët.

Pavaresisht qe bisedat nder te tjera kane patur kontekst çështjen e shpërblymit per punen e kryer, i pandehuri Albert Veliu nuk ka kundërshtuar të pandehurin Fredi Alizoti dhe për më tepër që e ka aprovuar në heshtje.

Nga analizimi i përgjimeve telefonike vihet re se i pandehuri Albert Veliu u "kërkon llogari" personave të tjerë për sistemimin e familjarëve të tij.

Ne vijim ka rezultuar e provuar dijenia, pjesëmarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Salianji me të pandehurit e tjerë në kryerjen e veprave penale të atribuara, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë ëprcëllë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji të analizuar më sipër.

Këto të dhëna janë tregues qe faktojne përfshirjen aktive te bashketepandehurit tjetër Ervin Salianji ne kryerjen e veprave penale ne bashkëpunim me të pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vertetojnë veprimtarinë aktive të tij në përgatitjen e me tej fabrikimin e sajimit e provave të rreme, duke u angazhuar kohe me parë se të realizohej audiopërgjimi kompromentues i sajuar midis të pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashit.

Po kështu nga administrimi i Shkresës me nr.prot.4434/1, datë 18.9.2018, të shoqërisë Albtelcom sh.a, dokumentohet fakti se numri 0676494091, është në përdorim të abonentit Fredi Alizoti.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.2740/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Albtelcom sh.a, dokumentohet se numri celular 0692151212, është përdorim të abonentit Jetmir Olldashit.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, ku këto të dhëna, evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë.

Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashit kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashit se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe njetin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Saliani.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashit për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashit për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelcom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e trasmetimit (antena) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Me Shkresën me nr.FRS/0458/LP, datë 31.01.2019, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet telefonike dhe qelizat e trasmetimit për numrin telefonik 0694024321, në përdorim të dëshmitarit Agron Hyseni, për komunikimet e kryera në datën 24.11.2017. Nga këto të dhëna vihet re qartë se atë ditë (pra në dt.24.11.2017) ai ndodhej në qytetin e Vlorës, ndonëse është me banim në Tiranë.

Pikërisht veprimet aktive të të pandehurit Fredi Alizoti në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, e njëkohësisht të kundershëm lidhur me planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopërgjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e ketij audiopërgjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuuar kryerjen e një veprave penale të rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale për të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, e po kështu shfrytëzimin e ketij audiopërgjimi për realizimin e interesave politike për të pandehurin Ervin Salianji provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë shkakësore të veprimeve të bashkërenduara të secilit prej të pandehurve me pasojën e ardhur në fillimin e një procedimi penal ligjor të pabazuar dhe të mbështetur në prova të sajura e të rreme.

Është një fakt i provuar nga aktet provuese, vecanerisht nga përmbajtja e transkriptëve të bisedave telefonike të siperevidentuara midis të pandehurve, ku evidentohet dhe vertetohet pjesëmarrja aktive e të pandehurit Fredi Alizoti në të gjithë veprimtarinë e kundershëm se bashku me të pandehurit e tjerë Albert Veliu, Ervin Salianji e Jetmir Olldashit lidhur me planifikimin e veprimeve të tyre në rend kronologjik e të mirenduar për realizimin e ketij audiopërgjimi nga përgatitja e kushteve, mjeteve, vendit, subjekteve e deri në mënyrën e publikimit mediatik të tij dhe servirjen si krim i rende i kryer nga shtetasi Geron (Agron) Xhafaj.

Referuar rrethanave të faktit, provave të administruara në hetim e gjykim, paraqitja e ketij kallezimi nga i pandehuri bashkë me prova dokumentuese të sajura prej tij, kanë vënë në levizje organin procedues për kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e çështjes (duke harxhuar burimet njerëzore, vemendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme që i shërbejnë kesaj Prokurorie të Posacme për të hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtarie konkrete kriminale dhe jo ato të sajura), por që nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të ketij kallezimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurit nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tij për të filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, për qëllime fitimi shumëfish të caktuar monetare. I pandehuri Fredi Alizoti ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundershëm dhe për të siguruar të drejtat e lirisë e njeriut objekt i procedimit penal si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallezimet e tyre për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 të Gjykatës së Shkalles së Parë për Krimet e Renda Tirane është vendosur ; "Pushimi i hetimeve të procedimit penal nr 95/1 të vitit 2018 për veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal,pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë inkriminuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të këtij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurve nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tyre ne bashkepunim me vullnet e ndërgjegje të plotë se po kryenin një veprimtari të kundërligjshme duke paraqitur të dhëna të rreme për të iniciuar qellimisht një procedurë penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Nga ana subjektive kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri Fredi Alizoti ne bashkepunim me bashketepandehurit e tjere Albert Veliu, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi me faj, ne formen e dashjes direkte, me qellimin e posacem per te shkaktuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive te dobta (per te perfituar shuma monetare te premtuara nga i bashkepunehuri tjetër Ervin Salianji), veprime keto qe kane nje lidhje te drejteperdrejte shkakesore me pasojen e dëshiruar prej te pandehurit, cka e ben te qarte se ky i fundit i ka parashikuar pasojat e veprimeve te tij (kallëzimin e rreme ne organin procedues dhe inicimin e procedimit penal ndaj shtetasit te kallezuar Geron (Agron) Xhafaj) dhe njekoheesisht ka dëshiruar ardhjen e ketyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qellimin e posacem per te demtuar te drejtat e lirite e tij, reputacioni e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vellaits te tij ish-ministrit te brendshem ne kohen kur dhe eshte bere public ky kallezim i rreme. Në rastin konkret, te pandehurit kane bashkepunuar me njeri-tjetrin nepermjet marreveshjes paraprake te tyre per castin e volitshem dhe meynren e kryerjes se vepres penale si dhe ndarjen e roleve ne kete bashkepunim Albert Veliu dhe Ervin Salianji bashkeorganizatore, e njekoheesisht i pari edhe ekzekutor e dy te pandehurit e tjere njeri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (te katert kane kryer veprime aktive ne realizimin e audiopergjimit kompromentues te rreme me qellim adresimin mediatikisht e publikisht te nje kallezimi te rreme per kryerjen e nje krimi qe nuk eshte kryer ndaj nje shtetasi shqiptar per te iniciuar procedimin penal ndaj tij e per te perfituar materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vellaits te te kallezuarit, me cilesine e ish-ministrit te brendshem te kohes kur ky fakt ka ndodhur). Megjithese ata e parashikonin se nje kallëzim i tille publik e mediatik me nje përmbajtje të tillë do të bënte që organet proceduese kompetente të viheshin në lëvizje për të hetuar dhe proceduar penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kane lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale “Trafikimit të narkotikeve” të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Subjekt i kryerjes se kësaj vepre penale eshte i pandehuri Fredi Alizoti, i cili, nga hetimi gjyqesor rezultoi te jete i pergjegjshem para ligjit penal dhe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale.

Fajësia e të pandehurit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, veçanërisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqëritë e telefonise celulare perkatese, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklarimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Fredi Alizoti ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të “Kallëzimit të rremë të kryer në bashkepunim”, të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Fredi Alizoti, Gjykata bazuar ne nenet 47, 48, 49,50 te K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që vepra penale që i atribuohet të pandehurit përbën një krim dhe si e tille paraqet rrezikshmëri shoqërore, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezultoi në dënues me parë por fakti që kjo vepra penale eshte kryer ne bashkepunim qe e lehtëson arrijten e rezultatit kriminal është tregues i rrezikshmërisë se tij, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprave penale (dashje direkte), faktin që ai ka pranuar akuzën dhe ka shprehur pendesë dhe eshte paraqitur prane organeve kompetente pas kryerje vepre penale, moshën dhe nivelin arsimor të tij, motivin per interesa pasurore që e ka shtyrë në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, si dhe rolin e tij ne kryerjen e vepres penale si ekzekutor.

Gjykata vlerëson se për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të marrëdhënieve juridike të cenuara nga kjo vepër penale (veprimtaria e rregullt e organeve të drejtësisë dhe të drejtat e lirite e njeriut), si dhe faktit që i pandehuri e ka kryer këtë vepër nisur nga motive te dobta (politike), duke bërë që të ezaurohen në kohë, në vëmendje dhe në veprime procedurale të panevojshme shërbimet e Policisë Gjyqësore e të organeve proceduese, lloji i dënimit me burgim i kërkuar nga organi i akuzës për t'u caktuar ndaj të pandehurit për akuzën e atribuar, është ligjërishit i bazuar në dispozitën përkatëse penale.

Ndaj dhe Gjykata per sa u argumentua, ne rastin objekt shqyrtimi çmon qe dhenia dhe vaujtja fizikisht e sanksionit penal me burgim prej te pandehurit Fredi Alizoti, në masën e dënimit të vlerësuar nga Gjykata në dispozitiv të këtij vendimi gjyqësor, i përgjigjet rëndësisë së faktit, veprave penale të kryera nga i pandehuri, si edhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, që të çmuara në kompleksitet justifikojne ligjërisht këtë masë dënimi dhe realizimin e qëllimit kompleks të dënimit penal lidhur me riedukimin dhe ndëshkimin e të pandehurit, por edhe qellimin e parandalimit te pergjithshem ne shoqeri te kryerjes se kategorise se ketyre veprave penale qe cenojne e drejtat dhe lirite e individit dhe devijojne veprimtarine e organeve proceduese te drejtises per te luftuar kriminalitetin real dhe ekzistues, ne vend te atij virtual e te sajuar.

3. Për të pandehurin Jetmir Olldashi.

1-Përsa i perket elementeve te figures se vepres penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, per Gjykaten referuar arsytimit vijues, duke u mbeshtetur ne provat e sipercituara rezultoi e provuar qe i pandehuri Jetmir Olldashi ne bashkepunim me të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Salianji jane autoret e kryerjes se kesaj vepre penale dhe veprimet e tyre te bashkerenduara te kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqërore, kane cenuar objektin e veprës penale marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe lirite e individit, objekt i nje procedimi penal te regjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar per me teper ne sajimin e provave te rreme për të iniciuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas percaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e veprës penale “Kallëzim i rremë” kryhet nëpërmjet: *i)* kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; *ii)* kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallëzohet; ose *iii)* krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të iniciohet ndjekja penale.

Rezultoni e provuar qe i pandehuri Jetmir Olldashi ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e ne bashkepunim me te pandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Salianji, të cilat konsistojnë në planifikimin, pergatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te rreme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shperndarjen e ketij audiopergjimi dhe publikimin mediatik te tij duke i atribuar kryerjen e nje vepre penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qellimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale ne vlera monetare per te pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti.

Ka rezultuar e provuar qe me ndihmesen e të pandehurit Jetmir Olldashi (ne venien ne dispozicion te automjetit, shoqerimin, instruksioneve, gjetjes se vendit per realizimin e audiopergjimit) të dy të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar i tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i a ka dorëzuar të pandehurit Ervin Salianji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet. Sikurse rezultoi si gjatë hetimit dhe gjykimit, i pandehuri Jetmir Olldashi nuk

dorëzoi në asnjë moment regjistrimet origjinale që ai pretendon se janë bërë në Vlorë në datën 24.10.2017. Per kete shkak sipas Raportit te ekspertimit te zerit, ka rezultuar se regjistrimet nuk janë regjistrime origjinale. Regjistrimi video ishte marrë nga pamjet e mediave. Ajo përbëhet nga dy video, shkrim dhe dy biseda të regjistruara.

Deshmitari Arnedo Selmanaj shpjegoi përpara Gjykatës se në rolin e kameramanit dhe për llogari të një emisioni investigativ për çështje në ndjekje të parcelave të hashashit, kishte udhëtuar për në qytetin e Vlorës së bashku me të pandehurin Jetmir Olldashi dhe me një person që thirrej "babale". Në qytetin e Vlorës kishte takuar shumë individë por nuk kishte faktuar aq sa donin.

Deklarimet e bashketepandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti e po keshtu permbajtja e tabulateve telefonike per komunikimet e kryera midis te gjithe te pandehurve, faktojne e provojne bashkepunimin mes te pandehurve, dhe se ne muajin Tetor te vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë paraprakisht takim me të pandehurin Ervin Saliñji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike.

Publikimi i "audio-regjistrimit" të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Saliñji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiantal dhe i transkriptuar të zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhet në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiantal i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si "Bashkëpunëtori X", i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim "audio" të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar "Bashkëpunëtori X" dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim "video" prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat "Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë".

Vlen per t'u theksuar se veprimtaria kriminale e te pandehurit Albert Veliu ka iniciuar me realizimin e audiopergjimit te sajuar duke qene si protagonist dy te pandehurit Albert Veliu e Fredi Alizoti, me kontributin e te pandehurit Jetmir Olldashi, por kjo veprimtari është organizuar edhe me bashkepunimin e te pandehurit Ervin Saliñji si në drejtim të fabrikimit të këtij audiopërgjimi të rremë ashtu edhe në drejtim të parashtrimit publikisht ne media duke e adresuar drejtperdrejt ne organet proceduese, si një kallëzim penal (duke bere deklarata publike e adresuar ne organet e drejtesise fillimin e procedimit penal per veprimtari kiminale ne fushen e trafikimit te narkotikeve (te rreme) ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Kallëzimi publik e mediatik i bere dihet që është realisht i rremë, pasi në përmbajtjen e tij nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me te pandehurit Fredi Alizoti ,Ervin Saliñji e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës për kryerjen e një krimi ("Trafikimi i narkotikeve", të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, i atribuar nga te pandehurit Albert Veliu e Ervin Saliñji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale te sajua ne blerjen prej tij per trafikimi te nje sasive lende narkotike te deklarua nga te pandehurit sikur jane kryer nga personi qe eshte cenuar nga ky kallezim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, paraqitja e këtij kallëzimi publik dhe mediatik i perseritur nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me të pandehurit e tjerë (duke sajuar kallezim te rreme, prova te rreme e cdo fakt tjetër ne themel te ketij kallezimi te rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së parë per Krimet e Renda Tirane si organet kompetente per shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes.

I pandehuri Jetmir Olldashi ne bashkepunim me te pandehurit e tjere ka konsumuar vepra penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 te K.Penal me veprime aktive te kunderligjshme, te cilat konsistojne ne realizimin e nje veprimtarie ne kuader te bisedave telefonike audio te perjuara, teresisht te rreme per personin qe i atribuohet krimi dhe veprimtaria kriminale e trafikimit te narkotikeve e sajuar, duke passjelle kjo prove e rreme baze e nje kallezimi publik ne media e me tej duke investuar organet e ndjekjes penale, për ta konsideruar si një subjekt te mundshëm të dyshuar të nje veprimtarie kriminale ne fushen e narkotikeve, shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

I pandehuri Jetmir Olldashi me kontributin e tij ne kete veprimtari kriminale per fabrikimin e një prove të rreme te kryer ne bashkepunim me të pandehurit e tjerë sikundër më lart është analizuar, rrjedhimisht ka adresuar nje kallezim penal drejtuar Prokurorise se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, kallezim i cili dihet qe eshte realisht i rreme, pasi ne permbajtjen e tij nga te pandehurit jane dhene informacione qe nuk i pergjigjen te vertetes per kryerjen e nje krimi (Trafikim i narkotikeve, te parashikuar nga neni 283/a i K.Penal Shqiptar) qe ne te vertete nuk eshte kryer, i atribuar nga te pandehurit shtetasit te kallezuar Geron (Agron) Xhafaj, me qellim qe organet e drejtesise te fillonin ndjekjen penale ndaj ketij shtetasi.

Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese te sipercituara dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale qe kjo vepra penale te jete konsumuar nga i pandehuri Jetmir Olldashi ne bashkepunim me te pandehurit e sipercituar. Konkretisht rezultojne nje numer i konsiderueshem bisedash telefonike midis te pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike te perjuara te detajuara ne rrethanat e faktit vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës komprometuese që tregon bashkëpunimin midis tyre. Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara. Ne vijim ka rezultuar e provuar dënjia, pjesëmarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Saliñji me te pandehurit e tjerë ne kryerjen e vepres penale të atribuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë përcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Saliñji. Nga këto tabulate evidentohet se: -në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliñji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda; -në datën 20.10.2017, ora 10:23:36', numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliñji dhe biseda ka zgjatur 6 sekonda; -në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliñji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 23 sekonda; -në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliñji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 12 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19.49', numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 84 sekonda;

Këto të dhëna janë tregues që faktotje perfshtirjen aktive te bashketepandehurve Jetmir Olldashi e Ervin Salianji ne kryerjen e veprave penale ne bashkepunim me te pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vertetojne veprimtarine aktive te tyre ne pergatitjen e me tej fabrikimin e sajimit e provave te rreme, duke u angazhuar kohe me parë se te realizohej audiopergjimi kompromentues i sajuar midis te pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi.

Po keshu nga administrimi i Shkresës me nr.prot.4434/1, datë 18.9.2018, të shoqërisë Albtelecom sh.a, dokumentohet fakti se numri 0676494091, është në përdorim të abonentit Fredi Alizoti.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.2740/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Albtelecom sh.a, dokumentohet se numri celular 0692151212, është përdorim të abonentit Jetmir Olldashi.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate dalin të dhëna që evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë.

Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrezojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjetin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vertetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër regjistrimi në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Saliani.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa më shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e trasmetimit (antenat) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Pikërisht veprimet aktive të të pandehurit Jetmir Olldashi në bashkëpunim me të pandehurit e tjere, e njekohesisht te kunderligjshme lidhur me planifikimin, pergatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te rreme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, duke i atribuar kryerjen e nje veprave penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qellimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij, pavarësisht detyrës së tij si gazetar investigativ që e ngarkon edhe me me tepër përgjegjësi profesionale në ushtrimin korrekt të detyrës së gazetarit, provojnë lidhjen e drejteperdrejte shkakësore te veprimeve te bashkerendura te seicilit prej te pandehurve me pasojen e ardhur ne fillimin e nje procedimi penal ligjerisht te pabazuar dhe te mbeshtetur ne prova te sajura e te rreme.

Referuar rrethanave te faktit, provave te administruara ne hetim e gjykim, paraqitja e ketij kallezimi nga i pandehuri Albert Veliu bashke me prova dokumentuese te sajura prej tij, kane vene ne levizje organin procedues per kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e ceshtjes (duke harxhuar burimet njerezore, vemendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme qe i sherbejne kesaj Prokurorie te Posacme per te hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtarite konkrete kriminale dhe jo ato te sajura), por qe nga verifikimet dhe veprimet hetimore te kryera mbi bazen iniciuese te ketij kallezimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej te pandehurit nuk i pergjigjen te vertetes dhe jane kryer prej tij per te filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. I pandehuri Jetmir Olldashi ka cenuar marredheniet juridike te vendosura me ligj per te siguruar veprimtarine e rregullt e normale te organeve te drejtesise nga veprimet e kunderligjshme dhe per te siguruar te drejtat dhe lirite e njeriut objekt i procedimit penal si pasoje e veprimeve te paligjshme te personave qe abuzojne padrejtesisht me kallezimet e tyre per te inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane eshte vendosur ;'Pushimi i hetimeve te procedimit penal nr 95/1 te vitit 2018 per veprën penale te "'Trafikimit te narkotikeve" parashikuair nga neni 283/a K.Penal,pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë inkriminuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të këtij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurve nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tyre në bashkëpunim me vullnet e ndërjegjeje të plotë se po kryenin një veprimtari të kunderligjshme duke paraqitur të dhëna të rreme për të inicuar qellimisht një procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Referuar, analizës juridike dhe provave të analizuara si me sipër, Gjykata i konsideron të pabazuara pretendimet e mbrojtjesit të të pandehurit Jetmir Olldashi për deklarimin e pafajshëm të ketij të pandehuri, pasi vlereson se ndryshe nga sa mbrojtësi pretendon, tërësia e këtyre provave e implikojnë të pandehurin në kryerjen e veprimtarisë kriminale të sajimit e fabrikimit të provave të rreme me qellim inicimin e një procedimi penal të paligjshëm ndaj një shtetasi shqiptar.

Lidhur me kete rast dhe funksionin e të pandehurit si gazetar investigativ, Gjykata vlerëson me rëndësi të theksojë se liria e shprehjes është një e drejtë thelbësore e garantuar nga legjislacioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e te tretteve, apo autoriteteve publike duke respektuar kufijtë ligjor.

Liria e shprehjes, e shtypit, radios e televizionit, lirisë së informimit, si një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike dhe si një parakusht për të gëzuar të drejtat e tjera garantohet nga Neni 22 i Kushtetutës së Shqipërisë. Neni 22 i Kushtetutës, në të cilin thuhet se: “*Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar...*”.

Kjo e drejtë garantohet edhe nga neni 10 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut me titull “*Liria e shprehjes*”. Në nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut parashikohet se:

“1. *Çdo person ka të drejtën e lirise se shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë pjesë ose për të dhënë informata, ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...*

2. *Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, për integritetin territorial ose për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe për parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të parandaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.*

Për më tepër Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut i ka zgjeruar shumë kufijtë e lirisë së shprehjes. Kjo Gjykatë thekson se kjo e drejtë përfshin lirinë e zotërimit të bindjeve, si dhe të marrjes apo transmetimit të informacioneve dhe të ideve pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht kufijve shtetërorë, por nuk është e pakufizuar, për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve si edhe për shkak të ruajtjes së balancës mes nenit 10 dhe nenit 8 “*E drejta për respektimin e jetes private dhe familjare*” të K.E.D.NJ-së.

Kështu në rastin objekt trajtimi gjyqësor, veprimtaria e të pandehurit Jetmir Olldashi në cilësinë e gazetarit nuk është zhvilluar konform kornizave kushtetuese e ligjore të disiplinimit të veprimtarisë së tij, duke mos u mjaftuar me investigimin, administrimin e një informacioni me rëndësi për publikun dhe informimin mediatisht të publikut lidhur me të, përkundrazi, vlen të theksohet se pavarësisht detyrës së tij si gazetar investigativ që e ngarkon edhe me të tepër përgjegjësi profesionale e ligjore në ushtrimin korrekt të detyrës së gazetarit, është një fakt tashmë i provuar nga aktet provuese, pjesëmarrja aktive e të pandehurit Jetmir Olldashi në të gjithë veprimtarinë e kundershtimit të bashkuar me të pandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Saliانji lidhur me planifikimin e veprimeve të tyre në rend kronologjik e të miremenuar për realizimin e ketij audiopërgjimi të sajuar nga pergatitja e kushteve, mjeteve, vendit, subjekteve e deri në mënyrën e publikimit mediatisht të tij dhe servirjen si krim i rende i kryer nga shtetasi Geron(Agron) Xhafaj.

Në rastin “Karakó kundër Hungarisë”, Gj.E.D.Nj u shpreh se Konventa mbron nëpërmjet nenit 8, aspektet thelbësore të reputacionit të individit, siguron mbrojtje “nga pretendimet apo akuzat faktike të një natyre të tillë seriozisht ofenduese, saqë publikimi i tyre do të kishte një efekt të pashmangshëm, të drejtpërdrejtë në jetën private të kërkuesit” dhe jo thjesht në vlerësimin e jashtëm të individit. Cilido qoftë ky “prag”, është e qartë se Gj.E.D.NJ-ja njeh të drejtën e “reputacionit” dhe e nxjerr atë nga koncepti i jetës private.

Gj.E.D.NJ-ja në jurisprudencë e saj ka zbrëthyer raportin ndërmjet lirisë së shprehjes së individit, lirisë së shtypit, radios dhe televizionit, si dhe të drejtës së informimit. GJEDNJ i jep më tepër rëndësi disa elementëve si: pozicionit të deklaruesit dhe personit në cenuar, natyrës dhe objektivitetit të materialeve apo deklaratave të pretenduara dëmtuese, kualifikimit/cilësimit të tyre si dhe ekzistencës së provave për vërtetësinë e deklaratave cënuese.

Po kështu Komisioni i Venecias ka referuar një vendim të Dhomës së Lordëve në Britani, *rasti Reynolds*, ku janë evidentuar një listë faktorësh, për vlerësimin e balancimit mes dy të drejtave në konflikt:

1. *Serioziteti i pretendimit.* Sa më serioze të jetë akuzat, aq më shumë publiku është i keqinformuar dhe individit i dëmtuar – nëse pohimi nuk është i vërtetë.

2. *Natyrë e informacionit,* dhe shkalla në të cilën përmbajtja është një çështje me interes publik.

3. *Burimi i informacionit.* Disa informatorë nuk kanë njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjeve. Disa mund të kenë qëllimet e tyre dhe mund të paguhet për historinë që tregojnë.

4. *Hapat e ndërmarrë për të verifikuar informacionin.*

5. *Statusi i informacionit.* Pretendimet/akuzat mund të ketë qenë tashmë objekt i një hetimi, që duhet respektuar.

6. *Urgjenca e çështjes/lajmit.*

7. *Nëse është kërkuar koment nga paditësi për lajmin.* Ai mund të ketë informacione të tjera që nuk janë zbuluar.

8. *Nëse artikulli përmban edhe thelbin e këndvështrimit të palës paditëse* për historinë/lajmin.

9. *Toni i artikullit.* Një gazetë mund të ngrejë pyetje ose të kërkojë një hetim. Nuk duhet të pranohet pretendimet/akuzat si deklarata faktike.

10. *Rrethanat e botimit,* duke përfshirë kohën. “

Nga hetimi e gjykimi, ka rezultuar e provuar se të gjithë të pandehurit ishin në dijeni të këtij audiopërgjimi të sajuar për kryerjen e të cilit kanë kontribuar dhe kanë lejuar e dëshiruar publikimin e tij.

Nga ana subjektive kjo veprë penale është kryer nga i pandehuri Jetmir Olldashi në bashkëpunim me bashkëpandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Saliانji me faj, në formën e dashjes direkte, me qëllimin e posacem për të shkakuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive të dobta, veprime keto që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar prej të pandehurit, cka e ben të qartë se ky i fundit i ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij (kallezimin e rreme në organin procedues dhe iniciimin e procedimit penal ndaj shtetasit të kallezuar Geron (Agron) Xhafaj dhe njehkohesisht ka dëshiruar ardhjen e këtyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qëllimin e posacem për të demtuar të drejtat e lirite e tij, reputacionin e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vellaist të tij ish-ministrit të brendshëm në kohën kur dhe është bere publik ky kallezim i rreme. Në rastin konkret, të pandehurit kanë bashkëpunuar me njeri-tjetrin nëpërmjet marrëveshjes paraprake të tyre për castin e volitshem dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe ndarjen e roleve në kete bashkëpunim Albert Veliu dhe Ervin Saliانji bashkeorganizatore, e njehkohesisht i pari edhe ekzekutor e dy të pandehurit e tjere njeri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (te katert kanë kryer veprime aktive në realizimin e audiopërgjimit kompromentues të rreme me qellim adresimin mediatisht e publikisht të një kallezimi të rreme për kryerjen e një krimi që nuk është kryer ndaj një shtetasi shqiptar për të iniciuar procedimin penal ndaj tij e për të perfituar materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vellaist te te kallezuarit, me cilesine e ish-ministrit të brendshëm të kohes kur ky fakt ka ndodhur). Megjithëse ata e parashikonin se një kallezim i tillë publik e mediatisht me një përmbajtje të tillë do të bënte që organet proçeduese kompetente të viheshin në lëvizje për të hetuar dhe proçeduar penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kanë lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikeve” të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Subjekt i kryerjes se kësaj veprë penale është i pandehuri Jetmir Olldashi, i cili, nga hetimi gjyqësor rezultoi të jete i përgjegjshëm para ligjit penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.Fajësia e të pandehurit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, veçanërisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqërite e telefonise celulare perkatese, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklarimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Jetmir Olldashi ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të “Kallëzimit të rremë të kryer në bashkëpunim”, të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Jetmir Olldashi, Gjykata bazuar në nenet 47, 49,50, të K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që vepra penale që i atribuohet të pandehurit përbën një krim dhe si e tillë paraqet rrezikshmëri shoqërore, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezulton i

padënuar më parë por fakti që kjo veprë penale është kryer në bashkëpunim që e lehtëson arritjen e rezulttit kriminal është tregues i rrezikshmërisë së tij, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprave penale (dashje direkte), moshën dhe nivelin arsimor të tij, si dhe rolin e tij në kryerjen e veprave penale si ndihmesë.

Gjithësesi, në një vlerësim të hollesishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri Jetmir Olldashi, Gjykata e cmon të bazuar kërkimin e Prokurorisë për llojin e dënimit të kërkuar për t'u caktuar ndaj tij si dhe për aplikimin e nenit 63 të K.Penal në masën e dënimit të vlerësuar nga Gjykata të shprehur në dispozitiv të vendimit gjyqësor, zëvendësimin e tij pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke detyruar të pandehurin për kryerjen e një pune në interes publik, sipas përcaktimeve të shprehura në dispozitiv. Gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohen kriteret ligjore për shkak të cmuarjes së rolit të tij në këto bashkëpunim dhe rrethanave të tjera social-familjare të evidentuara nga Gjykata.

4. Për të pandehurin Ervin Salianji.

Persa i përket elementeve të figures së veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, për Gjykatën referuar arsytimit vijues, duke u mbështetur në provat e spërcituara rezultoi e provuar që i pandehuri Ervin Salianji në bashkëpunim me të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi kanë bashkëautorësinë e kryerjes së kesaj veprë penale dhe veprimet e tyre të bashkërenduara të kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqërore, kanë cenuar objektin e veprës penale marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e individit, objekt i një procedimi penal të regjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar për me tepër në sajimin e provave të rreme për të inçuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas përcaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e veprës penale “*Kallëzimi i rremë*” kryhet nëpërmjet: *i*) kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; *ii*) kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallzohet; ose *iii*) krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të inçiohet ndjekja penale.

Rezulton e provuar që i pandehuri Ervin Salianji e ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi, veprime këto të cilat konsistojnë në një kontribut relevant, të zgjatur në kohë e të qendrueshëm në planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopergjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e ketij audiopergjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuuar kryerjen e një veprë penale të rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inçimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e interesave politike për vetë dhe forcën politike të përfaqësuar (i pandehuri Albert Veliu është akomoduar në selinë e P.D-se ku dhe ka dhënë deklaratat e intervista mbi këto audiopergjime duke konfirmuar vërtetësinë e tij, i shtyrë për motive qifmbetje me të kallëzuarin dhe të perfitimeve monetare të premtuara ips tij për të dhe të pandehurin tjetër protagonist i vërtete në audiopergjim Fredi Alizoti.

Ka rezultuar e provuar që të dy të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar të tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i ka dorëzuar të pandehurit Ervin Salianji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Deklarimet e dhena në hetim të bashkëpandehurit Albert Veliu (subjekti iniciues dhe protagonist në audiopergjim, me precedente penale dhe i motivuar nga një ndjenje qefmbetje e dashakeqesie ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj) dhe deklarimet e të pandehurit Fredi Alizoti si në hetim e gjykim (ku ky i fundit pohon pjesëmarrjen e tij si një prej subjekteve bashkëbisedues në këto audiopergjim duke simuluar rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, e po kështu komunikimet e kryera midis të gjithë të pandehurve në kohë para dhe pas realizimit të audiopergjimit, mungesa e cdo qëllimi tjetër të mundshëm që të shpëjtoje komunikimet telefonike të shpeshta e zinxhir mes të pandehurve përgjate periudhës së realizimit të audiopergjimit e mbas tij, rezultatet negative të Raportit të ekspertimit të zërit, fakttojnë e provojnë bashkëpunimin e të pandehurve në kryerjen e kesaj veprë penale dhe se në muajin tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë paraprakisht takim me të pandehurin Ervin Salianji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, duke bashkëorganizuar këtë veprimtari kriminale.

Publikimi i “audio-regjistrimit” të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Salianji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi.

Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiantal dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhet në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiantal i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si “Bashkëpunëtori X”, i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim “audio” të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar “Bashkëpunëtori X” dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim “video” prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat “Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë”.

Vlen për t'u theksuar se dijenia dhe kontributi i të pandehurit Ervin Salianji në veprimtarinë kriminale të paramenduara nga i pandehuri Albert Veliu dhe të mireorganizuar me ndihmesën e të pandehurit Ervin Salianji dhe të bashkëpandehurve të tjerë Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi ka inçuar që në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, kur numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda. Ky komunikim që përveç motivit të kryerjes se ketij audiopergjimi, nuk i lidh të pandehurit me asnjë shkak tjetër të mundshëm e të njohur komunikimi (miq, të afërm, etj), dhe ka vijuar midis të pandehurve të tjerë përgjate disa muajve deri në publikimin e ketij audiopergjimi të rreme e pas tij.

Konkretisht ka rezultuar e provuar dijenia, pjesëmarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Salianji me të pandehurit e tjerë në kryerjen e veprës penale të atribuuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë ëprcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji. Nga këto tabulate evidentohet se: -në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda;

-në datën 20.10.2017, ora 10:23:36, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 6 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 23 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 12 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19.49', numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 84 sekonda;

Këto të dhëna janë tregues që faktotje përfshirjen aktive të bashketepandehurit tjetër Ervin Salianji në kryerjen e veprës penale në bashkepunim me të pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vërtetojnë veprimtarinë aktive të tij në përgatitjen e me tej fabrikimin e sajimin e provave të rreme, duke u angazhuar që disa kohe më parë se të realizohej audiopërgjimi kompromentues i sajuar midis të pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi, duke qenë ky i fundit nderlidhësi i tyre më pas.

Gjithashtu, veprimtaria kriminale e të pandehurit Ervin Salianji tej kontributit të tij për realizimin e audiopërgjimit të sajuar, ka avancuar e vijuar me bashkepunimin e të pandehurit Ervin Salianji edhe në parashtrimin publikisht në media duke e adresuar drejtperdrejt në organet proceduese të drejtësisë, të një kallëzimi penal (duke bere deklarata publike e adresuar në organet e drejtësisë fillimin e procedimit penal për veprimtari kriminale në fushën e trafikimit të narkotikëve (te rreme) ndaj shtetasit Geron(Agron) Xhafaj.

Deklarimi publik e mediatik i bere (i adresuar si kallëzim) dihet që është realisht i rremë, pasi në përmbajtjen e tij nga i pandehuri Ervin Salianji në bashkepunim me të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës për kryerjen e një krimi ("Trafikimi i narkotikeve", të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, bazuar në një audiopërgjimit të sajuar, i atribuar nga të pandehurit Albert Veliu e Ervin Salianji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale të sajura në blerjen prej tij për trafikimi të një sasive lende narkotike të deklaruara nga të pandehurit sikur janë kryer nga personi që është cenuar nga ky kallëzim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, paraqitja e këtij kallëzimi publik dhe mediatik i perseritur nga i pandehuri Ervin Salianji në bashkepunim me të pandehurit e tjerë (duke sajuar kallëzim të rreme, prova të rreme e çdo fakt tjetër në themel të këtij kallëzimi të rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së parë për Krimet e Renda Tiranë si organet kompetente për shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes.

Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese të sipercituara dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale që kjo veper penale të jete konsumuar nga i pandehuri Ervin Salianji në bashkepunim me të pandehurit e sipercituar. Konkretisht rezultojnë një numer i konsiderueshem bisedash telefonike midis të pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara të detajuara në rrethanat e faktit vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës kompromentuese që tregon bashkëpunimin midis tyre. Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklarimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara.

Në bisedat e zhvilluara me të pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkon të pandehurit Fredi Alizoti, që të "duronte" dhe pak sa të rregulloheshin punët.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate të dhëna evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë.

Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjetin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vërtetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Saliani, nga të dhënat telefonike të administruara, vërtetohet se:

-në datën 24.11.2017, ora 09.01', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 13 sekonda. Kjo bisedë është zhvilluar rreth një orë më parë, nga momenti kur i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek zyra e dëshmitarit Besim Hajdarmataj;

-në datën 24.11.2017, ora 16.30', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 22 sekonda. Kjo bisedë është realizuar rreth 4 minuta më pas nga kontakti telefonik që shtetasi Albert Veliu ka patur me punonjësin e SHISH-it, dëshmitarin Eduart Martini.

- në datën 25.11.2017, ora 10.21', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 69 sekonda.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa me shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën dhjetor 2017-janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e trasmetimit (antemat) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Pikërisht veprimet aktive të të pandehurit Ervin Salianji në bashkëpunim me të pandehurit e tjere, e njehoheshit të kundersligjshme lidhur me planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopërgjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e këtij audiopërgjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuar kryerjen e një veprë penale të rreme shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale për të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, e po kështu shfrytëzimin e këtij audiopërgjimi për realizimin e interesave politike për të pandehurin Ervin Salianji provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë shkakësore të veprimeve të bashkërenduara të secilit prej të pandehurve me pasojën e ardhur në fillimin e një procedimi penal ligërisht të pabazuar dhe të mbështetur në prova të sajura e të rreme.

Eshtë një fakt i provuar nga aktet provuese, veçanërisht nga përmbajtja e transkriptëve të bisedave telefonike të sipërvenditura midis të pandehurve, ku evidentohet dhe vërtetohet pjesëmarrja aktive e të pandehurit Ervin Salianji në të gjithë veprimtarinë e kundersligjshme së bashku me të pandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi lidhur me planifikimin e veprimeve të tyre në rend kronologjik e të mirëmbur për realizimin e këtij audiopërgjimi nga përgatitja e kushteve, vendit, subjekteve e deri në menyrën e publikimit mediatik të tij dhe shërbimit si krim i rreme i kryer nga shtetasi Geron (Agron) Xhafaj.

Referuar rrethanave të faktit, provave të administruara në hetim e gjykim, paraqitja e këtij kallëzimi nga i pandehuri bashkë me prova dokumentuese të sajura prej tij në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, kanë vënë në lëvizje organin procedues për kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e çështjes (duke harxhuar burimet njerezore, vendmendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme që i shërbejnë kësaj Prokurorie të Posacme për të hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtaritë konkrete kriminale dhe jo ato të sajura), por që nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të këtij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurit nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tij për të filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, për qëllime fitimi shumash të caktuara monetare. I pandehuri Ervin Salianji ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundersligjshme dhe për të siguruar të drejtat e liritë e njeriut objekt i procedimit penal si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 të Gjykatës së Shkalles së Parë për Krimet e Renda Tirane është vendosur: "Pushimi i hetimeve të procedimit penal nr 95/1 të vitit 2018 për veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal, pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë inkriminuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të këtij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurve nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tyre në bashkëpunim me vullnet e ndërjegje të plotë se po kryenin një veprimtari të kundersligjshme duke paraqitur të dhëna të rreme për të inicuar qëllimisht një procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Nga ana subjektive kjo veprë penale është kryer nga i pandehuri Ervin Salianji në bashkëpunim me bashkëpandehurit e tjerë Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi me faj, në formën e dashjes direkte, me qëllimin e posacem për të shkaktuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive të dobta (për interesa politike e diskreditim të personalitetit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe cenim të reputacionit e imazhit të vëllait të tij, ish-ministrit të Brendshëm të kohës kur ka ndodhur fakti), veprime këto që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar prej të pandehurit, cka e bën të qartë se ky i fundit i ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij (sajimin e provave të rreme (audiopërgjimi kompromentues i rreme) dhe kallëzimin e rreme duke e adresuar publikisht e mediatikisht drejt organit procedues dhe inicimin e procedimit penal ndaj shtetasit të kallëzuar Geron (Agron) Xhafaj) dhe njehoheshit ka dëshiruar ardhjen e ketyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qëllimin e posacem për të demtuar të drejtat e liritë e tij, reputacionin e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vëllait të tij ish-Ministrit të Brendshëm të Republikës së Shqipërisë në kohën kur dhe është bërë publik ky kallëzim i rreme.

Në rastin konkret, të pandehurit kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin nëpërmjet marrëveshjes paraprake të tyre për castin e vullnetshëm dhe menyrën e kryerjes së veprës penale si dhe ndarjen e roleve në këtë bashkëpunim Albert Veliu dhe Ervin Salianji bashkëorganizatore, e njehoheshit i pari edhe ekzekutor e dy të pandehurit e tjerë njëri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (të katert kanë kryer veprime aktive në realizimin e audiopërgjimit kompromentues të rreme me qëllim adresimin mediatikisht e publikisht të një kallëzimi të rreme për kryerjen e një krimi që nuk është kryer ndaj një shtetasi shqiptar për të inicuar proces penal ndaj tij e për të përfituar materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vëllait të të kallëzuarit, me cilesinë e ish-ministrit të Brendshëm të kohës kur ky fakt ka ndodhur). Megjithatë ata e parashikonin se një kallëzim i tillë publik e mediatik me një përmbajtje të tillë do të bënte që organet proceduese kompetente të vëshnin në lëvizje për të hetuar dhe procedim penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kanë lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale të "Trafikimit të narkotikeve" të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Fajësia e të pandehurit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, veçanërisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqëritë e telefonisë celulare perkatese, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa me shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017 (disa dite para realizimit të vidiopërgjimit).

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratim të dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Referuar, analizës juridike si me sipër, Gjykata i gjen te pabazuar pretendimet e mbrojtjes te te pandehurit Ervin Salianji per deklarimin e pafajshem te ketij te pandehuri, pasi vlereson se ndryshe nga sa mbrojtja pretendon, rezultatet e komunikimeve telefonike me të bashkëpandehurit e tjerë Albert Veliu e Jetmir Ollidashi qe implikojne te pandehurin Ervin Salianji ne kryerjen e veprimtarise kriminale te sajimit e fabrikimit te provave te rreme me qellim iniciimin e nje procedimi penal te paligjshem ndaj nje shtetasi shqipar, harmonizohen edhe me prova te tjera qe jane detajuar me sipër nga Gjykata.

Gjykata gjen me rëndësi të theksosë se pikërisht për shkak të funksionit që ky i pandehur ka pasur ne kohen kur ka ndodhur fakti penal në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, duhet të reflektonte në veprimtarinë e tij kushtetuese parimet themelore kushtetuese e veçanërisht respektimin e Kushtetutës e ligjit, dhe kursesi kjo veprimtari e tij nuk mund të konsiderohet e kryer brenda fushes së ushtrimit të funksionit të tij politik apo të ushtrimit të lirisë së shprehjes, përderisa sikundër Gjykata ka evidentuar me lart jurisprudencen e Gj.E.D.Nj-se ne trajtimin e nenit 10 te Konventës, një veprimtari e tillë duke bashkëorganizuar me të pandehurit e tjerë për të krijuar nje provë të rreme, një audiopergjim të sajuar, si themeli i nje deklarimi e kallezimi public mediatic per kryerjne e një krimi të rëndë, per interesa politikë me qellim iniciimin e ndjekjes penale e diskretitim te personalitetit te shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe cenim te reputacionit e imazhit te vellait te tij, ish-ministrit te brendshem te kohes kur ka ndodhur fakti, cenon te drejtat dhe lirite e individit, pengon dhe mbingarkon veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë, si dhe shkakton një impakt negativ tek publiku përcimi mediatic i provave te sajuara dhe deklaratave te tilla disinformuese, ndaj dhe nje veprimtari e tille kriminale është e papranueshme ne një shtet të së drejtës dhe si e tillë penalizohet nga K.Penal.

U provuan ne gjykim te gjithe elementet cilesues te ekzistences se bashkepunimit te te pandehurit Ervin Salianji me bashketepandehurit e tjere ne kete aktivitet kriminal qe jane: pluraliteti i personave (kater), realizimi i faktit kriminal ne te gjithe elementet e tij material (kallezimi i rreme qe perben faktin penal eshte ezauruar ne teresine e tij ne te dy format, ate te sajimit te nje prove te rreme qe eshte audiopergjimi dhe te adresimit mediaticisht e publikisht te nje kallezimi te rreme qe ne themel ka nje prove te rreme), seicili ka nje kontribut relevant te qendrueshem dhe deciziv ne ardhjen e pasojes (motivet e ndryshme, dijenia, komunikimet telefonike, instruksonet e mundshme per realizimin e audiopergjimit te rreme, ndihma per te gjetur njetin e pergjimit, venia ne dispozicion e nje gazetari, administrimi i proves se rreme, shfaqja e saj mediaticisht dhe adresimi qellimisht per te iniciuar procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, si dhe dijenia e vullneti i manifestuar dukshëm i seicilit prej bashkepunetoreve per te bashkepunuar me njëri-tjetrin ne kryerjen e faktit kriminal eshte evidente dhe e qarte ne analizen e faktit penal si me sipër eshte shtjelluar.

Subjekt i kryerjes se kësaj vepre penale eshte i pandehuri Ervin Salianji, I cili, nga hetimi gjyqesor rezultoi te jete i pergjegjshem para ligjit penal dhe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Ervin Salianji ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të “Kallëzimit të rremë të kryer në bashkepunim”, të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Ervin Salianji, Gjykata bazuar ne nenet 47, 49,50, te K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që vepra penale që i atribuohet të pandehurit përbën një krim dhe si e tillë paraqet rrezikshmëri shoqërore, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezultoi i padënuar më parë por fakti që kjo veper penale eshte kryer ne bashkepunim dhe qe e pare lidhur edhe me funksionin e tij kushtetues si deputet i Kuvendit te Shqiperisë ne kohën kur ka ndodhur fakti penal, qe e lehtësojne arrijten e rezultatit kriminal janë tregues i rrezikshmerise se tij, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprave penale (dashje direkte), moshën dhe nivelin arsimor të tij, motivin per interesa politike që e ka shtyrë në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, si dhe rolin e tij ne kryerjen e veprës penale si bashkeorganizator.

Gjykata vlerëson se për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të marrëdhënieve juridike të cenuara nga kjo veper penale (veprimtaria e rregullt e organeve të drejtësisë dhe të drejtat e liritë e njeriut), si dhe faktit që i pandehuri e ka kryer këtë veper nisur nga motive te dohta (politike), duke bërë që të ezaurohen në kohë, në vëmendje dhe në veprime procedurale të panevojshme shërbimet e Policisë Gjyqësore e të organeve proceduese, lloji i dënimit me burgim i kërkuar nga organi i akuzës për t'u caktuar ndaj të pandehurit për akuzën e atribuar, është ligjërisht i bazuar në dispozitën përkatëse penale.

Gjithsesi, në një vlerësim të hollesishem të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, Gjykata e gjen te pabazuar ligjrisht kerkesene nje prej perfaqesuesve te akuzes per te aplikuar nenin 59 te K.Penal ndaj te pandehurit.

Gjykata per sa u argumentua, ne rastin objekt shqyrtimi çmon qe dhenia dhe vuajtja fizikisht e sanksionit penal me burgim prej te pandehurit Ervin Salianji, në masën e dënimit te vlerësuar nga Gjykata ne dispozitiv të këtij vendimi gjyqësor, i përgjigjet rëndësisë së faktit, veprës penale të kryer nga i pandehuri, si edhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, që të çmuara në kompleksitet justifikojne ligjërisht këtë masë dënimi dhe realizimin e qëllimit kompleks të dënimit penal lidhur me riedukimin dhe ndëshkimin e të pandehurit, por edhe qëllimin e parandalimit te pergjithshem ne shoqeri te kryerjes se kategorise se ketyre veprave penale qe cenojne e drejtat dhe lirite e individit dhe devijojne veprimtarine e organeve proceduese te drejtësisë per te luftuar kiminalitetin real dhe ekzistues, ne vend te atij virtual e te sajuar.

Lidhur me provat materiale te sekuestruara e te pasqyruara ne Proçesverbalet përkatëse të sekuestrimit te sendeve te ndodhura ne fashikullin hetimor (konkretisht: një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637, një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091, Gjykata në mbeshetje te nenit 190/1(ç) te K.Pr.Penale urdheron t'i kthehen pronarit te ligjshem të pandehurit Fredi Alizoti.

Persa i perket percaktimit te llojit te sigurise te Institucionit te ekzekutimit te denimit penal dhe konkretisht vendit te vuajtjes se denimit penal me burgim per te pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Salianji, ne referim te dispozitave te Ligjit 8328 dt.16.4.1998 “Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim dhe te paraburgosurve” te ndryshuar, Gjykata çmon qe vuajtja e denimit penal me burgim nga tre te pandehurit te kryhet ne nje burg te sigurise se zakonshme.

Së fundi, persa i perket detyrimit ligjor per pagimin e shpenzimeve procedurale hetimore e ato gjyqesore te parapaguara nga shteti, ne referim te neneve 392, 393 te K.Pr.Penale, keto te fundit i ngarkohen solidarisht te pandehurve.

PËR KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 297, 305, 25, 47, 49,63 të K.Penal dhe në nenet 379,383 dhe 384 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I:

1.Të deklarohet fajtor të pandehurin **Albert Veliu** për veprën penale “**Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror**”, dhe në bazë të nenit **297** te Kodit Penal, e dënon me **10(dhjetë) muaj burgim**.

–Të deklarohet fajtor të pandehurin **Albert Veliu** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** te Kodit Penal, e dënon me **2(dy) vjet e 10(dhjetë) muaj burgim**.

-Ne aplikim te nenit 55 te Kodit Penal, ne bashkim te denimeve, denimin e te pandehurit **Albert Veliu** me **3 (tre) vjet e 5 (pese) muaj burgim**.

-Afati i vuajtjes së dënimit për të pandehurin **Albert Veliu** fillon nga dita e kapisjes së tij pasi ky vendim te marr forme te prere.

-Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Albert Veliu**, do kryhet në një nga burgjet e sigurise së zakonshme.

2. Të deklarohet fajtor të pandehur **Fredi Alizoti** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** të Kodit Penal, e dënon me **2(dy) vjet burgim**.
-Afati i vuajtjes së dënimit për të pandehur **Fredi Alizoti** fillon nga data e masës shtrënguese personale “Arrest në burg”.
-Vuajtja e dënimit për të pandehur **Fredi Alizoti**, do kryhet në një nga burgjet e sigurisë së zakonshme.
- 3.Të deklarohet fajtor të pandehur **Jetmir Oldashi** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** të Kodit Penal, e dënon me **6(gjashtë) muaj burgim**.
-Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin e të pandehurit **Jetmir Oldashi** për të kryer **100(njeqind)** orë pune në interes publik.
-Detyrohet i pandehuri të mbajë kontakte me Zyren e Sherbimit të Proves të vendbanimit të tij.
- Heqjen e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhene me vendimin **Nr.2103 Regj.Them datë 12.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane**.
- 4.Të deklarohet fajtor të pandehur **Ervin Salianji** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** të K.Penal,e dënon me **1(një) vit burgim**.
-Vuajtja e dënimit për të pandehur **Ervin Salianji**, fillon nga dita që ky vendim merr formë të prete.
-Vuajtja e dënimit për të pandehur **Ervin Salianji**, do kryhet në një nga burgjet e sigurisë së zakonshme.
-**Provat materiale** të sekuestruar bazuar në nenin 190, pika 1, gërma “ç”, të K.Pr.Penale, konkretisht :
1.Një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637
- 2.Një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091, t’i kthehen të pandehurit **Fredi Alizoti**.
-Shpenzimet procedurale të fazës së hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore, janë në ngarkim të të pandehurve në mënyrë solidarë.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palet brënda 15(pesëmbëdhjetë) diteve në Gjykatën e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi. Një kopje e këtij vendimi t’i komunikohet përfaqësuesve të viktimes.

U shpall në Tirane, sot më datë **18.12.2019**.

SEKRETARE
Ornela BALLA

GJYQTAR
Artan GJERMËNI

Republika e Shqipërisë

Gjykata e RRETHIT GJYQËSOR TIRANE

Nr.1862 REGJ.THEM.

NR.2900 vendimi

VENDIM

“Në EMËR Të rEPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë prej :

GJYQTAR -ARTAN GJERMËNI

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ornela Balla**, në Tirane, sot me datë **18.12.2019** mori në shqyrtim ne seancë gjyqësore publike, me gjykim të zakonshëm, çështjen penale me:

KËRKUESE:Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane e perfaqësuar nga **prokuroret Genci Qana dhe Kolë Hysenaj**
NDAJ TË PANDEHURËVE:

Albert Veliu, i biri i Egerem dhe Abe, i dtl.19.01.1967, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Lagjia “4 Heronjtë”, Rruga: “Isa Boletini”, Pall.1004, Shk. I, Kat. II-të, Vlorë, me arsim 10 klasë, i martuar, me dy fëmijë, hetuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg” në mungesë, i deklaruar në mungesë në gjykim (i ikur) i mbrojtur nga mbrojtjesja e caktuar kryesisht **Elena Ullorja**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale “**Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror**” dhe “**Kallzimi i rremë**” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 297, 305 e 25 të K.Penal .

Fredi Alizoti, i biri i Elmaz dhe i Ildize, i dtl.13.04.1973, lindur dhe banues në Fier, Lagjia “1 Maji”, i divorcuar, me arsim 8-vjeçar, i pranishëm në gjykim, i hetuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg”, i mbrojtur nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij **Illir Dode**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “**Kallzimi i rremë**” i kryer në bashkëpunim të

parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Jetmir Oлдashi, i biri i Tahir dhe i Fatime, i dtl. 30.05.1981, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Mikel Maruli", i padënuar, i divorcuar, me arsim të lartë, hetuar me masë sigurimi "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", i deklaruar në mungesë në gjykim, përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur **Indrit Sefa**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Kallzimi i rremë" i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Ervin Salianji, i biri i Bujar dhe Shegë, i dtl. 16.01.1988, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Asim Vokshi", i padënuar, me arsim të lartë, hetuar në gjendje të lirë, i mbrojtur nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij **Ledio Braho**.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Kallzimi i rremë" i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

VIKTIMA/KALLËZUES: **Geron (Agron) Xhafaj**, i biri i Sezai dhe Elpiniqi, i dtl. 08.06.1975, lindur e banues në Vlorë, Lagjia: "Isa Boletini", Rruga "Mehmet Petoshati", Nd. 45, H. 3, Apt. 32, në mungesë, i përfaqësuar nga Av.Ardian Visha dhe Av.Arben Prenga (sipas Prokurës Nr. 2554 Rep., Nr. 717 Kol., dt. 15.05.2018).

Gjykata pasi dëgjoji pretendimet e palëve dhe mori provat e nevojshme, dëgjoji përfundimisht palët që kërkuan:

Perfaqësuesit e Prokurorisë kërkuan:

- 1-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Albert Veliu** për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale "Kallzimi i rremë", parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.
Deklarimin fajtor të pandehurit **Albert Veliu** për kryerjen e veprës penale "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror", parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.
Duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 55 të Kodit Penal për caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e të pandehurit **Albert Veliu**, me 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.
Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Albert Veliu**, të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
- 2-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fredi Alizoti**, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale "Kallzimi i rremë", parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.
Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Fredi Alizoti**, të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
- 3-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervin Salianji**, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale "Kallzimi i rremë", parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
Në lidhje me këtë të pandehur, prokurori Genci Qana ndryshe nga prokurori Kolë Hysenaj kërkon që në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, të bëhet pezullimi i ekzekutimit të vendimit për një periudhë 3 (tre) vjeçare, duke urdhëruar të pandehurin që të mbajë kontakte me shërbimin e provës.
- 4-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Jetmir Oлдashi**, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale "Kallzimi i rremë", parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.
Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i pandehuri Jetmir Oлдashi të përmbushë një punë në interes publik, për një kohë prej 200 (dyqind) orë.
- 5-Bazuar në nenin 190, pika 1, gërma "ç", të K.Pr.Penale, një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637 dhe një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091, t'i kthehen të pandehurit Fredi Alizoti.
- 6- Shpenzimet proceduriale në shumën prej 50000 lekë dhe 13547 GBP (paund britanik), të kryera gjatë hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore në masën që do të përcaktohen nga Gjykata, t'i ngarkohen solidarisht të pandehurve.

Mbrojtësia e të pandehurit Albert Veliu kërkoi:Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Albert Veliu.

Mbrojtësi i të pandehurit Fredi Alizoti kërkoi:Denim me të ulët.

Mbrojtësi i të pandehurit Jetmir Oлдashi kërkoi: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, pasi fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si veprë penale bazuar në nenin 388/1(a,c).

Mbrojtësi i të pandehurit Ervin Salianji kërkoi: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, pasi fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si veprë penale bazuar në nenin 388/1(a,c).

I pandehuri Ervin Salianji kërkoi:Deklarimin e pafajshëm.

Gjykata, pasi dëgjoji pretendimet e palëve në seancë gjyqësore dhe si shqyrtoi në tërësi provat e marra në gjykim në lidhje me çështjen,

V Ë R E N:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën për gjykimin e çështje penale në ngarkim të të pandehurit Albert Veliu i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror", dhe "Kallzimi i rremë i kryer në bashkëpunim" të parashikuara nga nenet 297, 305 e 25 të K.Penal, si dhe në ngarkim të të pandehurve Fredi Alizoti, Jetmir Oлдashi dhe Ervin Salianji, të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Kallzimi i rremë i kryer në bashkëpunim" të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Me Vendimin Nr.1940 Regj.Them. ,datë 12.04.2019, gjyqtari i seancës paraprake, pasi është njohur me kërkesën për gjykim dhe aktet e dosjes së këtij procedimi penal, ka disponuar për dërgimin për gjykim të çështjes penale objekt trajtimi gjyqësor.

Gjykata konstatoi se në seancën paraprake, i pandehuri **Fredi Alizoti** dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij **Av. Ilir Doda** kanë parashtruar kërkesën për të proceduar me gjykim të shkurtuar të çështjes penale në respektim të nenit 403/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Përpara çeljes së shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, i pandehuri i pranishëm konfirmoi para kësaj Gjykate qëndrimin e tij për të vijuar me gjykim të shkurtuar të çështjes duke u kërkuar edhe vecimi i çështjes.

Gjykata me vendim e saj të ndërmjetëm të datës 12.06.2019 në zbatim të neneve 93 e 405 të K.Pr.Penale disponoi të mos e panojë kete kerkese, duke vlerësuar se çështja në ngarkim të të pandehurit Fredi Alizoti nuk mund të zgjidhet në gjendjen e ndodhur të akteve në dosje, për shkak se gjykimi penal zhvillohet ndaj disa të pandehurve, ku pjesa tjetër nuk e kanë parashtruar këtë kërkesë dhe akuzat për kryerjen e veprës penale “Kallzimi i remë” është e cilesuar me elementin e kryerjes në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal për të gjithë të pandehurit (pengese ligjore kjo e specifikuar në nenin 93/ç të K.Pr.Penale) dhe ndarja e çështjes do të sillte një dëm hetimit gjyqësor si dhe vertetimit të fakteve objekt gjykimi.

Referuar shqyrtimit gjyqësor, rrethanat e faktit të çështjes lidhur me këtë procedim penal kanë rezultuar si vijon:

Në datën 14.05.2018, rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës).

Publikimi është bërë nga i pandehurit Ervin Salianji dhe shtetasi Enkelejd Alibeaj në cilësinë e deputetit, si dhe shtetasi Gazment Bardhi në cilësinë e funksionarit të PD-së. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiantal i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si “Bashkëpunëtori X”, i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim “audio” të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar “Bashkëpunëtori X” dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim “video” prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat “Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e rreguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë”.

Mbi bazën e këtij publikimi, në datën 17.05.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka regjistruar Procedimin penal Nr. 95, për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal dhe hetimet e mëtejshme në kuadër të këtij procedimi nuk evidentuan ndonjë të dhënë apo indicie inkriminuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Salianji, në bashkëpunim me njëri tjetrin dhe nisur nga motive personale të ndryshme, kanë krijuar një provë të rreme në formën e një “audio-regjistrimi”, me qëllim ngritjen e një dyshimi se nga shtetasi Geron (Agron) Xhafaj, ishte konsumuar një veprë penale në fushën e narkotikëve. Rreth muajit Tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë takim me të pandehurin Ervin Salianji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike. Në këtë takim, i pandehuri Albert Veliu i ka bërë të ditur të pandehurit Ervin Salianji se donte të çonte në burg shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, pasi kishte një inat të mëparshëm me të, për shkak të një qëndrimi në burg në Itali. Ai është vetëofruar dhe ka garantuar, se kishte mundësinë që të grumbullonte të dhëna komprometuese për aktivitetin kriminal në fushën e narkotikëve që shtetasi Geron (Agron) Xhafaj, ushtronte në rrethin e Vlorës. Në bisedë midis tyre, i pandehuri Ervin Salianji i ka premtuar të pandehurit Albert Veliu se do të përfitonte një shpërblyem në vlerë prej 200 mijë eurosh, në rast se do të sillte të dhëna që inkriminonin shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në vijim, i pandehuri Ervin Salianji ka mundësuar kontaktin midis të pandehurit Albert Veliu dhe të pandehurit Jetmir Olldashi, i cili në atë kohë punonte si gazetar investigativ tek emisioni “Të paeksponuarit” pranë televizionit “News 24”.

Mbasi janë takuar me njëri tjetrin, të pandehurit Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi, kanë vendosur që të shkojnë në qytetin e Vlorës, me qëllim që të regjistrojnë shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe të shkonin në vendet ku ky i fundit mendohej se ushtronte aktivitetin kriminal. Në mëngjesin e datës 24.10.2017, të pandehurit Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi, janë nisur për në qytetin e Vlorës me një automjet që i pandehuri Jetmir e kishte marrë me qira dhe së bashku me ta ka qenë edhe dëshmitari Arnedo Selmanaj, si kameraman i emisionit investigativ “Të paeksponuarit”. Mbasi kanë arritur në qytetin e Vlorës, i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek lokali në pronësi të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, por nuk ka mundur që t’a takojë dhe komunikojë me të, mbasi nuk ndodhej aty. Në vijim, ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë ecur me makinë në drejtim të fshatit Radhimë dhe Tragjias të rrethit Vlorë, për të marrë kontakt me personat që mund të dispononin lëndë narkotike dhe të kryenin filmimet e nevojshme. Më pas, ata janë rikthyer në qytetin e Vlorës dhe me gjithë përpjekjen e bëra, nuk kanë mundur që të kontaktojnë shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, apo të bëjnë ndonjë regjistrim bisede me të.

Nisur nga fakti që deri në atë kohë nuk kishte arritur që të realizonte ndonjë regjistrim me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, në datën 23.11.2017, rreth orës 16:00, i pandehuri Albert Veliu në marrëveshje me të pandehurin Ervin Salianji, ka shkuar në zyrën e dëshmitarit Besim Hajdarmataj, me detyrë drejtues i Prokurorisë pranë Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Në këtë takim, i pandehuri Albert ka pretenduar se kishte informacione që në ditët e ardhshme do të trafikohej një sasi lëndë narkotike për në Itali dhe se personat që do të bënin trafikimin ishin punonjës policie si dhe shtetasi Geron (Agron) Xhafaj, vëllai i Ministrit të Brendshëm të asaj kohe.

Në datën 24.11.2017, rreth orës 10:00, dëshmitari Besim Hajdarmataj ka mundësuar takimin në zyrën e tij, të të pandehurit Albert Veliu me dëshmitarët Albert Tuci dhe Eduard Martini, me detyrë punonjësit të SHISH. Mandej punonjësit e SHISH-it kanë vijuar me procedurat duke e pajisur të pandehurin Albert Veliu, me një pajisje përgjimi në formën e një puliti automjeti.

Rreth orës 15:00'-15:30', të datës 24.11.2018, punonjësit e SHISH dhe i pandehuri Albert Veliu kanë arritur në qytetin e Vlorës, ku ky i fundit u ka shpjeguar se, me personat do të takohej tek lokali “2 Palmat”. Mbas rreth gjysëm ore, i pandehuri Albert Veliu ka telefonuar punonjësit e SHISH-it me qëllim për t’u dhënë pajisjen përgjuese dhe në momentin e takimit u ka thënë se kishte takuar një person me emrin Agron, por pa u thënë mbiemrin. Ai gjithashtu u ka thënë se nuk e kishte përfunduar bisedën për trafikimin e narkotikëve pasi kishte lënë një takim ditën e nesërme me një shtetas të quajtur Ermal dhe për të kryer ndonjë regjistrim të mundshëm, punonjësit e SHISH-it i kanë lënë një tjetër mjet përgjimi të kamufluar si “usb”. Ndërkohë që, e kanë porositur se në momentin që do merrte kontakt me Ermalin, t’i njoftonte për vendin dhe orën e takimit.

Në datën 25.11.2017, rreth orës së drekës i pandehuri Albert Veliu ka telefonuar punonjësit e SHISH-it dhe u ka kërkuar të shkonin në Vlorë. Mbasi është takuar me ta në rrugë tek “Lungomare”, ai u ka shpjeguar se ishte takuar me Ermalin, por nuk kishte regjistruar bisedë me interes për çështjen, mbasi kishte patur edhe persona të tjerë në tavolinë. Ai u ka kërkuar dhjetë mijë lekë të reja për të ngrënë një drekë me Ermalin dhe aty të bënte edhe përgjimin e bisedës, por kjo kërkesë është refuzuar nga punonjësit e SHISH-it. Në vijim, i

pandehuri Albert Veliu u ka kërkuar që të shkonin tek vendet ku mbahej hashashi apo mjetet, kërkesë që i është plotësuar nga punonjësit e SHISH-it. Komunikimi i të pandehurit Albert Veliu me punonjësit e SHISH ka vazhduar deri në datën 30.11.2017 dhe në përfundim të gjithë procedurës së kryer nuk rezultoi asnjë e dhënë inkriminuese (proceduriale apo informative) për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Në rrethanat kur nuk po mundte që të realizonte ndonjë regjistrim kompromentues me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të pandehurin Fredi Alizoti me të cilin kishte një njohje të vjetër dhe shumë miqësore. Në takimin midis tyre, i pandehuri Albert Veliu i ka kërkuar ndihmë të pandehurit Fredi Alizoti për të realizuar një regjistrim bisede midis tyre, ku ky i fundit do të luante rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, mbasi do të shpërbleheshin në shumën prej 200 mijë eurosh nga i pandehuri Ervin Saliqij. Përveç përfitimit material, i pandehuri Albert Veliu dhe familja e tij do të përfitonin edhe përfitimin e azilit politik në ndonjë shtet.

Fillimisht, i pandehuri Fredi Alizoti ka hezituar dhe nuk ka pranuar që të kryejë veprimin e kërkuar, por pas disa ditësh ai ka rënë dakort, i ndikuar nga këmbëngulja e të pandehurit Albert Veliu si dhe joshja nga përfitimi financiar në shumën prej 100 mijë eurosh (gjysma e shumës prej 200 mijë eurosh) që ai do të kishte. Të dy të pandehurit kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin Janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar i tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliqij, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Publikimi i "audio-regjistrimit" të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018, nga i pandehuri Ervin Saliqij atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiantal dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisede telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, është vazhduar me një regjistrim "audio" të një bisede ambientale të realizuar nga i pandehuri Albert Veliu në rolin e "Bashkëpunëtorit X" dhe i pandehuri Fredi Alizoti në rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, duke imituar zërin e këtij të fundit. Në fund, materiali i fabrikuar pason me një regjistrim "video" prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat "*Bashkëpunëtorit X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë*". Publikimi i materialit solli më pas edhe regjistrimin e një procedimi penal dhe kryerjen e hetimeve nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, të cilat në përfundim të tyre rezultuan pa ndonjë implikim për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj duke pasqyruar edhe pushimin e çështjes penale sipas vendimit nr 53 date 12.4.2019. Të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane

Në zbatim të planit të mëparshëm të tij, në datën 24.05.2018 i pandehuri Albert Veliu është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë duke kaluar në territorin e Republikës së Kosovës, jashtë vendeve të përcaktuara për kalimin e kufirit shtetëror. Në datën 28.05.2018, ai është paraqitur në policinë e Republikës së Kosovës dhe në datën 29.05.2018, ka kërkuar azil pranë zyrës përkatëse. Në vijim, mbasi është pajisur me certifikatën e statusit të azilkërkuesit me nr.1311, është lënë i lirë nga policia dhe aktualisht ndodhet i arrestuar nga autoritetet e Mbretërisë së Belgjikës, duke i'u nënshtruar procedurave të ekstradimit.

Sa më sipër, u provua në gjykimin e çështjes me provat e specifikuara më poshtë të paraqitura nga organi i akuzës dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, pjesë e fashikullit të gjykimin, ku theksohen dhe analizohen në fuqinë e tyre provues si vijon:

-Procesverbali për kryerjen e kqyrjes dt.14.05.2018, me anë të të cilit dokumentohet publikimi i materialit në daljen publike të dëshmitarëve Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi, si dhe të pandehurit Ervin Saliqij;

-Procesverbali për sekuestrimin e sendit dt.15.05.2018, me anë të të cilit dokumentohet fakti se shtetasit Enkeled Alibeaj i është sekuestruar një "DVD" në të cilën është i regjistruar materiali i publikuar në daljen publike të datës 14.05.2018;

-Procesverbal për sekuestrimin e sendeve dt.06.10.2018, me anë të të cilit dokumentohet fakti se të pandehurit Fredi Alizoti, i janë sekuestruar një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637 dhe një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091.

-Procesverbali për marrjen e dokumentit dt.15.05.2018, me anë të të cilit dokumentohet fakti se shtetasit Geron (Agron) Xhafaj i është marrë me cilësinë e dokumentit një regjistrimi "video" që ndodhet tek një "USB" e markës "VERBATIM", në një "folder" në formatin "MP4", i emërtuar (Deklarate PD).

-Procesverbali për marrjen e dokumentave dt.23.05.2018, me anë të të cilit është marrë në cilësinë e dokumentit një fotokopje e "Kontratë qiraje autoveturë", e datës 23.10.2017, me palë "qirramaës" të pandehurin Jetmir Oldashi dhe "qirradhënës" Iris Jaupaj dhe objekt dhënien me qira të automjetit me targë AA 283 SD. Pikërisht ky është automjeti, me të cilin të pandehurit Albert Veliu dhe Jetmir Oldashi, së bashku edhe me dëshmitarin Arnedo Selmanaj, kanë udhëtuar për në Vlorë, në datën 24.10.2017.

-Procesverbali për këqyrjen e sistemit TIMS dt.05.10.2018, nga ku dokumentohet se dalja e fundit për të pandehurin Albert Veliu nga territori i Republikës së Shqipërisë ishte regjistruar në datë 28.09.2017 dhe nuk evidentohet ndonjë shënim për dalje të tij në datën 24.05.2018.

-Shkresa Nr.4857 Prot., datë 05.06.2018, e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, me anë të të cilës është përcjellë fotokopje e regjistrimit të shërbimit të sallës së komandimit të DVP Fier. Nga të dhënat e fletës rezultojnë se në datë 01.06.2018, ora 16.00', i pandehuri Fredi Alizoti ka telefonuar nga numri telefonik 0676494091 dhe komunikimet vazhdojnë edhe në orën 16.30' dhe 16.48'.

-Shkresa Nr.FRS/2094/ES, datë 21.05.2018, e shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë të gjithë numrat telefonikë të kësaj shoqërie dhe që janë përdorur nga abonenti Albert Veliu;

-Raporti (ekspertimi) mbi krahasimet shkencore të folësve dt.6/09/2018, në të cilin është ekspertuar materiali i publikuar në datën 14.05.2018, duke e krahasuar me modelet e zërit të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, si dhe shtetasve Geron (Agron) Xhafaj dhe Agron Hyseni. Ky Akt ekspertimi i shqyrtuar dhe administruar me cilësinë e provës ka konkluduar se:Regjistrimet nuk janë regjistrime origjinale. Regjistrimi video ishte marrë nga pamjet e mediave. Ajo përbëhej nga dy video, shkrim dhe dy biseda të regjistruara. Këto dy biseda janë fokusi i analizës së ekspertit. Nuk ka qenë në gjendje të marrë regjistrimet origjinale të këtyre bisedave.

Biseda e parë: Biseda e parë ndodh në minutën 1 e 4 sekonda të kohës së videos dhe zgjat për 14 sekonda. Ajo duket të jetë një pjesë e një thirrjeje telefonike dhe folësit janë emërtuar 'Bashkëpunëtorit' dhe 'Agroni'; megjithatë, vetëm e folura që i atribuohet 'Bashkëpunëtorit' është e dëgjueshme (e kapshme) dhe për këtë arsye ekspertja ka ekzaminuar 'Bashkëpunëtorit' por jo 'Agroni' nga kjo bisedë.

Biseda e dytë: Regjistrimi i dytë, i cili është një bisedë e bërë ballë për ballë, ndodh në minutën 1 e 25 sekonda të kohës së videos. Ajo zgjat 1 minutë dhe 46 sekonda. Përsëri, ajo është një bisedë midis burrit të quajtur "Bashkëpunëtorit" dhe "Agroni". Në këtë regjistrim e folura nga të dy palët është e dëgjueshme (e kapshme). Ndërsa shumica e bisedës është midis "Agroni" dhe "Bashkëpunëtorit" ka shenja (të dhëna) që në sfond është edhe zëri i një burri të tretë. Regjistrimi nuk e përmban bisedën e plotë. Nuk ka hapje të bisedës apo

përhëndetje, gjëra të cilat për dikë janë të pritshme, si fillim kur palët takohen. Biseda vetë, është shumë e shkurtër dhe gjithashtu shfaqen ndryshime shumë të papritura, sa i takon temave të bisedës. Dy janë shpjegimet e mundshme: a) regjistrimi është një pjesë/pjesë të mbledhura nga një regjistrim më i gjatë, ose b) vetëm një pjesë e bisedës është regjistruar.

- Gjetendet mbështetje e fortë në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar “Bashkëpunëtori” në bisedën e parë është Albert Veliu;
- Gjetendet mbështetje e fortë e moderuar në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar “Bashkëpunëtori” në bisedën e dytë në fjalë është Albert Veliu;
- Gjetendet mbështetje e fortë në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar “Agroni” në bisedën e dytë në fjalë nuk është Agron Hyseni; Vërehen ndryshime të rëndësishme forensike midis zërit të ‘Agroni’ dhe atij të z. Hyseni.

Kampioni i bisedës në regjistrimin “Agroni” në bisedën e dytë, objekt ekspertimi, nuk është i përshtatshëm për të arritur në konkluzion (pozitiv ose negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj. Kampioni i ligjiëratës (të folurit) në ‘Agroni’ nuk është i mjaftueshëm (adekuat) për të arritur në konkluzion (pozitiv apo negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj. Kampioni “Agroni” është i një cilësie shumë të dobët. Arsyeja pse ekspertja ishte në gjendje të arrinte në një konkluzion negativ për z. Hyseni në lidhje me atë, lidhej me faktin se ai dhe “Agroni” kishin shumë dukshëm zëra të ndryshëm. Kjo nuk ishte kështu në lidhje si me z. Alizoti ashtu edhe z. Xhafaj. Ata janë zëra të ngjashëm si me njëri tjetrin ashtu edhe me “Agroni”, të paktën për sa ky i fundit mund të analizohet. Ekspertes do i duhej një regjistrim i një cilësie më të mirë të të folurës së “Agroni” për të arritur në një konkluzion (pozitiv ose negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj.

Sikurse vihet re, përfundimet e arritura në këtë ekspertim duke u parë në raport me deklaratimet e të pandehurit Fredi Alizoti dhe provat e tjera të marra gjatë këtij gjykimi e të analizuar gjatë këtyre konkluzioneve, tregojnë bindshem se zëri i subjektit “Agroni” nuk është zëri i shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

-Nga regjistrimet e përgjimeve të komunikimeve me telefon dhe transkriptet për numrat telefonikë 0698612599, 0695793764, 0695366327, 0696177770, 0685692692, 0695187565, 0676494091, 0692151212, 0694024321, 0697808251, 0685579637 dhe 0698621974, evidentohet se:

Në datë 18.05.2018, ora 13.13, përdoruesi i nr. të tel. 067 64 94 091 (i identifikuar më pas si i pandehuri Fredi Alizoti) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) dhe bëjnë këtë bisedë: 599- Alo, ore vella; 091-Ore ça po ben?; 599-Po ik o se jam ne prokurori mos mer o; 091- Eee?; 599- Hajd mos mer ne telefon vlla hajde.

Në datë 18.05.2018, ora 21.14, përdoruesi i nr. të tel. 067 64 94 091 (i identifikuar më pas si i pandehuri Fredi Alizoti) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) dhe veç të tjerash bëjnë edhe këtë bisedë: 091- po ato b...q...at do japin nai leke ata apo tja kthejme ndryshe ne?; 599- Ça thua e do i q...t motra prit te percjell dhe djaln o Fredi po me zien truri per djaln mua; 091- Ej – ore une te kam vella degjo mua, degjo mua, degjo nje minut le mua te mbaroj degjo mua; 599- He!?!; 091- Une nuk jam bukeshkale shpine time e ke hapur une ca te bej ty po une i qi e di ci bej atyre kurvave do japin nai leke apo jo une kaq po them; 599- Te percjelle njehere djaln e vogel pastaj flasim; 091 –Po te percjellim djaln se ja q... motren qe neser une; 599- Fredi nuk eshte muhabeti me te q... Fredi; 091-Jo jo ore; 599-Une nuk shkatërroj dy njerez qe kam lene lart ne fund te dynjase Fredi te kam vella te vejen ata ne ... pastaj flasim; 091- O vlla une te kam vlla dhe prape nuk e ve ne dyshim; 599- Atehere ca jane kto muhabete; 091 – Jane muhabete se ne e kupton vete ti;

Në datë 19.05.2018, ora 15.47, përdoruesi i nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 53 66 327 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 599- E flori ca ben ti? 327- Po rime po ngrohim veze; 599- Mire e motra e mora vesh qe po rri degjo se jam dhe me kte zoterine ktu une e mos kini merak fare se do behen te gjitha brenda dy diteve mbarojne e hotelin e pagojne kta neser mos kini merak. 327- Deri neser ne 12 e kam paguar une. 599- Na na fol njecik vete me kte na fol vete (flet person tjetër jo poseduesi i numrit telefonik) Alo.....

Në datë 20.05.2018, ora 09.25, përdoruesi i nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 61 77 770 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 599- Ku do takojme pime nje kafe? 770- Te thashe dhe dje do te marim vete. 599- O vlla une jam ne mes te kater rrugeve ne rregull e skam ça pres me tani vllai jot se jam shume i stresuar dhe i lodhur ka dhe te tjere per lart e per poshte sdua te flas ne telefon ka mundesi te takohesh pak 5 minuta”.....

Në datë 20.05.2018, ora 09.37, përdoruesi i nr. të tel. 069 86 12 599 (i pandehuri Albert Veliu) i dërgon sms përdoruesit të nr. të tel. 069 20 85 947(i pandehuri Ervin Salianji) me këtë përmbajtje: Mirmengjes duet te me takosh patjetr.

Në datë 20.05.2018, ora 19.55, përdoruesi i nr. të tel. 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) telefonon përdoruesin e nr. të tel. 069 53 66 327 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 692- E me thuaj se tani po ulem po flas me lart mos flas shume une tani ca te thane ata zoterinjtë aty? 327- Ata zotrinjtë ishin ane shoqerore e juaja nga ana e atit tjetrit? 692- Po e atit shokut tim po shokut tim nga Vlora po vazhdo. 327- Bravo vetem njeri nga ata edhe erdhen dy edhe thane ne kemi si urdher qe ik e gjejni nje shtepi nje muaj tha pastaj gjera te tjera jo. 692- Gjera te tjera sbejne asnje gje ata vetem shtepi nje muaj? Kaq te tha? 327-Po po po pastaj ne nuk dime tha se as njeri as tjetri nuk na kane sqaruar asnje gje.....692-Ka dhene urdher dikush te vijne t’ju marrin t’ju sistemojne e te gjitha ça te duan kshu eshte puna. 327- T’ja them hapur atyre? 692- Po me kane derguar thuaj e di vete ti emrin E-ja me L-ne.. 327- Nuk e di Berti kush na ka shkruaje me mesazh. 692- L-ja eshte ai i madhi krushku in E-ja eshte ai poshte. 327- Shkruaje nje mesazh Ledios Ledio te na e shkruaj ne. 692- L si Luli jot shoqa jote. 327- Puna eshte nuk duhet te flas une te flasin ata gojarisht dhe ata te jene se une te kure ika me urdher. 692-Mos fol shume ne telefon Luli me Ervinin kaq e di vete ai. 327-Kush? 692-Luli me Ervinin kaq.....

Në datë 22.05.2018, ora 17:01:51, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+692: Hajd te vendi vlla he hajde. +091: Ku në ç’vend?”.

Në datë 22.05.2018, ora 21:09:57, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+692: O vlla ik te dhoma se po vimë ngavash aty se ku jemi po presim ne edhe do vimë te dhoma te ...ik te hoteli ngavash ngavash. +091: E mirë hajd. +692: Hajde vlla...”.

Në datë 23.05.2018, ora 10:22:18, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 069 53 66 327 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmbajtje: “...+692: Sa të vi djali të veni direkt për azil politik. +327: Mirë mirë mirë. +692: Aty ambjenti mirë duket? +327: Mirë o Berti aman të keqen jemi brenda...”.

Në datë 24.05.2018, ora 19.35, përdoruesi i nr. të tel. 069 41 01 289 i dërgon sms përdoruesit të nr. të tel. 067 64 94 091 me këtë përmbajtje: “Do të të marrë mbas nja dy oresh se paska kalu deri ne maqedoni”

Në datë 22.05.2018, ora 17:01:51, përdoruesi i numrit telefonik 068 56 92 692 (i pandehuri Albert Veliu) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmajtje: "...+692: *Hajd te vendi vlla he hajde. +091: Ku në ç vend?*".

Në datë 27.05.2018, ora 21:17:08, përdoruesi i numrit telefonik 069 94 23 771 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmajtje: "...+091: *Ej po se, po s'jola me ty nuk flas me asnjëri në botë, dëgjo mua. +771: Po. +091: Më është afruar një gjë e mirë nga një pala tjetër e kupton tani muhabetin. +771: Po. +091: Janë të gjitha, unë i kam me... e ke parasysh?*".

Në datë 28.05.2018, ora 12.32, përdoruesi i nr. të tel. 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i nr. të tel. 068 20 29 700 dhe bëjnë këtë bisedë veç të tjerash: 700- Ej e more vesh? 091-He? 700-I arrestun ne Kosove ato shokun tend me djalin.....

Në datë 28.05.2018, ora 19:42:36, përdoruesi i numrit telefonik 068 20 29 700 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmajtje: "...+700: *Ej nuk e kam problem unë se ky shoku jonë që ishte sot ky ky i vje keq pak. +091: O vllai i thashë, o Salë i thashë unë ca të jenë i thashë unë ndajme të tre, në rregull në rregull po pse t'i lëmë këshu imotrën. ai duhet ta ulë në tavolinë e di si është muhabeti t'ja jap me...e ke parasysh ti?*".

Në datë 29.05.2018, ora 17:17:22, përdoruesi i numrit telefonik 068 20 29 700 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 dhe zhvilluan bisedën me këtë përmajtje: "...+700: *Edhe tha hajde tha, thuj Fredit hajd ta takojmë e të shkoj ta takoj vetë atë me dur të lidhje, ti thojmë o kshu o të fillojmë në krahin tjetër. +091: Po në rregull në rregull. +700: Më mirë kshu më mirë kshu tha Salu, shkoj unë e takoj. +091: O vlla unë ju kam vllëzër e unë. +700: E di Fredi, Fredi jemi shokë ne jemi shokë po shko tako Saluun e shkoni, tako atë*".

Në datë 29.05.2018, ora 21:00:02, përdoruesi i numrit telefonik 069 20 62 000 (i rezultuar gjatë bisedës si shtetasi Erzen Breçani) i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 (i rezultuar në tërësinë e bisedave të përgjuara si i pandehuri Fredi Alizoti) dhe, gjatë bisedës u fol: për premtimin që duhej të mbante dikush që e kishte dhënë atë: "...+000: ...unë nuk kam ditë gjo fare, as u kam thon hajdeni as hiç, por ai që ju ka premtue, ça u ka than, duhet t'u rri tek kamt e me ja marr. +091: Nuk kemi marrë asgjë akoma, po do llafosemi, do pimë kafe dhe do të sqaroj unë...+091: Jo me se me premtun diçka ktu, prit, eee e kupton ti..."; për dijeninë e Fredit rreth të dhënave që me shumë gjasa kanë lidhje me çështjen: "...+091: Çunat po e mbajnë nga brenda se thesin e kam unë, po ta hap unë thesin mbaron çdo gjë...e kupton vetë ti muhabetin..."; për vlerësimin nga Shkëlzen si gabim, nëse gjithçka ishte organizuar për të përfitur para: "+000: Në qoftë se i ka hy për lek, ka bo gabimin më të madh, e mo, o shoku jem, po ça boni o burr..."; për qënien e gjithçkaje të trilluar, të stisur, të pohuar si të tillë nga Fredi: "...+091: ...unë prap po rri fisnik, ato që janë premtuar...nuk kam marrë asgjë...edhe unë një llaflaf tani dhe përmbyset bota, kthehet nga e para e del çdo gjë fallco...kupton...+091: Janë fallco, janë fallco, po ta them me shpirt. +000: Eni pra mos u bini në qafë njerzve kur janë fallco, mos u binë në qafë njerzve kot o vlla"; për mundësinë e lidhjes së gjithçkaje të trilluar me synimin e marrjes së azilit: "...+000: Atë ditë e takova rastësisht Babalen dhe i thashë...vetja i thashë, ke hi i merr në qafë robt kot. +000: Me i bo letrat për azil, nuk e di si i boni kto punë. +091: është e vërtetë kjo ke vllai, është e vërtetë...".

Në datë 01.06.2018, ora 16.50, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) i telefonon nr. 355129 dhe bëjnë këtë bisedë:091-dëgjo mua, dëgjo mua..je, një sekondë do më dëgjosh me vëmendje, a më dëgjon? 129-po ju dëgjoj zotri fol 091-ajo dëshmi e babales është fallso, edhe unë jam ai origjinali. 129-mirë, mirë, ja po të merr drejtori në telefon tani lëre atë e di un....

Në datë 01.06.2018, ora 16:52:23, përdoruesi i numrit telefonik 069 41 10 316 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 067 64 94 091 (ndërsa më parë midis tyre ishin realizuar disa komunikime ku i kërkohet përdoruesit të numrit telefonik 069 41 10 316, i rezultuar drejtues i policisë në Qarkun Fier, nga komunikuesi takim për diçka shumë të rëndësishme) dhe zhvilluan bisedën me këtë përmajtje: "...091- ajo që është bërë mes telefonatave dhe përgjimi kam qenë unë që e kam bërë atë Ai që është bërë në përgjime.....ajo që është bërë me babalen në përgjime....kam qenë unë që e kam bërë..... 316- me kë ke qenë kur e ke bërë? 091-me babalen, me asnjë tjetër. 316-nuk ke qenë ti nuk ke qenë bashkë me Agronin? 091-jo, jo ka qenë babalja unë kam qenë në vend të Agronit. 316- je i sigurt për këtë? +091: Jam i sigurt, më dëgjo mua do më dëgjosh me vëmendje, më dëgjo mua, edhe do të flisja me fakte....na premtuan 200 (dyqind) mijë Euro unë s'kam marrë asgjë, i mori Berti 70 (shtatëdhjetë) mijë Euro dhe iku e kupton, jam i sigurt dhe me dorë në zjarr...".

Në datë 01.06.2018, ora 16:56:52, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 i telefonoi përdoruesit të numrit telefonik 068 20 29 700 dhe, zhvilluan bisedën me këtë përmajtje: "+091: *E morën vesh se ja thash gjitha unë historin, tani të marim ndonjë ej, aa do e shikosh në televizor, mua hajd ik, kalofsh mirë...*".

Në datë 05.06.2018, ora 14:32, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 069 94 23 771 dhe zhvillojnë këtë bisedë: "...771-ani vlla, ej i thashe une dicka atyne-I thashe me duket se po ja kerces atej nga ana tjetere. 091-jo, ja kercita une ja kercita. 771- ej me tha ai me gisht te keputun thuj te vije te me takoj s di gje thashe une s ma ka hap telefonin.

Në datë 05.06.2018, ora 18:47, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dysohet te jete i pandehuri Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: "... 272-e mire shume mire hajde vlla hajde-edhe degjo vetem kaq mendo per femijet e mi asgje ne bote ca takon mbaro punen e mendo per femijet e mi qe kam rrugeve po je vellai im. 091-e kam lene per me vone me ate pune. 272-po mire e mire dakort mendo per femijet e mi kaq. 091-e ore e mos e vri mendjen nga ajo pune tip o eij I ka gati ato ai?.....

Në datë 05.06.2018, ora 21:05, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 0694101289 dhe zhvillojnë këtë bisedë: "... 091-mire mo ne rregull po sonte ku do rri une si keni marre masat mire ku do rri sonte. 289-ku do rrih sonte? 091-po 289-po fol ijer me Saluun mos ashu rri ke Salu sonte rri ke Salu sonte fol ma Saluun njehere.....

Në datë 05.06.2018, ora 21:33, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dysohet te jete i pandehuri Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: "... 272-po mire e neser ne mengjes mere Salen iken mer ca te takojne te gjitha i di vete gjerat ti mos te flas shume ne telefon te kam vlla dhe une jam i shqetesuar, e beson qe po ha buke azili, po ha buke azili me vdekshin te dy djemte. 091-se ve ne dyshim.

Në datë 06.06.2018, ora 21:33, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dysohet te jete i pandehuri Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: "...091-e takova jo ktej jo andej jam keq po dridhej. 272-ore thuaj bej likuidimin qe kemi lene thuaj kaq asgje ne bote o Fredi vllai se me ate s kam lidhje fare kontakti besome se jam ne azil per shpirt te plakes-une flas me ane te tjetrit me kosovarin me ate - thuaj e vlla me bej likuidimin si e lame thuaj.....

Në datë 06.06.2018, ora 13:49, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 355438343766272 (dyskohet te jete shtetasi Albert Veliu) dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....091-fol njeher me ata miqte e vlla se une sdola dot andej poshte mua me erdhen me degjeneruan dy here ne mengjes me mbajten kater ore aty me benin presion mendo dhe per mua i q.. motren...272-ore po sbehet llaf po rri rehat tani bol tani. 091-ai miku qe ti njehe me thoshte mua fol hap gojen sa do ore une sikur e kam....”

Në datë 10.06.2018, ora 09:30, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 069 94 23 771 dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....771-mire, ca thojne kto gazeta e vlla? 091- ne s do mbajmë atë në kurriz unë i dola nga borxhi. 091- ne sdo mbajmë atë në kurriz unë i dola nga borxhi.....”

Në datë 12.06.2018, ora 12:55, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 069 86 21 974 dhe zhvillojnë këtë bisedë: “.....091-muhabeget nuk e ke digjeguar ne televizor ti me shtegjet me shtogu po fola unë gjëra e ai muhabegeti jam une e kape ti filmin e?.....091-une begera sikur kisha vllagai i atit e ke parasysh-degjon e? 974-he 091- begera sikur igisha vllagai i atitit e kupton ti qe dogoj kshu e kupton do migirim nga nje qikinshe e kupton ti. 974-eee 091-pa kela re burre po s ishte e mire ajo gje kupton ti nga nje qiginshe erdhi muhabeti prit re nga nje qigince per njer dyqigin e me tha mua nuk marim dyqigin me tha mua do magarim njeqikice ore mire I thashe une mendogova une vari k... 091- dgjo ree e me thaga mua do magarim nji iqikince me tha mua nuk japin dyqind une e kuptova edhe e pashe qe po me devijonte e ke parasysh vete ti se ca tipi ka ai. 974-e di une e di. 091-edhe i thashe mire i qikince i thashe une nem nje njezegetce mua nje zeget une viki andej levizja e kupton vlla-as njezeget asgjege vlla ikuqe ky muhabet...”

Në datë 19.06.2018, ora 11:46, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 telefonon përdoruesin e numrit telefonik 0685296508 dhe zhvillojnë këtë bisedë:”.....508-Hic ca te bej ne ship-mer lexo Gazeten Shqiptare mere. 091-ca thote? 508-e he fortune. 091-ca thote? 508-fortune, fortune, arrestime ca thote pranaj pot e them lexoje gazetën. 091-e po ku mar vesh une. 508-ca bone ti? 091- kur e dha kur e dha? 508-sot sot. 091-ca thote e ca thote. 508-arrestime thote priten arrestime.....”

Në datë 19.06.2018, ora 15:00, përdoruesi i numrit telefonik 067 64 94 091 (i pandehuri Fredi Alizoti) telefonohet nga përdoruesi i numrit telefonik 0685296508 dhe zhvillojnë këtë bisedë:”.....508- ne ship ku te jem – E pe ate gazeten? 091-jo se pashe, ca thoshte, ca thoshte? 508-po hic e do arrestohen po pak e pashe une po smora gazete-nuk mora gazete e pashe vetem me mjes te gazetate qe dalin ne gazette-priten arrestime edhe 100 miljon jane mare 100 miljon leke nga deshmitari nga Novosela thote qe eshte paraqitur te krimet e renda. 091-si ka marre 100 miljon qe jane marre? 508-jo jo qe jane mare 100 mije euro jan mar qe ka marre babalja.Nga përgjimet e sipërcituara vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas bërjes publike të regjistrimit të bisedës që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara.

Në bisedat e zhvilluar të pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkon të pandehurit Fredi Alizoti, që të “duronte” dhe pak sa të rregulloheshin punët.

Në asnjë bisedë që ka patur kontekst çështjen e shpërblimit, i pandehuri Albert Veliu nuk ka kundërshtuar të pandehurin Fredi Alizoti dhe për më tepër që ka aprovuar në heshtje.

Nga analizimi i përgjimeve telefonike vihet re se i pandehuri Albert Veliu u “kërkon llogari” personave të tjerë për sistemimin e familjarëve të tij.

Midis të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, ka shumë komunikime pas bërjes publike të regjistrimit të bisedës që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Ne vijim ka rezultat e provuar dënia, pjesëmarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Salianji me të pandehurit e tjerë në kryerjen e vepres penale të atribuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë përcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji.

Nga këto tabulate evidentohet se:

- Në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatuar 51 sekonda;
- Në datën 20.10.2017, ora 10:23:36', numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatuar 6 sekonda;
- Në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatuar 23 sekonda;
- Në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatuar 12 sekonda;
- Në datën 21.10.2017, ora 19:49', numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatuar 84 sekonda;

Këto të dhëna vërtetojnë tej çdo dyshimi se, është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi.

-Po kështu nga administrimi i Shkresës me nr.prot.4434/1, datë 18.9.2018, të shoqërisë Altelecom sh.a, dokumentohet fakti se numri 0676494091, është në përdorim të abonentit Fredi Alizoti. Më sipër janë pasqyruar edhe regjistrimet e përgjimeve të këtij numri celular.

-Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.2740/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Altelecom sh.a, dokumentohet se numri celular 0692151212, është në përdorim të abonentit Jetmir Olldashi.

-Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate vihet re se nga numri i tel. 069 93 24 140, në përdorim të pandehurit Albert Veliu, është telefonuar numri i tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, në datën 09.10.2017, ora 19.32, biseda ka zgjatur 69 sekonda dhe në datën 10.10.2017, ora 13.38, biseda ka zgjatur 121 sekonda.

Në datën 24.10.2017, ora 14.27', numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të pandehurit Albert Veliu ka telefonuar numrin e tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe biseda ka zgjatur 20 sekonda. Në momentin e thirrjes, qeliza e transmetimit e numrit celular 0699477182 në përdorim të shtetasit Albert Veliu, është "KRAPSI-S" dhe "MIFOLI-N".

Në datën 24.10.2017, ora 14.50', numri i tel. 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj ka telefonuar numrin e tel. 069 94 77 182 në përdorim të pandehurit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 29 sekonda. Në momentin e thirrjes, numri telefonik 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, ka loguar në zonën "Mbrotari Ura B", Fier.

Në datën 24.10.2017, numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të pandehurit Albert Veliu ka realizuar thirrje telefonike me numra të tjerë celularë, në orën 15.06' me qelizë transmetimi "PESHTAN-N" dhe "FIER SOUTH-N", në orën 15.57' me qelizë transmetimi "KAVAJE-SE" dhe në orën 16.38' me qelizë transmetimi "NEW RING ROAD 3-SE" (Unaza e Re).

Këto të dhëna, evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë. Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjedin regjistrues. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

-Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vërtetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

-Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Saliani. Nga të dhënat telefonike të administruara, vërtetohet se:

-Në datën 24.11.2017, ora 09.01', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 13 sekonda. Kjo bisedë është zhvilluar rreth një orë më parë, nga momenti kur i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek zyra e dëshmitarit Besim Hajdarmataj;

-Në datën 24.11.2017, ora 16.30', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 22 sekonda. Kjo bisedë është realizuar rreth 4 minuta më pas nga kontakti telefonik që shtetasi Albert Veliu ka patur me punonjësin e SHISH-it, dëshmitarin Eduart Martini.

-Në datën 25.11.2017, ora 10.21', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 69 sekonda.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa më shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

-Nga Shkresa me nr.prot.53/1, datë 10.01.2019, e shoqërisë Albtelcom sh.a, evidentohen numrat telefonikë që ka përdorur i pandehuri Fredi Alizoti.

-Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelcom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e transmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e transmetimit (antena) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

-Me Shkresën me nr.FRS/0458/LP, datë 31.01.2019, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet telefonike dhe qelizat e transmetimit për numrin telefonik 0694024321, në përdorim të dëshmitarit Agron Hyseni, për komunikimet e kryera në datën 24.11.2017. Nga këto të dhëna vihet re qartë se atë ditë (pra në dt.24.11.2017) ai ndodhej në qytetin e Vlorës, ndonëse është me banim në Tiranë.

Sipas vendimit Nr 53 data 12.4.2019 te Gjykatës se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane eshte vendosur ;'Pushimi i hetimeve te procedimit penal nr 95/1 te vitit 2018 per veprën penale te "Trafikimit te narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal,pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë inkrimuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

-Nga materialet e përcjella me Shkresën me nr.32/2 Prot./BK, datë 24.01.2019, të Ministrisë së Drejtësisë, dokumentohet se i pandehuri Albert Veliu ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në datën 24.05.2018. Në datën 28.05.2018 ai është paraqitur në policinë e Republikës së Kosovës dhe në datën 29.05.2018, ka kërkuar azil pranë zyrës përkatëse. Mbasi është pajisur me çertifikatën e statusit të azilërkuesit me nr.1311, i pandehuri Albert Veliu është lënë i lirë nga policia.

-Në gjykim në funksion të këtij procedimi kanë dëshmuar dëshmitarët Ermal Sadiraj, Ermal Kodhima dhe Ermal Hitoaliaj, me detyrë efektive në Komisaritet në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Në dëshmitë e dhëna përpara Gjykatës ndër të tjera ata shpjeguan që nuk kishin as njohje dhe as kontakte si me të pandehurin Albert Veliu ashtu dhe me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Të gjithë dëshmitarët mohuan që ndonjë prej tyre të ishte personi me emrin "Ermal" që përmendej në materialin e publikuar në datën 14.05.2018.

Ne vijim, ne gjykim dëshmitari Ermal Haxhi, dëshmoi përpara Gjykatës se në periudhën Gusht 2017 – Nëntor 2017 kishte qenë shef i Stacionit Policisë Kufitare Dhermi dhe nuk kishte as njohje dhe as kontakte si me të pandehurin Albert Veliu ashtu dhe me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Për këtë rast ai ishte vënë në dëgjim pas bërjes publike të regjistrimit dhe mohoi që të ishte personi me emrin "Ermal" që përmendej në materialin e publikuar në datën 14.05.2018.

Po kështu dëshmitari Eriton Demiri, dëshmoi përpara Gjykatës se njëher ndryshe edhe me nofkën "toto qorri". Ai shpjegoi kishte në pronësi të tij një lokal të ndodhur në "lungomare" Vlorë dhe të pandehurin Albert Veliu e njihte si person problematik dhe me të kishte marrëdhënie si gjiton që ishin. Ai mohoi kategorikisht që i pandehuri Albert Veliu të kishte drekuar ndonjëherë në lokalin e tij dhe pas daljes së regjistrimit edhe stafi i lokalit i kishin konfirmuar që Albert Veliu nuk kishte qenë ndonjëherë në lokalin e tij.

Edhe dëshmitarët Besim Hajdarmataj, Robert Tuci dhe Eduard Martini, dëshmuar përpara Gjykatës per fakte qe evidentuan mënyrën se si secili prej tyre kishte kontaktuar me të pandehurin Albert Veliu, informacionin që ai pretendonte se dispononte, mënyrën se si ishte proceduar më tej dhe faktin që nga gjithë procedura e kryer nuk kishte rezultuar ndonjë e dhënë implikuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Ne gjykim dëshmuar rreth fakteve objekt procedimi edhe dëshmitarët Enkelejd Alibeaj dhe Gazmend Bardhi, të cilët shpjeguan përpara Gjykatës rrethanat se si ishin vënë në dëgjim të materialit që u publikua prej tyre dhe të pandehurit Ervin Saliq, në daljen publike të datës 14.05.2018. Nga dëshmia e tyre, u evidentua qartë se kishte qenë pikërisht i pandehuri Ervin Saliq që ishte marrë paraprakisht me materialin që ishte publikuar.

Ne gjykim dëshmuar rreth fakteve objekt procedimi edhe dëshmitarët Albert Nushi dhe Andon Marko, të cilët kanë qenë përkatësisht në detyrë e drejtorit dhe zv/drejtorit të DVP Fier, në periudhën kur është publikuar "videopërgjimi". Të dy këta dëshmitarë, shpjeguan në mënyrë të hollësishme përpara Gjykatës, lidhur me rrethanat se si janë kontaktuar nga i pandehuri Fredi Alizoti dhe veprimet që kanë kryer më pas me të.

Ne séance gjyqësore në dëshmine e dhënë në gjykim, shtetasi Arnedo Selmanaj shpjegoi përpara Gjykatës se në rolin e kameramanit dhe për llogari të një emision investigativ për çështje në ndjekje të parcelave të hashashit, kishte udhëtuar për në qytetin e Vlorës së bashku me të pandehurin Jetmir Olldashi dhe me një person që thirrej "babale". Në qytetin e Vlorës kishin takuar shumë individë por nuk kishin faktuar aq sa donin.

Në dëshminë e tij të dhënë në gjykim shtetasi Ylli Rakipi, shpjegoi përpara Gjykatës se si drejtues i emisionit "Të paeksponuarit" kishte miratuar kërkesën e të pandehurit Jetmir Olldashi për të kryer një investigim për çështje droge në qytetin e Vlorës. I pandehuri Jetmir nuk i kishte referuar ndonjë emër konkret, por i kishte premtuar se do sillte video. Kur i pandehuri është kthyer në Vlorë, dëshmitari është vënë në dëgjim për materialin dhe meqenëse nuk kishte asnjë vlerë nuk e kishte marrë dhe shfrytëzuar për ndonjë emision.

Sikurse rezultoi si gjatë hetimit dhe gjykimit, i pandehuri Jetmir Olldashi nuk dorëzoi në asnjë moment regjistrimet origjinale që ai pretendon se janë bërë në Vlorë në datën 24.10.2017.

Në gjykim dëshmitari Erzen Breçani, konfirmoi përpara Gjykatës bisedat telefonike që kishte kryer me të pandehurin Fredi Alizoti dhe kontekstin e tyre. Në komunikimet me të pandehurin ai i kishte thënë se nuk ishte ai personi i duhur dhe të mos merrnin më qafë njerëzit.

Po kështu dëshmitari Nertil Mehmetaj, shpjegoi përpara Gjykatës se administronte lokalit "Vila del Sol", që ndodhej në qytetin Vlorë, në të cilin kishte të punësuar edhe shtetasin Klevis Veliu, djali i të pandehurit Albert Veliu. Ditën që është publikuar materiali i përgjimit është njoftuar nga një i njohur i tij, i cili i kishte thënë që personi i thirrur "Bashkëpunëtori X" dyshonte se ishte shtetasi Bert Veliu. Pas këtij momenti, kishte komunikuar me të pandehurin Albert Veliu, i cili i kishte pohuar që personi në bisedë ishte ai. Të nesërmen e asaj dite, Klevisi i kishte thënë që do e linte punën, pasi do të ikte larg.

Në gjykim dëshmitari Agron Hyseni dëshmoi përpara Gjykatës se kishte aktivitet biznesi në Vlorë dhe për këtë shkak, shpesh herë shkonte atje.

Në respektim të kërkesave të nenit 369/2 të K.Pr.Penale gjatë shqyrtimit gjyqësor u lexuan edhe deklaratimet e dhëna gjatë hetimeve paraprake nga shtetasi Geron (Agron) Xhafaj dhe procesverbalit përkatës u bë pjesë e fashikullit të shqyrtimit gjyqësor. Në deklaratimet e bëra prej tij përpara prokurorit, ky shtetas ka mohuar kategorikisht që të kishte kryer ndonjë bisedë me të pandehurin Albert Veliu, e për më tepër bisedë për ndonjë trafikim të mundshëm lëndësh narkotike.

Ne deklarimet e dhëna në gjykim përpara Gjykatës i pandehuri Fredi Alizoti, (në respektim të nenit 166 të K.Pr.Penale) shpjegoi në mënyrë të hollësishme gjithë mënyrën se si kishin vepruar ai dhe bashkëpunëtorët e tjerë në realizimin e veprës penale, faktin e kryerjes se kesaj veprimtarie i motivuar nga një përfitim material i premtuar, etj.

Ne gjykim u administruan edhe Proçesverbalet me deklarimet e dhëna gjatë hetimit paraprak të të pandehurit Albert Veliu (i proçeduar ne mungese ne gjykim, konform nenit 370/2 te K.Pr.Penale), i cili megjithëse u njoftua nga Gjykata nëpërmjet Letërporosisë për zhvillimin e këtij gjykimi dhe akuzat ndaj tij, nuk paraqiti asnjë kërkesë lidhur me gjykimin. Në lidhje me deklarimet e tij të mëparshme Prokuroria eidentoi disa pasaktësi si më poshtë:

I pandehuri Albert Veliu në deklarimet e tij në Prokurori ka rrëfyer të dy udhëtimet e tij në Vlorë të datave 24.10.2017 dhe 24.11.2017 në një deklaram. Është e vërtetë që ai ka shkuar në Vlorë i shoqëruar nga i pandehuri Jetmir Olldashi në datë 24.10.2017, ku dhe ka kryer komunikime telefonike në këtë datë në rrethinat e Vlorës referuar logjimeve të antenave me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj por nuk rezultojnë që të jetë takuar me këtë shtetas. Gjithashtu, i pandehuri Albert Veliu ka qenë në Vlorë dhe në datë 24.11.2017, i shoqëruar nga punonjës të SHISH-it ku ka regjistruar një bisedë me shtetasin Agron Hyseni. I pandehuri Albert Veliu në deklarimet e tij i referohet datës 24.11.2017 e cila është disa ditë para përmbajtjeve. Në këtë datë ai nuk ka asnjë komunikim me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe ka kryer regjistrimin e bisedës me shtetasin Agron Laver Hyseni. Gjithashtu, lokali i pretenduar në deklaramin e tij "2 Palmat" është lokali ku ai ka kryer bisedën i shoqëruar nga punonjësit e SHISH-it me shtetasin Agron Laver Hyseni. Gjithashtu në deklarimet e dhëna prej tij lidhur me pajisjen ai i referohet pajisjes së përdorur kur ka qenë i shoqëruar nga punonjësit SHISH-it.

I pandehuri Albert Veliu në deklarimet e tij i referohet udhëtimit në Vlorë me punonjësit e agjencisë ligjzbatuese në datë 24.11.2017, datë e cila përkon me atë që përmend në deklaram, rreth katër ditë përpara se të binin shirat e mëdha në Vlorë. Ka mospërputhje rreth një muaj midis udhëtimit me të pandehurin Jetmir Olldashi në Vlorë në datë 24.10.2017, me udhëtimit me punonjësit e SHISH-it në datë 24.11.2017.

Personat e përmendur nga i pandehuri Albert Veliu nuk rezultojnë të kenë qenë të pranishëm në bisedë. Për më tepër që, emri "Ermal" përmendet dhe në bisedën e realizuar me punonjësit e SHISH-it.

I pandehuri Albert Veliu pranon që kishte "qejfmbetje" të vjetër me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj pasi sipas tij ai nuk ishte interesuar për problemet e tij.

Këtë fakt e pranon dhe i pandehuri Jetmir Olldashi në deklarimet e tij sipas të cilit Alberti kishte ndjenjë të fortë hakmarrjeje për njerëzit për të cilët fliste, midis tyre dhe për Geron (Agron) Xhafaj.

I pandehuri Albert Veliu përmend në deklaramin e tij që ka komunikuar me shtetasin Edmon Hyseni ndërkohë që ky i fundit e mohoi një fakt të tillë. Gjithashtu pretendon që ka drekuar në lokalit e "toto qorrit". Ky i fundit i identifikuar si dëshmitari Eriton Demiri e mohoi një fakt të tillë përpara Gjykatës. I pandehuri Albert Veliu, pas publikimit të audiopërgjimit ka larguar fillimisht familjarët e tij jashtë vendit dhe më pas është larguar dhe vetë duke kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovë.

Mbi bazën e këtyre fakteve, nga përfaqësuesit e organit të akuzës u kërkua deklarimi fajtor i secilit prej të pandehurve Albert Veliu, Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Salianji për veprat penale të atribuara ne kete gjykim, si dhe denimi i secilit prej tyre me burgim ne masat e percaktuara ne pjesen hyrese te ketij vendimi, duke u kerkuar aplikimi i nenit 63 të Kodit Penal për të pandehurin Jetmir Olldashi (ku prokurori G.Qana kerkoi aplikim të nenit 59 të Kodit Penal ndaj te pandehurit Ervin Salianji). Perfaqesuesit e akuzes parashtruan se të pandehurit me veprimet e tyre të kryera me dashje kane konsumuar elementet e ketyre veprave penale, duke kerkuar nga Gjykata qe ne aktimin e llojit dhe te mases se denimit ndaj secilit prej te pandehurve te marre ne vleresim rrezikshmerine e veprave penale, faktin që vepra penale e parashikuar nga nent 305-25 është kryer në bashkëpunim, rrezikshmërinë e vetë të pandehurve dhe rrethanat individuale, sociale e familjare te secilit prej te pandehurve si me siper jane evidentuar.

Mbrojtësia e të pandehurit Albert Veliu ne konkluzionet e fundit kerkoj deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Albert Veliu për veprat penale të atribuara duke i evidentuar pretendimet kontestuese me shkrim.

Mbrojtësi i të pandehurit Fredi Alizoti kerkoj aktimin e një mase dënimi më të butë ndaj tij, për shkak të qëndrimit pohues e pendues të tij ndaj akuzës dhe bashkëpunimit të treguar me organin procedure në zbulimin e të vërtetës.

Mbrojtësi i të pandehurit Jetmir Olldashi kerkoj deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprën penale të atribuar me pretendimin se fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si veprë penale bazuar në nenin 388/1(a,c), duke i evidentuar pretendimet kontestuese me shkrim.

Mbrojtësi i të pandehurit Ervin Salianji kerkoj deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprën penale të atribuar me pretendimin se fakti nuk u provua se ekziston dhe as nuk parashikohet nga ligji si veprë penale bazuar në nenin 388/1(a,c), duke i evidentuar pretendimet kontestuese me shkrim.

Vetë i pandehuri Ervin Salianji u shpreh dakord me mbrojtësin e tij duke kërkuar pafajësi.

Vlerësimi, arsyetimi dhe disponimi i Gjykatës.

Interpretimi i dispozitave penale, analiza e provave lidhur me akuzën respektive të atribuar secilit të pandehur.

Referuar faktit penal te sipercituar dhe teresise se provave te shqyrtuara e administruara ne gjykim, Gjykata çmon se në veprimet e të pandehurit **Albert Veliu** janë të pranishëm të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elemente të figurave të veprave penale të "Kallëzimit të rreme, të kryer në bashkëpunim" dhe të "Kalimit të paligjshëm te kufirit shtetëror", të parashikuara nga nenet 305 e 25 dhe 297 të K.Penal. Gjithashtu Gjykata çmon se në veprimet e secilit prej të pandehurve **Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Salianji** janë të pranishëm të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elemente të figurës së veprës penale të "Kallëzimit të rreme, të kryer në bashkëpunim", të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

Në nenin 305 të Kodit Penal përcaktohet se: "*Kallëzimi për kryerjen e një krimi që dihet se nuk është kryer ose për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer atë, si edhe krijimi i provave të rreme me qëllim që të bëhen ndjekje penale, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*"

Në analizë të kuptimit, elementeve të bashkëpunimit dhe rolit të bashkëpunetoreve, si dhe referuar praktikës unifikuese te Gjykatës se Larte e konkretisht vendimit unifikues penal Nr.4, date 15/04/2011 qe te ekzistojte bashkëpunimi ne kryerjen e nje vepre penale detyrimisht duhet te bashkeekzistojne si kushte "*sine qua non*" njeherazi keto 4 elemente:

- Dy ose me shume subjekte (pluralitet personash);
- Realizimi i faktit kriminal ne te gjithe elementet e tij materiale;
- Dhenia e nje kontributi rilevant ne kryerjen e vepres penale nga seicili prej bashkëpunetoreve;
- Ana subjektive, qe eshte djenia e bashkëpunetoreve per te bashkëpunuar me te tjeret ne kryerjen e faktit kriminal.

Ndërsa në përmbajtjen e nenit 297 të K.Penal, sanksionohet se: *“Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërore përben kundërvajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjër në dy vjet.”*

Sipas nenit 152/1 të K.Pr.Penale: *“Çmuarja e provave është percaktimi i vërtetësisë dhe i fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në interes.”*

Gjykata vlerëson se, nisur nga rrethanat e ngjarjes, nga shqyrtimi i provave të analizuar më sipër, të administruara në funksion të këtij procesi që japin hollësi dhe tregojnë rrjedhën kronologjike të veprimtarisë së të katër të pandehurve në kryerjen e veprave penale të atribuara, të kohës kur ka ndodhur krimi, mënyrës se si është fabrikuar audiopergjimi i rreme në përmbajtje dhe i rreme për subjektin që referon si një nga protagonistët e tij (shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, ndërkohe që subjekte të vërtetë të tij janë të pandehurit Albert Veliu e Fredi Alizoti), të përdorimit të kësaj prove të rremë si bazë e një deklarimi publik e mediatik për kryerjen e një krimi të rëndë në fushën e narkotikëve, tërësisht i sajuar (i planifikuar kohë më parë nga të pandehurit në bashkëpunim me tyre, duke qenë se të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti rezultuan të kishin njohje të mepareshme, ndërsa të pandehurit Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñani kanë krijuar njohje për shkak të këtij bashkëpunimi me të pandehurit, të rezultuar nga komunikimet mes tyre dhe më tej takimet), mjetet që janë përdorur në kryerjen e këtij krimi (pergjues, media, etj.), shtuar këtu dhe faktin e pranuar në gjykim nga vete i pandehuri Fredi Alizoti për bashkeautoresinë e pohuar mbi kryerjen e këtij krimi me të pandehurit e tjerë, rezultoni tërësisht e provuar se fakti ka ndodhur në variantin e percaktuar nga ana e Prokurorisë, e vërtetuar nga aktet provuese si me sipër janë specifikuar, dhe Gjykata vlerëson se në teresinë e veprimeve të kryera nga të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñani çilesohet kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 305 e 25 të K.Penal dhe se autorët e kryerjes së këtij krimi janë pikërisht të pandehurit.

1. Për të pandehurin Albert Veliu.

Përsa i përket elementeve të figures së veprave penale të parashikuara nga nenet 305 e 25 të K.Penal, për Gjykatën referuar arsyetimit vijues, duke u mbështetur në provat e sipërcituara rezultoi e provuar që i pandehuri Albert Veliu në bashkëpunim me të pandehurit Fredi Alizoti, Jetmir Olldashi dhe Ervin Saliñani janë autorët e kryerjes së kesaj veprave penale dhe veprimet e tyre të bashkërenduara të kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqërore, kanë cenuar objektin e veprës penale, marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e individit, objekt i një procedimi penal të rregjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar për me tepër në sajimin e provave të rreme për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas percaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e veprës penale *“Kallëzimi i rremë”* kryhet nëpërmjet: *i)* kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; *ii)* kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallzohet; ose *iii)* krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të iniciohet ndjekja penale.

Rezultoni e provuar që i pandehuri Albert Veliu ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë Fredi Alizoti, Ervin Saliñani e Jetmir Olldashi, të cilat konsistojnë në planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopergjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e këtij audiopergjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuuar kryerjen e një veprave penale të rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale në vlerë monetare për të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti.

Gjykata konstaton se përveç perfitimit material i pandehuri Albert Veliu ka pasur si qëllim tjetër në kryerjen e veprave penale edhe atë të perfitimit të azilit politik për vete dhe familjaret e tij. Nga provat rezultoni se ky qëllim i të pandehurit Albert Veliu për azil politik për vete dhe familjaret e tij del qartë i provuar nga komunikimet e pergjimit telefonike gjatë kohës kryerjes së veprave penale e pas saj, duke u ndihmuar në këtë qëllim edhe nga bashkëpandehuri tjetër Ervin Saliñani, deputet në atë kohë i Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë. Ky qëllim i të pandehurit rezultoni edhe nga veprimet e të pandehurit pas kryerjes së veprave penale. Nga aktet rezultoni se i pandehuri Albert Veliu ka kërkuar strehim politik në Mbretërinë e Belgjikës ku është kapur për efektë ekstradimi drejt Republikës së Shqipërisë. Nga ana e kesaj gjykate i është mundësuar të pandehurit Albert Veliu njoftimi për këtë procedim penal objekte gjykimi, por i pandehuri rezultoni që të fshihet drejtësisë pavarësisht se ishte në dijeni të këtij procedimi penal.

Ka rezultuar e provuar që të dy të pandehurit e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin Janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar i tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliñani, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Deklarimet e dhëna në hetim të bashkëpandehurit Albert Veliu (subjekti inicues dhe protagonist në audiopergjim, me precedente penale dhe i motivuar nga një ndjenje qejfmbetje e dashakeqesie ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj të cilat vlerësohen me rezervë nga Gjykata për shkak të kontradiktoritetit të tyre në faktet e deklaruara me provat e tjera si me sipër janë evidentuar, dhe deklarimet e të pandehurit Fredi Alizoti si në hetim e gjykim (ku ky i fundit pohon pjesëmarrjen e tij si një prej subjekteve bashkëbisedues në këtë audiopergjim duke simuluar rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj), e po kështu përmbajtja e bisedave sipas tabulateve telefonike për komunikimet e kryera midis të gjithë të pandehurve disa dite para realizimit të audiopergjimit, mungesa e cdo qëllimi tjetër të mundshëm që të shpjegojë komunikimet telefonike të shpeshta e zinxhir mes të pandehurve përgjate periudhës se realizimit të audiopergjimit e mbas tij, faktotje e provojnë bashkëpunimin e të pandehurve në kryerjen e kesaj veprave penale dhe se në muajin Tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë paraprakisht takim me të pandehurin Ervin Saliñani, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike. Në vlerësim të nenit 152/3 të K.Pr.Penale, deklarimet e dhëna në hetim nga bashkëpandehurit Albert Veliu e Fredi Alizoti përbëjnë prove, por vlerësohen në unitet me provat e tjera të specifikuar e të marra gjatë këtij gjykimi që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

Kështu nga dëshmitë e dëshmitarëve të pytur në gjykim nuk u vërtëtua ekzistenca e personit me emrin “Ernal” që përmendë nga i pandehuri Albert Veliu në materialin e publikuar në datën 14.05.2018. Po kështu dëshmitari Arnedo Selmanaj shpjegoi përpara Gjykatës se në rolin e kameramanit dhe për llogari të një emisioni investigativ për çështje në ndjekje të parcelave të hashashit, kishte udhëtuar për në qytetin e Vlorës së bashku me të pandehurin Jetmir Olldashi dhe me një person që thirrej “babale”. Në qytetin e Vlorës kishin takuar shumë individë por nuk kishin faktuar aq sa donin. I pandehuri Albert Veliu në deklarimet e tij i referohet datës 24.11.2017 e cila është disa ditë para përmbytjeve. Në këtë datë ai nuk ka asnjë komunikim me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Publikimi i “audioregjistrimit” të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Saliñani atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiantal dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiantal i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si “Bashkëpunëtori X”, i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohej me një regjistrim “audio” të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar “Bashkëpunëtori X” dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e

Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim "video" prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat "Bashkëpunëtori X" ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrisë të Brendshme, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë".

Vlen për t'u theksuar se veprimtaria kriminale e të pandehurit Albert Veliu ka iniciuar me realizimin e audiopërgjimit të sajuar në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, si dhe ka vijuar me bashkëpunimin e të pandehurit Ervin Salianji në parashkrimin publikisht në media duke e adresuar drejtperdrejt në organet proceduese, si një kallëzim penal (duke bere deklarata publike e adresuar në organet e drejtësisë fillimin e procedimit penal për veprimtari kriminale në fushën e trafikimit të narkotikëve (te rreme) ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Kallëzimi publik e mediatik i bere dihet që është realisht i rremë, pasi në përmbajtjen e tij nga i pandehuri Albert Veliu në bashkëpunim me të pandehurit Fredi Alizoti, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës, bazur në një provë audiopërgjimit të sajuar për kryerjen e një krimi ("Trafikimi i narkotikeve", të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, i atribuar nga të pandehurit Albert Veliu e Ervin Salianji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale të sajua ne blerjen prej tij per trafikimi te nje sasi lende narkotike te deklaruar nga te pandehurit sikur jane kryer nga personi qe eshte cenuar nga ky kallezim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, paraqitja e këtij kallëzimi publik dhe mediatik i perseritur nga i pandehuri Albert Veliu në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë (duke sajuar kallezim te rreme, prova te rreme e cdo fakt tjeter ne themel te ketij kallezimi te rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Renda Tiranë si organet kompetente për shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes.

I pandehuri Albert Veliu në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë ka konsumuar veprimet penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal me veprime aktive të kundërligjshme, të cilat konsistojnë në realizimin e një veprimtarie në kuadër të bisedave telefonike audio të përgjuara, teresisht te rreme, duke kallezuar publikisht ne media e me tej duke investuar organet e ndjekjes penale, si subjekt te nje veprimtarie kriminale ne fushen e narkotikeve, shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Ky i pandehuri nepermjet kesaj veprimtarie te paligjshme rrjedhimisht ka adresuar nje kallezim penal drejtuar Prokurorise se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, kallezim i cili dihet qe eshte realisht i rreme, pasi ne permbajtjen e tij nga i pandehuri jane dhene informacione qe nuk i përgjigjen te vertetes per kryerjen e nje krimi (Trafikim i narkotikeve, te parashikuar nga neni 283/a i K.Penal Shqiptar) qe ne te vertete nuk eshte kryer, i atribuar nga i pandehuri shtetasit te kallezuar Geron (Agron) Xhafaj, me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese te sipercituara dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale qe kjo veper penale te jete konsumuar nga i pandehuri Albert Veliu në bashkëpunim me të pandehurit e sipercituar. Bashkeautoresia e tij ne kryerjen e kesaj vepre penale provohet si nga transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara, ku ka komunikuar ky i pandehur me bashketepandehurit e tjerë te ketij procedimi, nga deklarimet pohuese te bashkeautoresise ne pjesemarrjen si subjekt ne kete audiopergjim e te pandehurit Fredi Alizoti, ashtu edhe me rezultatet negative te Raporit të zërit dhe deshmite e deshmitareve, të cilat japin fakte konkrete te perfishirjes se te pandehurit Albert Veliu ne kete veprimtari kriminale. Konkretisht rezultojne nje numer i konsiderueshem bisedash telefonike midis te pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike te përgjuara te detajuara ne rrethanat e faktit vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës kompromentuese që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklarimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara. Në bisedat e zhvilluara me të pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkoi të pandehurit Fredi Alizoti, që të "duronte" dhe pak sa të rregulloheshin punët. Pavarësisht që bisedat ndër të tjera kanë patur kontekst çështjen e shpërblimit për punën e kryer, i pandehuri Albert Veliu nuk ka kundërshtuar të pandehurin Fredi Alizoti dhe për më tepër që e ka aprovuar në heshtje. Nga analizimi i përgjimeve telefonike vihet re se i pandehuri Albert Veliu u "kërkoi llogari" personave të tjerë për sistemin e familjarëve të tij.

Ne vijim ka rezultuar e provuar dijenia, pjesemarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Salianji me të pandehurit e tjerë ne kryerjen e vepres penale të atribuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë përcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji. Nga këto tabulate evidentohet se: -në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda;

-në datën 20.10.2017, ora 10:23:36', numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 6 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 23 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 12 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:49', numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 84 sekonda;

Këto të dhëna janë tregues që faktikisht perfishirjen aktive te bashketepandehurit tjeter Ervin Salianji ne kryerjen e vepres penale ne bashkëpunim me të pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vërtetojnë veprimtarinë aktive të tij në përgatitjen e me tej fabrikimin e sajimin e provave te rreme, duke u angazhuar qe disa dite para se te realizohej audiopergjimi kompromentues i sajuar midis te pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate vihet re se nga numri i tel. 069 93 24 140, në përdorim të pandehurit Albert Veliu, është telefonuar numri i tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, në datën 09.10.2017, ora 19.32, biseda ka zgjatur 69 sekonda dhe në datën 10.10.2017, ora 13.38, biseda ka zgjatur 121 sekonda.

Në datën 24.10.2017, ora 14.27', numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të të pandehurit Albert Veliu ka telefonuar numrin e tel. 067 20 14 472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe biseda ka zgjatur 20 sekonda. Në momentin e thirrjes, qeliza e transmetimit e numrit celular 0699477182 në përdorim të shtetasit Albert Veliu, është "KRAPSI-S" dhe "MIFOLI-N".

Në datën 24.10.2017, ora 14.50', numri i tel. 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj ka telefonuar numrin e tel. 069 94 77 182 në përdorim të pandehurit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 29 sekonda. Në momentin e thirrjes, numri telefonik 067 20 14 472 në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, ka loguar në zonën "Mbrotari Ura B", Fier.

Në datën 24.10.2017, numri i tel. 069 94 77 182, në përdorim të pandehurit Albert Veliu ka realizuar thirrje telefonike me numra të tjerë celularë, në orën 15.06' me qelizë transmetimi "PESHTAN-N" dhe "FIER SOUTH-N", në orën 15.57' me qelizë transmetimi "KAVAJE-SE" dhe në orën 16.38' me qelizë transmetimi "NEW RING ROAD 3-SE" (Unaza e Re).

Këto të dhëna, evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë. Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjetin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vërtetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Salianji. Nga të dhënat telefonike të administruara, vërtetohet se:

-në datën 24.11.2017, ora 09.01', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 13 sekonda. Kjo bisedë është zhvilluar rreth një orë më parë, nga momenti kur i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek zyra e dëshmitarit Besim Hajdarmataj;

-në datën 24.11.2017, ora 16.30', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 22 sekonda. Kjo bisedë është realizuar rreth 4 minuta më pas nga kontakti telefonik që shtetasi Albert Veliu ka patur me punonjësin e SHISH-it, dëshmitarin Eduart Martini.

- në datën 25.11.2017, ora 10.21', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 69 sekonda.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa më shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e transmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e transmetimit (antenat) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Pikerisht veprimet aktive të të pandehurit Albert Veliu në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, e njëkohësisht të kundershtueshme lidhur me planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopergjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e këtij audiopergjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuar kryerjen e një veprë penale të rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve monetare për të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, e po kështu shfrytëzimin e këtij audiopergjimi për realizimin e interesave politike për të pandehurin Ervin Salianji provojnë lidhjen e drejtepërdrejte shkakësore të veprimeve të bashkërenduara të secilit prej të pandehurve me pasojen e ardhur në fillimin e një procedimi penal ligjrisht të pabazuar dhe të mbeshtetur në prova të sajura e të rreme.

Eshte një fakt i provuar nga aktet provuese, vecanerisht nga permbajtja e transkripteve të bisedave telefonike të siperevidentuara midis të pandehurve, ku evidentohet dhe vërtetohet pjesëmarrja aktive e të pandehurit Albert Veliu në të gjithë veprimtarinë e kundershtueshme të bashku me të pandehurit e tjerë Fredi Alizoti, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi lidhur me planifikimin e veprimeve të tyre në rend kronologjik e të miremenduar për realizimin e këtij audiopergjimi nga përgatitja e kushteve, mjeteve, vendit, subjekteve e deri në menyren e publikimit mediatik të tij dhe servirjen si krim i rende i kryer nga shtetasi Geron(Agron) Xhafaj.

Referuar rrethanave të faktit, provave të administruara ne hetim e gjykim, paraqitja e ketij kallëzimi nga i pandehuri bashke me prova dokumentuese të sajura prej tij, kane vene ne levizje organin procedues per kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e ceshitjes (duke harxhuar burimet njezore, vemendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme qe i sherbejne kesaj Prokurorie te Posacme per te hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtarite konkrete kriminale dhe jo ato te sajura), por qe nga verifikimet dhe veprimet hetimore te kryera mbi bazen iniciuese te ketij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej te pandehurit nuk i pergjigjen te vertetes dhe jane kryer prej tij per te filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, per qellime fitimi shumash te caktuara monetare. I pandehuri Albert Veliu ka cenuar marredheniet juridike te vendosura me ligj per te siguruar veprimtarine e rregullt e normale te organeve te drejtesise nga veprimet e kunderligjshme dhe per te siguruar te drejtat dhe lirate e njeriut objekt i procedimit penal si pasojte e veprimeve te paligjshme te personave qe abuzojne padrejtesisht me kallëzimet e tyre per te inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane eshte vendosur ; Pushimi i hetimeve te procedimit penal nr 95/1 te vitit 2018 per vepren penale te "Trafikimit te narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal, pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonje e dhene inkriminuese per shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore te kryera mbi bazen iniciuese te ketij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej te pandehurve nuk i pergjigjen te vertetes dhe jane kryer prej tyre ne bashkepunim me vullnet e ndërgjegje te plotë se po kryenin nje veprimtari te kunderligjshme duke paraqitur te dhena te rreme per te inicuar qellimisht nje procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Nga ana subjektive kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me bashketepandehurit e tjere Fredi Alizoti, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi me faj, ne formen e dashjes direkte, me qellimin e posacem per te shkatuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive te dobta (per te perfituar shuma monetare te premtuara nga i bashkepunehuri tjetër Ervin Salianji), veprime keto qe kane nje lidhje te drejteperdrejte shkakore me pasojen e deshiruar prej te pandehurit, cka e ben te qarte se ky i fundit i ka parashikuar pasojat e veprimeve te tij (kallëzimin e rreme ne organin procedues dhe iniciimin e procedimit penal ndaj shtetasit te kallëzuar Geron (Agron) Xhafaj) dhe njekoheisht ka deshiruar ardhjen e ketyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qellimin e posacem per te demtuar te drejtat e lirate e tij, reputacioni e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vellaite te tij ish-ministrit te brendshem ne kohen kur dhe eshte bere publik ky kallëzim i rreme. Në rastin konkret, te pandehurit kane bashkepunuar me njeri-tjetrin nepermjet marreveshjes paraprake te tyre per castin e volitshem dhe menyren e kryerjes se vepres penale si dhe ndarjen e roleve ne kete bashkepunim Albert Veliu dhe Ervin Salianji bashkeorganizatore, e njekoheisht i pari edhe ekzekutor e dy te pandehurit e tjere njeri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (te katert kane kryer veprime aktive ne realizimin e audiopergjimit kompromentente te rreme me qellim adresimin mediaticisht e publikisht te nje kallëzimit te rreme per kryerjen e nje krimi qe nuk eshte kryer ndaj nje shtetasi shqiptar per te inicuar procedimin penal ndaj tij e per te perfituar materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vellaite te te kallëzuarit, me cilesine e ish-ministrit te brendshem te kohes kur ky fakt ka ndodhur). Megjithese ata e parashikonin se një kallëzim i tille publik e mediatic me një përmbajtje të tillë do të bënte që organet proceduese kompetente të viheshin në lëvizje për të hetuar dhe proceduar penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kane lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e vepres penale te "Trafikimit te narkotikeve" te parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Subjekt i kryerjes se kesaj vepre penale eshte i pandehuri Albert Veliu, i cili, nga hetimi gjyqesor rezultoi te jete i pergjegjshem para ligjit penal dhe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale.

Fajësia e të pandehurit në kryerjen e vepres penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, veçanërisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqërite e telefonise celulare perkatese, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa më shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017 (disa dite para realizimit te vidiopergjimit).

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Albert Veliu ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e vepres penale të "Kallëzimit të rremë të kryer në bashkepunim", të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

- Në lidhje me elementet e figures se vepres penale te parashikuar nga neni 297 i K.Penal, per Gjykatën referuar arsytimit vijues,** rezultoi e provuar qe i pandehuri Albert Veliu ka konsumuar këtë vepër penale dhe ka cenuar objektin e kesaj vepre penale që janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar ligjshmërinë e kalimit të kufirit shtetëror. Në rastin konkret, i pandehuri Albert Veliu i cili me veprimet e tij të kunderligjshme, të drejtëperdrejta dhe të vullnetshme ka cenuar marredheniet juridike te vendosura me ligj per te siguruar veprimtarine e rregullt e normale te organeve te drejtesise nga veprimet e kunderligjshme dhe per te siguruar te drejtat dhe lirate e njeriut objekt i procedimit penal si pasojte e veprimeve te paligjshme te personave qe abuzojne padrejtesisht me kallëzimet e tyre per te inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Referuar nenit 297 të Kodit Penal, figura e vepres penale "Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror" nga ana objektive kryhet nëpërmjet kalimit të kufirit shtetëror në mënyrë të paligjshme, pa dokumentacion të rregullt. Eshtë e qarte që kjo është një dispozitë blankete, ndaj dhe lidhur me perkufizimin e kufijve shtetërorë dhe përcaktimin e rregullave ligjore te kalimit të territorit, Gjykata duhet t'i referohemi Ligjit Nr. 9861, datë 24.08.2008 "Për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit shtetëror", i ndryshuar, ku në nenin 4 të ketij ligji nën titullin "Përkufizime" parashikohet shprehimisht: "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: "...

- "Kufiri shtetëror" (më poshtë kufiri) është vija, e cila ndan territorin tokësor, ujërat e brendshme e territoriale dhe nëntokën e Republikës së Shqipërisë me shtetet fqinje, si edhe kufiri në territorin e pikave të kalimit kufitar, në aeroporte, aerodrome, porte detare, lumore, liqenore, nëpërmjet të cilave kryhet transporti ndërkombëtar...

- "Pikë e kalimit kufitar" është vendi i autorizuar nga autoritetet kompetente, ku kategori të caktuara personash mund të kalojnë kufirin gjatë orarit zyrtar të punës.

- "Kalim i kufirit shtetëror" është çdo lëvizje e njerëzve, e gjësh së gjallë, e sendeve vetjake dhe e mjeteve nëpërmjet kufirit."

Ndërsa në nenin 13 të ketij ligji nën titullin "Kalimi i kufirit" thuhet shprehimisht se: "1. Kalimi i kufirit bëhet vetëm në pikat e kalimit kufitar, brenda orarit të caktuar, me dokumente të vlefshme udhëtimi apo me dokumente që autorizojnë kalimin e kufirit; me një vizë të vlefshme, nëse kërkohet..."

Persa i perket anes objektive te kesaj vepre penale dispozita kerkon detyrimisht qe keto veprime per t'u konsideruar te kunderligjshme dhe per te formuar kundervajtje penale, pra per te rene ne penalitetet e kesaj dispozite te kryhen ne nje nga keto forma:

- nëpërmjet daljes nga kufiri shtetëror i Republikës së Shqipërisë nga pika apo vende të ndryshme të territorit dhe jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qellim;
 - nëpërmjet hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qellim, por nga vende të ndryshme të territorit;
- nëpërmjet hyrjes apo daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qellim dhe pa dokumentet përkatëse identifikuese të nevojshme sipas normave ligjore shqiptare në fuqi, por në mënyrë të fshehtë duke iu shmangur autoriteteve kompetente që kontrollojnë dhe verifikojnë pajisjen apo jo të shtetasve me dokumentat e nevojshëm konform rregullave ligjore për të kaluar kufirin shtetëror;

- *nëpërmjet hyrjes, kalimit, daljes në/nga ujrat territoriale të Republikës së Shqipërisë, në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të aplikueshem ne fuqi per përcaktimin dhe respektimin e vijes kufitare detare, te liqeneve dhe te lumenjve kufitare;*
- *nëpërmjet hyrjes, kalimit në hapësirën ajrore ku shtrihet sovraniteti i Republikës së Shqipërisë jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara me ligj për këte qellim, në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit të aplikueshem ne fuqi per përcaktimin dhe respektimin e vijes kufitare.*

Ne rastin objekt trajtimi, ka rezultuar e provuar nga aktet provuese të administruara se i pandehuri Albert Veliu ka dale me date 24.05.2018 nga kufijte shtetore te vendit tone, pra është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë duke kaluar në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paligjshme, jo nga pikat e kalimit kufitar të caktuara ligjrisht për kalimin e kufirit shtetëror sipas normave ligjore shqiptare në fuqi, por në mënyrë të fshëhtë duke iu shmangur autoriteteve kompetente që kontrollojnë dhe verifikojnë pajisjen apo jo të shtetasve me dokumentat e nevojshëm konform rregullave ligjore për të kaluar kufirin shtetëror, duke qenë i pandehuri në dijeni të faktit që ndaj tij ishte caktuar një masë sigurimi personal shtrënguese “arrest në burg” në funksion të këtij procedimi. Në datën 28.05.2018, ai është paraqitur në policinë e Republikës së Kosovës dhe në datën 29.05.2018, ka kërkuar azil pranë zyrës përkatëse. Në vijim, mbasi është pajisur me certifikatën e statusit të azilkërkuetit me nr.1311, është lënë i lirë nga policia dhe aktualisht ndodhet i arrestuar nga autoritetet e Mbretërisë së Belgjikës, duke i'u nënshtruar procedurave të ekstradimit.

Në kryerjen e kësaj vepre penale i pandehuri, ka vepruar me dashje të drejtëpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të paligjshme, duke kaluar kufirin shtetëror pa dokumentacionin ligjor, jo ne pikat e ligjshme te kalimit te kufirit shtetëror.

Subjekti i kryerjes se kësaj vepre penale eshte i pandehuri Albert Veliu, i cili, nga hetimi gjyqesor rezultoi te jete i pergjegjshem para ligjit penal dhe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale.

Pas shqyrtimit të akteve provuese, Gjykata konkludoi se i pandehuri Albert Veliu ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të “Kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror”, të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Albert Veliu, Gjykata bazuar në nenet 47, 49,50, te K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që vepra penale e parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal që i atribuohet të pandehurit përbën një krim, ndërsa vepra tjetër penale perben kundervajtje, përcaktime keto që lidhen drejtpërdrejt me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezulton me precedentet e mëparshëm penalë, por i rehabilituar, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprave penale (dashje direkte), moshën dhe nivelin arsimor të tij, motivin për përfitim pasuror që e ka shtyrë në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, si dhe faktin që i është fshehur drejtësisë duke iu shmangur procedimit penal.

Gjykata vlerëson se për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të marrëdhënieve juridike të cenuara nga kjo veprë penale (veprimtaria e rregullt e organeve të drejtësisë dhe të drejtat e liritë e njeriut), si dhe faktit që i pandehuri e ka kryer këtë veprë nisur nga motive të dobta (pasurore e politike), duke bërë që të ezarurohen në kohë, në vëmendje dhe në veprime procedurale të panevojshme shërbimet e Policisë Gjyqësore e të organeve proçeduese, lloji i dënimit me burgim i kërkuar nga organi i akuzës për t'u caktuar ndaj të pandehurit për te dyja akuzat e atribuara, është ligjrisht i bazuar në dispozitën përkatëse penale.

Nga ana tjetër, lidhur me masat respektive dhe atë përfundimtare të dënimit me burgim të kërkuar nga organi i akuzës për të pandehurin Albert Veliu, Gjykata vlerëson se masat e dënimit të vlerësuar nga Gjykata në dispozitiv të këtij vendimi, përfshirë këtu dhe atë përfundimtare ne zbatim te nenit 55 të K.Penal, i përgjigjen rëndësisë së faktit, veprave penale të kryera nga i pandehuri, si edhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, që të çmuara në kompleksitet justifikojne ligjrisht këtë masë përfundimtare dënimi dhe realizimin e qëllimit kompleks të dënimit penal lidhur me riedukimin dhe ndëshkimin e të pandehurit, por edhe qëllimin e parandalimit të përgjithshem ne shoqeri te kryerjes se kategorise se ketre veprave penale qe cenojne e drejtat dhe lirite e individit dhe devijojne veprimtarine e organeve proçeduese te drejtësisë per te luftuar kriminalitetin real dhe ekzistues, ne vend te atij te sajuar.

2. Për të pandehurin Fredi Alizoti.

Përsa i përket elementeve të figures se vepres penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, per Gjykatën referuar arsytimit vijues, duke u mbështetur ne provat e sipercituara rezultoi e provuar qe i pandehuri Fredi Alizoti ne bashkepunim me të pandehurit Albert Veliu ,Jemmir Olldashi dhe Ervin Saliانji jane autore te kesaj vepre penale dhe veprimet e tyre te bashkerenduara te kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqerore, kane cenuar objektin e vepres penale,marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e individit, objekt i nje procedimi penal te rregjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar per me teper ne sajimin e provave te reme për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas përcaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e veprës penale “Kallëzimi i rremë” kryhet nëpërmjet: i) kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; ii) kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallzohet; ose iii) krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të iniciohet ndjekja penale.

Rezultoni e provuar qe i pandehuri Fredi Alizoti ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e ne bashkepunim me te pandehurit e tjere Albert Veliu, Ervin Saliانji e Jemmir Olldashi, të cilat konsistojnë në planifikimin, përgatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te reme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e ketij audiopergjimi dhe publikimin mediatik te tij duke i atribuar kryerjen e nje vepre penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale ne vlera monetare per te pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti.

Ka rezultuar e provuar qe të dy të pandehurit e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin Janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar i tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i'a ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliانji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Deklarimet e bashketepandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti e po keshtu permbajtja e tabulateve telefonike per komunikimet e kryera midis te gjithe te pandehurve, faktojne e provojne bashkepunimin e tyre në kryerjen e këtij krimi dhe se ne muajin tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë paraprakisht takim me të pandehurin Ervin Saliانji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike.

Publikimi i "audio-regjistrimit" të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Salianji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiantal dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiantal i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si "Bashkëpunëtori X", i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim "audio" të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar "Bashkëpunëtori X" dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim "video" prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat "Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë".

Vlen për t'u theksuar se veprimtaria kriminale e te pandehurit Fredi Alizoti ka iniciuar nga i pandehuri tjetër Albert Veliu duke u motivuar nga interesa teresisht pasurore duke u bërë Fredi Alizoti një nga protagonistët dhe subjekti i realizimit të audiopërgjimit të sajuar, por kjo veprimtari është organizuar me bashkëpunimin e te pandehurit Ervin Salianji si në drejtim të fabrikimit të këtij audiopërgjimi të rremë ashtu edhe në drejtim të parashtrimit publikisht në media duke e adresuar drejtpërdrejt në organet proceduese, si një kallëzim penal (duke bërë deklaratat publike e adresuar në organet e drejtësisë fillimin e procedimit penal për veprimtari kiminale në fushen e trafikimit të narkotikëve (te rreme) ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Kallëzimi publik e mediatic i bërë dihet që është realisht i rremë, pasi në përmbajtjen e tij nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkëpunim me te pandehurit Fredi Alizoti, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës bazuar në një provë audiopërgjimit të sajuar për kryerjen e një krimi ("Trafikimi i narkotikeve", të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, i atribuuar nga te pandehurit Albert Veliu e Ervin Salianji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale te sajua ne blerjen prej tij per trafikimi te nje sasi lende narkotike te deklaruar nga te pandehurit sikur jane kryer nga personi qe eshte cenuar nga ky kallezim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, realizimi i një audiopërgjimi të rremë nga te pandehurit Fredi Alizoti e Albert Veliu ne bashkëpunim me te pandehurit e tjerë (duke sajuar kallezim te rreme, prova te rreme e cdo fakt tjetër ne themel te ketij kallezimi te rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së parë per Krimet e Renda Tiranë si organet kompetente per shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes. Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese te sipercituara dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale qe kjo veper penale te jete konsumuar nga i pandehuri Fredi Alizoti ne bashkëpunim me te pandehurit e sipercituar.

Bashkeautoresia e tij ne kryerjen e kesaj vepre penale provohet si nga transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara, ku ka komunikuar ky i pandehur me bashketepandehurit e tjere te ketij procedimi, nga deklaratimet pohuese te bashkeautoresise ne pjesemarrjen si subject ne kete audiopergjim e te pandehurit Fredi Alizoti, ashtu edhe me rezultatet e Raportit të zërit dhe deshmite e deshmitareve, të cilat japin fakte konkrete te perfshirjes se te pandehurit Fredi Alizoti ne kete veprimtari kriminale. Konkretisht rezultojne nje numer I konsiderueshem bisedash telefonike midis te pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike te përgjuara te detajuara ne rrethanat e faktit vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës kompromentuese që tregon bashkëpunimin midis tyre.

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara. Në bisedat e zhvilluara me te pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkon te pandehurit Fredi Alizoti, që të "duronte" dhe pak sa të rregulloheshin punët.

Pavaresisht qe bisedat nder te tjera kane patur kontekst çështjen e shpërblimit per punen e kryer, i pandehuri Albert Veliu nuk ka kundërshtuar te pandehurin Fredi Alizoti dhe për më tepër që e ka aprovuar në heshtje.

Nga analizimi i përgjimeve telefonike vihet re se i pandehuri Albert Veliu u "kërkon llogari" personave të tjerë për sistemimin e familjarëve të tij.

Ne vijim ka rezultuar e provuar djenia, pjesemarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i te pandehurit Ervin Salianji me te pandehurit e tjerë ne kryerjen e vepres penale të atribuuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë ëprcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji të analizuara më sipër.

Këto të dhëna janë tregues qe faktotjne perfshirjen aktive te bashketepandehurit tjetër Ervin Salianji ne kryerjen e vepres penale ne bashkëpunim me te pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vertetojne veprimtarine active te tij ne pergatitjen e me tej fabrikimin e sajimin e provave te rreme, duke u angazhuar kohe me parë se te realizohej audiopergjimi kompromentues i sajuar midis te pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi.

Po keshtu nga administrimi i Shkresës me nr.prot.4434/1, datë 18.9.2018, të shoqërisë Albtelcom sh.a, dokumentohet fakti se numri 0676494091, është në përdorim të abonentit Fredi Alizoti.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.2740/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Albtelcom sh.a, dokumentohet se numri celular 0692151212, është përdorim të abonentit Jetmir Olldashi.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, ku këto të dhëna, evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë.

Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjetin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Saliani.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e trasmetimit (antena) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Me Shkresën me nr.FRS/0458/LP, datë 31.01.2019, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet telefonike dhe qelizat e trasmetimit për numrin telefonik 0694024321, në përdorim të dëshmitarit Agron Hyseni, për komunikimet e kryera në datën 24.11.2017. Nga këto të dhëna vihet re qartë se atë ditë (pra në dt.24.11.2017) ai ndodhej në qytetin e Vlorës, ndonëse është me banim në Tiranë.

Pikërisht veprimet aktive të të pandehurit Fredi Alizoti në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, e njekohesisht të kunderligjshme lidhur me planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopërgjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërdarjen e ketij audiopërgjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuar kryerjen e një veprë penale të rreme shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale për të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, e po kështu shfrytëzimin e ketij audiopërgjimi për realizimin e interesave politike për të pandehurin Ervin Salianji provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë shkakësore të veprimeve të bashkerenduara të secilit prej të pandehurve me pasojën e ardhur në fillimin e një procedimi penal ligjerisht të pabazuar dhe të mbështetur në prova të sajura e të rreme.

Eshtë një fakt i provuar nga aktet provuese, vecanerisht nga përmbajtja e transkripteve të bisedave telefonike të siperevidentuara midis të pandehurve, ku evidentohet dhe vërtetohet pjesëmarrja aktive e të pandehurit Fredi Alizoti në të gjithë veprimtarinë e kunderligjshme së bashku me të pandehurit e tjerë Albert Veliu, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi lidhur me planifikimin e veprimeve të tyre në rend kronologjik e të miremenduar për realizimin e ketij audiopërgjimi nga përgatitja e kushteve, mjeteve, vendit, subjekteve e deri në menyrën e publikimit mediatik të tij dhe servirjen si krim i rreme i kryer nga shtetasi Geron (Agron) Xhafaj.

Referuar rrethanave të faktit, provave të administruara në hetim e gjykim, paraqitja e ketij kallëzimi nga i pandehuri bashkë me prova dokumentuese të sajura prej tij, kanë vënë në lëvizje organin procedues për kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e ceshtjes (duke harxhuar burimet njerëzore, vemendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme që i shërbejnë kesaj Prokurorie të Posacme për të hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtarie konkrete kriminale dhe jo ato të sajura), por që nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të ketij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurit nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tij për të filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, për qëllime fitimi shumash të caktuara monetare. I pandehuri Fredi Alizoti ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë nga veprimet e kunderligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e njeriut objekt i procedimit penal si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre për të inicuar fiktivisht ndjekje penale. Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 të Gjykatës së Shkalles së Parë për Krime të Renda Tiranë është vendosur: "Pushimi i hetimeve të procedimit penal nr 95/1 të vitit 2018 për veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal, pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë inkriminuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të këtij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurve nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tyre në bashkëpunim me vullnet e ndërgjegje të plotë se po kryenin një veprimtari të kunderligjshme duke paraqitur të dhëna të rreme për të inicuar qëllimisht një procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Nga ana subjektive kjo veprë penale është kryer nga i pandehuri Fredi Alizoti në bashkëpunim me bashkëpandehurit e tjerë Albert Veliu, Ervin Salianji e Jetmir Olldashi me faj, në formën e dashjes direkte, me qëllimin e posacem për të shkakuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive të dobta (për të perfutur shumën monetare të premtuara nga i bashkëpandehuri tjetër Ervin Salianji), veprime këto që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar prej të pandehurit, cka e bën të qartë se ky i fundit ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij (kallëzimin e rreme në organin procedues dhe inicimin e procedimit penal ndaj shtetasit të kallëzuar Geron (Agron) Xhafaj) dhe njekohesisht ka dëshiruar ardhjen e ketyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qëllimin e posacem për të demtuar të drejtat e liritë e tij, reputacionin e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vellaist të tij ish-ministrit të brendshëm në kohën kur dhe është bere public ky kallëzim i rreme. Në rastin konkret, të pandehurit kanë bashkëpunuar me njeri-tjetrin nepermjet marreveshjes paraprake të tyre për castin e volitshëm dhe menyrën e kryerjes së veprës penale si dhe ndarjen e roleve në këte bashkëpunim Albert Veliu dhe Ervin Salianji bashkeorganizatore, e njekohesisht i pari edhe ekzekutor e dy të pandehurit e tjerë njeri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (te katert kanë kryer veprime aktive në realizimin e audiopërgjimit kompromentues të rreme me qëllim adresimin mediatisht e publikisht të një kallëzimi të rreme për kryerjen e një krimi që nuk është kryer ndaj një shtetasit shqiptar për të inicuar procedim penal ndaj tij e për të perfutur materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vellaist të të kallëzuarit, me cilësinë e ish-ministrit të brendshëm të kohës kur ky fakt ka ndodhur). Megjithatë ata e parashikonin se një kallëzim i tillë publik e mediatik me një përmbajtje të tillë do të bënte që organet proceduese kompetente të viheshin në lëvizje për të hetuar dhe proceduar penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kanë lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale "Trafikimit të narkotikeve" të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Subjekt i kryerjes së kësaj veprë penale është i pandehuri Fredi Alizoti, i cili, nga hetimi gjyqësor rezultoi të jete i përgjegjshëm para ligjit penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Fajësia e të pandehurit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, vecanerisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqëritë e telefonisë celulare perkatese, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratim të dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Fredi Alizoti ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të "Kallëzimit të rremë të kryer në bashkëpunim", të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Fredi Alizoti, Gjykata bazuar në nenet 47, 48, 49,50 të K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që vepra penale që i atribuohet të pandehurit përbën një krim dhe si e tillë paraqet rrezikshmëri shoqërore, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezultoi i dënuar më parë por fakti që kjo veprë penale është kryer në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë dhe se lehtëson arritjen e rezultatit kriminal është tregues i rrezikshmërisë së tij, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprës penale (dashje direkte), faktin që ai ka pranuar akuzën dhe ka shprehur pendësë dhe është paraqitur pranë organeve kompetente pas kryerjes veprë penale, moshën dhe nivelin arsimor të tij, motivin për interes pasurore që e ka shtyrë në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, si dhe rolin e tij në kryerjen e veprës penale si ekzekutor.

Gjykata vlerëson se për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të marrëdhënieve juridike të cenuara nga kjo veprë penale (veprimtaria e rregullt e organeve të drejtësisë dhe të drejtat e liritë e njeriut), si dhe faktit që i pandehuri e ka kryer këtë veprë nisur nga motive të dobta (politike), duke bërë që të ezaurohen në kohë, në vëmendje dhe në veprime procedurale të panevojshme shërbimet e Policisë Gjyqësore e të organeve proceduese, lloji i dënimit me burgim i kërkuar nga organi i akuzës për t'u caktuar ndaj të pandehurit për akuzën e atribuar, është ligjërishi i bazuar në dispozitën përkatëse penale.

Ndaj dhe Gjykata per sa u argumentua, ne rastin objekt shqyrtimi çmon qe dhënia dhe vuajtja fizikisht e sanksionit penal me burgim prej të pandehurit Fredi Alizoti, në masën e dënimit të vlerësuar nga Gjykata në dispozitiv të këtij vendimi gjyqësor, i përgjigjet rëndësisë së faktit, veprave penale të kryera nga i pandehuri, si edhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, që të çmuara në kompleksitet justifikojnë ligjërishi këtë masë dënimi dhe realizimin e qëllimit kompleks të dënimit penal lidhur me riedukimin dhe ndëshkimin e të pandehurit, por edhe qëllimin e parandalimit të përgjithshëm në shoqëri të kryerjes se kategorise se ketyre veprave penale qe cenojne e drejtat dhe liritë e individit dhe devijojne veprimtarine e organeve proceduese te drejtesise per te luftuar kriminalitetin real dhe ekzistues, ne vend te atij virtual e te sajuar.

3. Për të pandehurin Jetmir Olldashi.

1-Përsa i perket elementeve te figures se vepres penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, per Gjykatën referuar arsytimit vijues, duke u mbështetur ne provat e sipercituara rezultoi e provuar qe i pandehuri Jetmir Olldashi ne bashkepunim me të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Saliñji jane autoret e kryerjes se kesaj vepre penale dhe veprimet e tyre te bashkerenduara te kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqerore, cane aueruar objektin e vepres penale marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale te organeve të drejtësisë nga veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e individit, objekt i nje procedimi penal te rregjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar per me teper ne sajimin e provave te rreme për të inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas përcaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e vepres penale “Kallëzimi i rremë” kryhet nëpërmjet: i) kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; ii) kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallzohet; ose iii) krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të iniciohet ndjekja penale.

Rezultoni e provuar qe i pandehuri Jetmir Olldashi ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e ne bashkepunim me te pandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Saliñji, të cilat konsistojnë në planifikimin, përgatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te rreme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e ketij audiopergjimi dhe publikimin mediatic te tij duke i atribuar kryerjen e nje vepre penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale ne vlera monetare per te pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti.

Ka rezultuar e provuar qe me ndihmesen e të pandehurit Jetmir Olldashi (ne venien ne dispozicion te automjetit, shoqerimin, instruksioneve, gjetjes se vendit per realizimin e audiopergjimit) të dy të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar i tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliñji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet. Sikurse rezultoi si gjatë hetimit dhe gjykimit, i pandehuri Jetmir Olldashi nuk dorëzoi në asnjë moment regjistrimet origjinale që ai pretendon se janë bërë në Vlorë në datën 24.10.2017. Per kete shkak sipas Raportit te ekspertimit te zerit, ka rezultuar se regjistrimet nuk janë regjistrime origjinale. Regjistrimi video ishte marrë nga pamjet e mediave. Ajo përbëhej nga dy video, shkrim dhe dy biseda të regjistruara.

Deshmitari Arnedo Selmanaj shpjegoi përpara Gjykatës se në rolin e kameramanit dhe për llogari të një emisioni investigativ për çështje në ndjekje të parcelave të hashashit, kishte udhëtuar për në qytetin e Vlorës së bashku me të pandehurin Jetmir Olldashi dhe me një person që thirrej “babale”. Në qytetin e Vlorës kishin takuar shumë individë por nuk kishin faktuar aq sa donin.

Deklarimet e bashketepandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti e po keshtu permbajtja e tabulateve telefonike per komunikimet e kryera midis te gjithe te pandehurve, faktojne e provojne bashkepunimin mes te pandehurve, dhe se ne muajin Tetor te vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë paraprakisht takim me të pandehurin Ervin Saliñji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike.

Publikimi i “audio-regjistrimit” të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqitshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Saliñji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi. Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiential dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiential i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si “Bashkëpunëtori X”, i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Mandej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohet me një regjistrim “audio” të një bisede ambientale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar “Bashkëpunëtori X” dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim “video” prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat “Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrit të Brendshëm, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë”.

Vlen per t'u theksuar se veprimtaria kriminale e te pandehurit Albert Veliu ka inicuar me realizimin e audiopergjimit te sajuar duke qene si protagonist dy të pandehurit Albert Veliu e Fredi Alizoti, me kontributin e të pandehurit Jetmir Olldashi, por kjo veprimtari është organizuar edhe me bashkepunimin e te pandehurit Ervin Saliñji si në drejtim të fabrikimit të këtij audiopergjimi të rremë ashtu edhe në drejtim të parashtrimit publikisht ne media duke e adresuar drejtperdrejt ne organet proceduese, si një kallëzim penal (duke bere deklarata publike e adresuar ne organet e drejtesise fillimin e procedimit penal per veprimtari kriminale ne fushen e trafikimit te narkotikeve (te rreme) ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Kallëzimi publik e mediatic i bere dihet që është realisht i rremë, pasi në përmbajtjen e tij nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me te pandehurit Fredi Alizoti ,Ervin Saliñji e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës për kryerjen e një krimi (“Trafikimi i narkotikeve”, të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, i atribuar nga te pandehurit Albert Veliu e Ervin Saliñji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale te sajara ne blerjen prej tij per trafikimi te nje sasie lende narkotike te deklaruar nga te pandehurit sikur jane kryer nga personi qe eshte cenuar nga ky kallëzim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, paraqitja e këtij kallëzimi publik dhe mediatic i perseritur nga i pandehuri Albert Veliu ne bashkepunim me të pandehurit e tjerë (duke sajuar kallëzim te rreme, prova te rreme e cdo fakt tjetër ne themel te ketij kallëzimi te rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së parë per Krimet e Renda Tiranë si organet kompetente per shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes.

I pandehuri Jetmir Olldashi ne bashkepunim me te pandehurit e tjere ka konsumuar veprën penale te parashikuar nga nenet 305 e 25 te K.Penal me veprime aktive te kundërligjshme, te cilat konsistojne ne realizimin e nje veprimtarie ne kuader te bisedave telefonike audio te perjuara, teresisht te rreme per personin qe i atribuohet krimi dhe veprimtaria kriminale e trafikimit te narkotikeve e sajuar, duke pasjelle kjo prove e rreme bazen e nje kallëzimi publik ne media e me tej duke investuar organet e ndjekjes penale, për ta konsideruar si një subjekt te mundshëm të dyshuar të nje veprimtarie kriminale ne fushen e narkotikeve, shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

I pandehuri Jetmir Olldashi me kontributin e tij ne kete veprimtari kriminale per fabrikimin e një prove të rreme te kryer ne bashkëpunim me të pandehurit e tjerë sikundër më lart është analizuar, rrjedhimisht ka adresuar një kallezim penal drejtuar Prokurorisë se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, kallezim i cili dihet qe eshte realisht i rreme, pasi ne permbajtjen e tij nga te pandehurit jane dhene informacione qe nuk i pergjigjen te vertetes per kryerjen e nje krimi (Trafikim i narkotikeve, te parashikuara nga neni 283/a i K.Penal Shqiptar) qe ne te vertete nuk eshte kryer, i atribuar nga te pandehurit shtetasit te kallezuar Geron (Agron) Xhafaj, me qellim qe organet e drejtesise te fillonin ndjekjen penale ndaj ketij shtetasi.

Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese te sipercituara dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale qe kjo veper penale te jete konsumuar nga i pandehuri Jetmir Olldashi ne bashkëpunim me te pandehurit e sipercituar. Konkretisht rezultojne nje numer i konsiderueshem bisedash telefonike midis te pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike te pergjuara te detajuara ne rrethanat e faktit vihete se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës kompromentuese që tregon bashkëpunimin midis tyre. Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara. Ne vijim ka rezultuar e provuar dijënia, pjesëmarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Salianji me te pandehurit e tjerë ne kryerjen e vepres penale të atribuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë përcjellë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Salianji. Nga këto tabulate evidentohet se: -në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda; -në datën 20.10.2017, ora 10:23:36', numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 6 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 23 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 12 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:49', numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 84 sekonda;

Këto të dhëna janë tregues qe faktotje perfshirjen aktive te bashketepandehurve Jetmir Olldashi e Ervin Salianji ne kryerjen e vepres penale ne bashkëpunim me te pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vertetojne veprimtarine aktive te tyre ne pergatitjen e me tej fabrikimin e sajimin e provave te rreme, duke u angazhuar koha me parë se te realizohet audiopergjimi kompromentues i sajuar midis te pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Salianji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi.

Po keshtu nga administrimi i Shkresës me nr.prot.4434/1, datë 18.9.2018, të shoqërisë Albtelcom sh.a, dokumentohet fakti se numri 0676494091, është në përdorim të abonentit Fredi Alizoti.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.2740/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Albtelcom sh.a, dokumentohet se numri celular 0692151212, është përdorim të abonentit Jetmir Olldashi.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate dalin të dhëna që evidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë.

Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrëzojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjetin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vertetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a, janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihete re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Saliani.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa më shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelcom sh.a, me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën Dhjetor 2017-Janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihete re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e trasmetimit (antennat) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhën kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Pikerisht veprimet aktive te te pandehurit Jetmir Olldashi ne bashkëpunim me te pandehurit e tjere, e njekohesisht te kunderligjshme lidhur me planifikimin, pergatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te rreme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, duke i atribuar kryerjen e nje vepre penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qellimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij, pavarësisht detyrës së tij si gazetar investigativ që e ngarkon edhe me të tepër përgjegjësi profesionale në ushtrimin korrekt të detyrës së gazetarit, provojnë lidhjen e drejteperdrejte shkakësore te veprimeve te bashkerendura te seicilit prej te pandehurve me pasojen e ardhur ne fillimin e nje procedimi penal ligjesisht te pabazuar dhe te mbeshtetur ne prova te sajura e te rreme.

Referuar rrethanave te faktit, provave te administruara ne hetim e gjykim, paraqitja e ketij kallezimi nga i pandehuri Albert Veliu bashke me prova dokumentuese te sajura prej tij, kane vene ne levizje organin procedues per kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e ceshtjes (duke harxhuar burimet njerezore, vemendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme qe i sherbejne kesaj Prokurorie te Posacme per te hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtarite kriminale dhe jo ato te sajura), por qe nga verifikimet dhe veprimet hetimore te kryera mbi bazen iniciuese te ketij kallezimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej te pandehurit nuk i pergjigjen te vertetes dhe jane kryer

prej tij per te filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. I pandehuri Jetmir Olldashi ka cenuar marrëdhëniet juridike te vendosura me ligj per te siguruar veprimtarine e rregullt e normale te organeve te drejtesise nga veprimet e kunderligjshme dhe per te siguruar te drejtat dhe lirite e njeriut objekt i procedimit penal si pasojë e veprimeve te paligjshme te personave qe abuzojne padrejtesisht me kallezimin e tyre per te inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane eshte vendosur ; 'Pushimi i hetimeve te procedimit penal nr 95/1 te vitit 2018 per vepren penale te "Trafikimit te narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal, pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonje e dhene inkriminuese per shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore te kryera mbi bazen iniciuese te ketij kallzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej te pandehurve nuk i pergjigjen te vertetes dhe jane kryer prej tyre ne bashkepunim me vullnet e nderegjime te plotë se po kryenin nje veprimtari te kunderligjshme duke paraqitur te dhëna te rreme per te inicuar qellimisht nje procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Referuar, analizes juridike dhe provave te analizuara si me sipër, Gjykata i konsideron te pazuarua pretendimet e mbrojtjes te te pandehurit Jetmir Olldashi per deklarimin e pajshem te ketij te pandehuri, pasi vlereson se ndryshe nga sa mbrojtja pretendon, tërësia e këtyre provave e implikon te pandehurin ne kryerjen e veprimtarise kriminale te sajimit e fabrikimit te provave te rreme me qellim iniciimin e nje procedimi penal te paligjshem ndaj nje shtetasi shqiptar.

Lidhur me kete rast dhe funksionin e te pandehurit si gazetar investigativ, Gjykata vlereson me rëndësi te theksojë se liria e shprehjes është një e drejtë thelbësore e garantuar nga legjislacioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e te tretteve, apo autoriteteve publike duke respektuar kufijtë ligjor.

Liria e shprehjes, e shtypit, radios e televizionit, lirisë së informimit, si një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike dhe si një parakusht për të gëzuar të drejtat e tjera garantohet nga Neni 22 i Kushtetutës së Shqipërisë. Neni 22 i Kushtetutës, në të cilin thuhet se: "*Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar...*".

Kjo e drejtë garantohet edhe nga neni 10 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut me titull "*Liria e shprehjes*". Në nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut parashikohet se:

"1. Çdo person ka të drejtën e lirisë se shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë pjesë ose për të dhënë informata, ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë..."

2. *Ushtrimi i këtyre lirisë, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, për integritetin territorial ose për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe për parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të parandaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor".*

Për të tepër Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut i ka zgjeruar shumë kufijtë e lirisë së shprehjes. Kjo Gjykatë thekson se kjo e drejtë përfshin lirinë e zotërimit të bindjeve, si dhe të marrjes apo transmetimit të informacioneve dhe të ideve pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht kufijve shtetërorë, por nuk është e pakufizuar, për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve si edhe për shkak të ruajtjes së balancës mes nenit 10 dhe nenit 8 "*E drejta per respektimin e jetes private dhe familjare*" të K.E.D.NJ-së.

Kështu në rastin objekt trajtimi gjyqësor, veprimtaria e te pandehurit Jetmir Olldashi në cilësinë e gazetarit nuk është zhvilluar konform kornizave kushtetuese e ligjore të disiplinimit të veprimtarisë së tij, duke mos u mjaftuar me investigimin, administrimin e një informacioni me rëndësi për publikun dhe informimin mediatisht të publikut lidhur me të, përkundrazi, vlen te theksohet se pavarësisht detyrës së tij si gazetar investigativ që e ngarkon edhe me te tepër përgjegjësi profesionale e ligjore në ushtrimin korrekt të detyrës së gazetarit, është një fakt tashmë i provuar nga aktet provuese, pjesëmarrja aktive e te pandehurit Jetmir Olldashi ne te gjithë veprimtarine e kunderligjshme se bashku me te pandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Salianji lidhur me planifikimin e veprimeve te tyre ne rend kronologjik e te miremenduar per realizimin e ketij audiopergjimi të sajuar nga pergatitja e kushteve, mjeteve, vendit, subjekteve e deri ne menyren e publikimit mediatisht te tij dhe servirjen si krim i kryer nga shtetasi Geron(Agron) Xhafaj.

Në rastin "*Karakod kundër Hungarisë*", Gj.E.D.Nj u shpreh se Konventa mbron nëpërmjet nenit 8, aspektet thelbësore te reputacionit të individit, siguron mbrojtje "*nga pretendimet apo akuza faktike të një natyre të tillë seriozitet ofenduese, saqë publikimi i tyre do të kishte një efekt të pashmangshëm, të drejtpërdrejtë në jetën private të kërkuesit*" dhe jo thjesht në vlerësimin e jashtëm të individit. Cilido qoftë ky "prag", është e qartë se Gj.E.D.NJ-ja njeh të drejtën e "reputacionit" dhe e nxjerr atë nga koncepti i jetës private.

Gj.E.D.Nj-ja ne jurisprudence e saj ka zberthyer raportin ndërmjet lirisë së shprehjes së individit, lirisë së shtypit, radios dhe televizionit, si dhe të drejtës së informimit. GJEDNJ i jep më tepër rëndësi disa elementëve si: pozicionit të deklaruesit dhe personit të cenuar, natyrës dhe objektivitetit të materialeve apo deklaratave te pretenduara dëmtuese, kualifikimit/cilësimit të tyre si dhe ekzistencës se provave për vërtetësinë e deklaratave cënuese.

Po kështu Komisioni i Venecias ka referuar një vendim të Dhomës së Lordëve në Britani, *rasti Reynolds*, ku janë evidentuar një listë faktorësh, për vlerësimin e balancimit mes dy të drejtave në konflikt:

1. *Serioziteti i pretendimit*. Sa më serioze të jetë akuza, aq më shumë publiku është i keqinformuar dhe individi i dëmtuar – nëse pohimi nuk është i vërtetë.

2. *Natyra e informacionit*, dhe shkalla në të cilën përmbajtja është një çështje me interes publik.

3. *Burimi i informacionit*. Disa informatorë nuk kanë njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjeve. Disa mund të kenë qëllimet e tyre dhe mund të paguhen për historinë që tregojnë.

4. *Hapat e ndërmarrë për të verifikuar informacionin*.

5. *Statusi i informacionit*. Pretendimet/akuzat mund të ketë qenë tashmë objekt i një hetimi, që duhet respektuar.

6. *Urgjenca e çështjes/lajmit*.

7. *Nëse është kërkuar koment nga paditësi për lajmin*. Ai mund të ketë informacione të tjera që nuk janë zbuluar.

8. *Nëse artikulli përmban edhe thelbin e këndvështrimit të palës paditëse* për historinë/lajmin.

9. *Toni i artikullit*. Një gazetë mund të ngrejë pyetje ose të kërkojë një hetim. Nuk duhet të pranojë pretendimet/akuzat si deklarata faktike.

10. *Rrethanat e botimit*, duke përfshirë kohën. "

Nga hetimi e gjykimi, ka rezultuar e provuar se te gjithë te pandehurit ishin në dijeni të ketij audiopergjimi të sajuar për kryerjen e të cilit kanë kontribuar dhe kanë lejuar e dëshiruar publikimin e tij.

Nga ana subjektive kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri Jetmir Olldashi ne bashkepunim me bashketepandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Salianji me faj, ne formen e dashjes direkte, me qellimin e posacem per te shkakuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive te dobta, veprime keto qe kane nje lidhje te drejteperdrejte shkakesore me pasojen e dëshiruar prej te pandehurit, cka e ben te qarte se ky i fundit i ka parashikuar pasojat e veprimeve te tij (kallezimin e rreme ne organin procedues dhe iniciimin e procedimit penal ndaj shtetasit te kallezuar Geron (Agron) Xhafaj dhe njekohesisht ka dëshiruar ardhjen e ketyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qellimin e posacem per te demtuar te drejtat e lirisë e tij, reputacioni e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vellait te tij ish-ministrit te brendshem ne kohen kur dhe eshte bere publik ky kallezim i rreme. Në rastin konkret, te pandehurit kane bashkepunuar me njeri-tjetrin nepermjet marreveshjes paraprake te tyre per castin e volitshem dhe menyren e kryerjes se vepres penale si dhe ndarjen e roleve ne kete bashkepunim Albert Veliu dhe Ervin Salianji bashkeorganizatore, e njekohesisht i pari edhe ekzekutor e dy te pandehurit e tjere njeri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (te katert kane kryer veprime aktive ne realizimin e audiopergjimit kompromentues te rreme me qellim adresimin mediatisht e publikisht te nje kallezimi te rreme per kryerjen e nje krimi qe nuk eshte kryer ndaj nje shtetasi shqiptar per te inicuar procedimin penal ndaj tij e per te perfutur materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vellait te te kallezuarit, me cilesine e ish-ministrit te brendshem te kohes kur ky fakt ka ndodhur). Megjithese ata e parashikonin se një kallëzim i tillë publik e mediatisht te një përmbajtje të tillë do të bënte që organet proceduese kompetente të viheshin në lëvizje për të hetuar dhe proceduar penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kane lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e vepres penale të "Trafikimit te narkotikeve" të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Subjekt i kryerjes se kësaj vepre penale eshte i pandehuri Jetmir Olldashi, i cili, nga hetimi gjyqësor rezultoi te jete i pergjegjshem para ligjit penal dhe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale.Fajësia e te pandehurit në kryerjen e vepres penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, veçanërisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqëritë e telefonise celulare perkatese, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, në tre biseda

telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Jetmir Olldashi ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të “Kallëzimit të rremë të kryer në bashkëpunim”, të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Jetmir Olldashi, Gjykata bazuar në nenet 47, 49,50, të K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që vepra penale që i atribuohet të pandehurit përbën një krim dhe si e tillë paraqet rrezikshmëri shoqërore, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezultoi në padënuar më parë por fakti që kjo veprë penale është kryer në bashkëpunim që e lehtëson arritjen e rezultatit kriminal është tregues i rrezikshmërisë së tij, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprave penale (dashje direkte), moshën dhe nivelin arsimor të tij, si dhe rolin e tij në kryerjen e veprës penale si ndihmes.

Gjithsesi, në një vlerësim të hollesishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri Jetmir Olldashi, Gjykata e cmon të bazuar kërkimin e Prokurorisë për llojin e dënimit të kërkuar për t’u caktuar ndaj tij si dhe për aplikimin e nenit 63 të K.Penal në masën e dënimit të vlerësuar nga Gjykata të shprehur në dispozitiv të vendimit gjyqësor, zëvendësimin e tij pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke detyruar të pandehurin për kryerjen e një pune në interes publik, sipas përcaktimeve të shprehura në dispozitiv. Gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohen kriteret ligjore për shkak të emuarjes së rolit të tij në këto bashkëpunim dhe rrethanave të tjera social-familjare të evidentuara nga Gjykata.

4. Për të pandehurin Ervin Saliانji.

Persa i perket elementeve të figures së veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, për Gjykatën referuar arsytimit vijues, duke u mbështetur në provat e sipercituar rezultoi e provuar që i pandehuri Ervin Saliانji në bashkëpunim me të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi kanë bashkeautorësuar e kryerjes së kesaj veprë penale dhe veprimet e tyre të bashkërenduara të kundërligjshme dhe me rrezikshmëri shoqërore, kanë cenuar objektin e veprës penale marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë dhe veprimet e kundërligjshme dhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e individit, objekt i një procedimi penal të rregjistruar si pasojë e veprimeve të paligjshme të personave që abuzojnë padrejtësisht me kallëzimet e tyre duke avancuar për me tepër në sajimin e provave të rreme për të inicuuar fiktivisht ndjekje penale.

Nga ana objektive, sipas përcaktimeve të nenit 305 të Kodit Penal, figura e veprës penale “Kallëzim i rremë” kryhet nëpërmjet: *i*) kallëzimit të një krimi që dihet se nuk është kryer; *ii*) kallëzimit për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer personi që kallzohet; ose *iii*) krijimit të provave të rreme, të bëra me qëllim që të inicohet ndjekja penale.

Rezultoni e provuar që i pandehuri Ervin Saliانji e ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme e në bashkëpunim me të pandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi, veprime këto të cilat konsistojnë në një kontribut relevant, të zgjatur në kohë e të qëndrueshem në planifikimin, përgatitjen, realizimin e një audiopërgjimi të rreme midis dy të pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shpërndarjen e këtij audiopërgjimi dhe publikimin mediatik të tij duke i atribuuar kryerjen e një veprë penale të rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qëllim e inicimit të një procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e interesave politike për vetë dhe forcen politike të perfaqësuar (i pandehuri Albert Veliu është akomoduar në selinë e P.D-se ku dhe ka dhënë deklaratë e intervista mbi këtë audiopërgjimi duke konfirmuar vërtetësinë e tij, i shtyrë për motive qifmbetje me të kallëzuarin dhe të perfitimeve monetare të premtuara ips tij per të dhe të pandehurin tjetër protagonist i vërtetë në audiopërgjimi Fredi Alizoti.

Ka rezultuar e provuar që të dy të pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti e kanë regjistruar bisedën e simuluar, në muajin janar të vitit 2018, në qytetin e Vlorës, tek një lokal që ndodhet përballë lokalit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Bisedën ata e kanë regjistruar tek një mjet regjistruar të tipit stilolaps dhe mbasi kanë ardhur në Tiranë, i pandehuri Albert Veliu i’a ka dorëzuar të pandehurit Ervin Saliانji, i cili ishte dhe personi që i kishte dhënë këtë mjet.

Deklarimet e dhena në hetim të bashketepandehurit Albert Veliu (subjekti inicues dhe protagonist në audiopërgjimi, me precedente penale dhe i motivuar nga një ndjenje qefmbetje e dashakeqesie ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj) dhe deklaratimet e të pandehurit Fredi Alizoti si në hetim e gjykim (ku ky i fundit pohon pjesëmarrjen e tij si një prej subjekteve bashkëbisedues në këtë audiopërgjimi duke simuluar rolin e shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, e po kështu komunikimet e kryera midis të gjithë të pandehurve në kohë para dhe pas realizimit të audiopërgjimit, mungesa e çdo qëllimi tjetër të mundshëm që të shpjegojë komunikimet telefonike të shpeshta e zinxhir mes të pandehurve përgjate periudhes së realizimit të audiopërgjimit e mbas tij, rezultatet negative të Raportit të ekspertimit të zërit, faktotjone e provojne bashkëpunimin e të pandehurve në kryerjen e kesaj veprë penale dhe se në muajin tetor të vitit 2017, i pandehuri Albert Veliu ka marrë parapikësit takim me të pandehurin Ervin Saliانji, që në atë kohë ishte në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, duke bashkëorganizuar këtë veprimtari kriminale.

Publikimi i “audio-regjistrimit” të manipuluar, është kryer në datën 14.05.2018 rreth orës 11:30, në një konferencë për shtyp, të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, ku është publikuar një material audio, duke u pretenduar se në të paraqiteshin të dhëna mbi aktivitetin kriminal të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (vëllai i Ministrisë të Brendshme të kohës). Ky publikim është kryer nga i pandehuri Ervin Saliانji atë kohë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, në një dalje për mediat së bashku me dëshmitarët Enkeled Alibeaj dhe Gazmend Bardhi.

Në materialin e fabrikuar dhe të publikuar është paraqitur regjistrimi ambiantial dhe i transkriptuar i zërit të pandehurit Albert Veliu, gjatë kohës që ai ndodhej në një automjet duke simuluar sikur po kryente një bisedë telefonike me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj. Në këtë material paraqitet regjistrimi ambiantial i zërit dhe i transkriptuar, i një personi të cilësuar si “Bashkëpunëtori X”, i cili kryente një bisedë telefonike në një automjet në ecje, me një person tjetër supozuar si shtetasi Geron (Agron) Xhafaj. Më tej, së bashku edhe me komentet me shkrim, vazhdohej me një regjistrim “audio” të një bisede ambiantiale që paraqitet si e zhvilluar midis personit të cilësuar “Bashkëpunëtori X” dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, tek lokali i këtij të fundit në qytetin e Vlorës. Në fund, materiali pasohet me një regjistrim “video” prej 6 sek, që tregonte pamje të një rruge, të regjistruara nga brendësia e një automjeti në lëvizje, shoqëruar me titrat “Bashkëpunëtori X ndoqi rrugën e treguar nga Geron (Agron) Xhafaj, bleu kanabisin tek trafikantët nën urdhërat e vëllait të Ministrisë të Brendshme, i qetë dhe pa ndjekjen e policisë”.

Vlen për t’u theksuar se dënimi dhe kontributi i të pandehurit Ervin Saliانji në veprimtarinë kriminale të paramenduar nga i pandehuri Albert Veliu dhe të mireorganizuar me ndihmesën e të pandehurit Ervin Saliانji dhe të bashketepandehurve të tjere Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi ka inicuar që në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, kur numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliانji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda. Ky komunikim që pervec motivit të kryerjes së këtij audiopërgjimi, nuk i lidh të pandehurit me asnjë shkak tjetër të mundshëm e të njohur komunikimi (miq, të aferm, etj), dhe ka vijuar midis të pandehurve të tjerë përgjate disa muajve deri në publikimin e këtij audiopërgjimi të rreme e pas tij. Konkretisht ka rezultuar e provuar dënimi, pjesëmarrja, kontributi dhe bashkëpunimi i të pandehurit Ervin Saliانji me të pandehurit e tjerë në kryerjen e veprës penale të atribuuar, nga administrimi i Shkresës me nr.FRS/3803/ES, datë 11.10.2018, të shoqërisë telefonike Vodafone Albania sh.a, me anë të së cilës janë ëprcëllë tabulatet telefonike të numrit telefonik 0692085947, në përdorim të abonentit Ervin Saliانji. Nga këto tabulate evidentohet se: -në datën 20.10.2017, ora 10:06:26, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliانji dhe biseda ka zgjatur 51 sekonda;

-në datën 20.10.2017, ora 10:23:36’, numri telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliانji dhe biseda ka zgjatur 6 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:42:57, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliانji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 23 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:44:32, numri telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Saliانji ka telefonuar numrin telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi dhe biseda ka zgjatur 12 sekonda;

-në datën 21.10.2017, ora 19:49’, numri telefonik 0692151212 në përdorim të shtetasit Jetmir Olldashi ka telefonuar numrin telefonik 0699324140 në përdorim të shtetasit Albert Veliu dhe biseda ka zgjatur 84 sekonda;

Këto të dhëna janë tregues që faktotjone përshirjen aktive të bashketepandehurit tjetër Ervin Saliانji në kryerjen e veprës penale në bashkëpunim me të pandehurin Albert Veliu, pasi tregojnë e vërtetojnë veprimtarinë aktive të tij në përgatitjen e me tej fabrikimin e sajimin e provave të rreme, duke u angazhuar që disa kohë me parë se të realizohej audiopërgjimi kompromentues i sajuar midis të pandehurve Albert Veliu e Fredi Alizoti, dhe se është pikërisht i pandehuri Ervin Saliانji ai që ka realizuar kontaktin midis të pandehurve Albert Veliu dhe Jetmir Olldashi, duke qenë ky i fundit nderlidhësi i tyre më pas.

Gjithashtu, veprimtaria kriminale e të pandehurit Ervin Salianji tej kontributit të tij për realizimin e audiopergjimit të sajuar, ka avancuar e vijuar me bashkëpunimin e të pandehurit Ervin Salianji edhe në parashkrimin publikisht në media duke e adresuar drejtpërdrejt në organet proceduese të drejtësisë, të një kallëzimi penal (duke bere deklarata publike e adresuar në organet e drejtësisë fillimin e procedimit penal për veprimtari kriminale në fushën e trafikimit të narkotikëve (te rreme) ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Deklarimi publik e mediatic i bere (i adresuar si kallëzim) dihet që është realisht i rremë, pasi në përmbajtjen e tij nga i pandehuri Ervin Salianji në bashkëpunim me të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti e Jetmir Olldashi janë dhënë informacione që nuk i përgjigjen të vërtetës për kryerjen e një krimi ("Trafikimi i narkotikeve", të parashkuar nga neni 283/a i Kodit Penal) që në të vërtetë nuk është kryer, bazuar në një audiopërgjimit të sajuar, i atribuar nga të pandehurit Albert Veliu e Ervin Salianji ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj (për kryerjen e veprimeve kriminale të sajura ne blerjen prej tij per trafikimi te nje sasive lende narkotike te deklaruar nga te pandehurit sikur jane kryer nga personi qe eshte cenuar nga ky kallezim), me qëllim që organet e drejtësisë të fillonin ndjekjen penale ndaj këtij shtetasi.

Gjithsesi, referuar rrethanave të faktit, paraqitja e këtij kallëzimi publik dhe mediatic i perseritur nga i pandehuri Ervin Salianji në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë (duke sajuar kallëzim të rreme, prova të rreme e cdo fakt tjetër në themel të këtij kallëzimi të rreme) ka vënë në lëvizje organet proceduese (Policinë Gjyqësore, Prokurorinë dhe Gjykatën e Shkallës së parë për Krimet e Renda Tiranë si organet kompetente për shkak lende) për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes.

Rezultoi teresisht e provuar nga aktet hetimore, aktet provuese të sipercituara dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale qe kjo veper penale te jete konsumuar nga i pandehuri Ervin Salianji ne bashkëpunim me të pandehurit e sipercituar. Konkretisht rezultojne nje numer i konsiderueshem bisedash telefonike midis te pandehurve, ku nga transkriptet e bisedave telefonike te pergjuara ne rrethanat e faktit vihet re se, midis shtetasit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti ka shumë komunikime pas publikimit të audioregjistrimit të bisedës kompromentuese që tregon bashkëpunimin midis tyre. Në tre biseda telefonike të pergjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopërgjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Në bisedat telefonike i pandehuri Fredi Alizoti shprehet i zhgënjyer nga i pandehuri Albert Veliu që nuk i ka dhënë paratë e pretenduara.

Në bisedat e zhvilluara me të pandehurin Albert Veliu, ky i fundit i kërkon të pandehurit Fredi Alizoti, që të "duronte" dhe pak sa të rregulloheshin punët.

Nga administrimi i Shkresës me nr.prot.3570/1, datë 30.05.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a., janë përcjellë tabulatet dhe evidentuar qelizat e logimit të numrit telefonik 0672014472, në përdorim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj. Nga këto tabulate të dhënat eidentojnë qartë faktin se në datën 24.10.2017, nuk ka patur asnjë kontakt fizik midis shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe të pandehurit Albert Veliu dhe për rrjedhojë nuk ka patur asnjë mundësi që midis tyre të jetë regjistruar ndonjë bisedë.

Gjatë hetimit, i pandehuri Albert Veliu ka pretenduar që të jetë takuar me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj në datë 24.10.2017, rreth orës 17.30, ndërkohë që referuar qelizave të telefonit rreth orës 14.40' ai dhe i pandehuri Jetmir Olldashi kanë qenë në Levan duke u kthyer për Tiranë. Këto të dhëna gjithashtu, rrezojnë edhe pretendimin e të pandehurit Jetmir Olldashi se atë ditë në Vlorë ishte realizuar regjistrimi i një bisede me shtetasin Geron (Agron) Xhafaj dhe për më tepër që këtë regjistrim, ai e kishte të ruajtur edhe mjeshin regjistruar. Fakti i vërtetë është, se atë ditë dhe më pas nuk është regjistruar asnjë bisedë ambientale midis të pandehurit Albert Veliu dhe shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Me Shkresën me nr.prot.7581/1, datë 28.12.2018, të shoqërisë Telekom Albania sh.a., janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të dëshmitarit Eduart Martini, për datat 24.11.2017-26.11.2017. Nga këto tabulate dhe në referencë të dëshmisë së tij, vërtetohet se i pandehuri Albert Veliu ka komunikuar me të nëpërmjet numrit telefonik 0684652077.

Me Shkresën me nr.prot.81/1, datë 16.01.2019, të shoqërisë Telekom Albania sh.a., janë përcjellë tabulatet e numrit telefonik 0684652077, në përdorim të abonentit Albert Veliu. Nga tabulatet vihet re se, i pandehuri Albert Veliu ka filluar që të përdorë këtë numër telefonik në datën 9.11.2017 dhe se gjatë kohës që ka "bashkëpunuar" me punonjësit e SHISH-it, ka qenë në kontakt me të pandehurin Ervin Salianji, nga të dhënat telefonike të administruara, vërtetohet se:

-në datën 24.11.2017, ora 09.01', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 13 sekonda. Kjo bisedë është zhvilluar rreth një orë më parë, nga momenti kur i pandehuri Albert Veliu ka shkuar tek zyra e dëshmitarit Besim Hajdarmataj;

-në datën 24.11.2017, ora 16.30', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 22 sekonda. Kjo bisedë është realizuar rreth 4 minuta më pas nga kontakti telefonik që shtetasi Albert Veliu ka patur me punonjësin e SHISH-it, dëshmitarin Eduart Martini.

- në datën 25.11.2017, ora 10.21', numri telefonik 0688536870 në përdorim të shtetasit Albert Veliu ka telefonuar numrin telefonik 0692085947 në përdorim të shtetasit Ervin Salianji dhe biseda ka zgjatur 69 sekonda.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa më shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017. Ndërkohë që ai ka komunikime edhe në intervalin kohor 24.11.2017-26.11.2017, të cilat u analizuan më sipër.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 14 komunikime telefonike me shtetasin Ervin Salianji për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka 81 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 20.10.2017 – 10.11.2017.

Referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Ervin Salianji ka 145 komunikime telefonike me shtetasin Jetmir Olldashi për periudhën 18.10.2017 – 19.05.2018.

Nga Shkresa me nr.prot.496/1, datë 05.02.2019, e shoqërisë Albtelecom sh.a., me anë të të cilës janë përcjellë tabulatet dhe qelizat e trasmetimit të numrave telefonikë në përdorim të të pandehurit Fredi Alizoti, për periudhën dhjetor 2017-janar 2018, nga të dhënat e përcjella vihet re se ai ka komunikime të shpeshta me shtetasin Albert Veliu dhe se qelizat e trasmetimit (antena) tregojnë për praninë e tij në qytetin e Vlorës, gjatë periudhën kohore kur ai shpjegon se ka realizuar regjistrimin e bisedës së publikuar.

Pikerisht veprimet aktive të të pandehurit Ervin Salianji në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, e njehoheshin të kundershtueshme lidhur me planifikimin, përgatitjen, realizimin e nje audiopergjimi te rreme midis dy te pandehurve Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, shperndarjen e ketij audiopergjimi dhe publikimin mediatic te tij duke i atribuar kryerjen e nje vepre penale te rende shtetasit Geron (Agron) Xhafaj me qellimin e inicimit te nje procedimi penal ndaj tij dhe realizimin e perfitimeve materiale per te pandehurit Albert Veliu dhe Fredi Alizoti, e po keshtu shfrytezimin e ketij audiopergjimi per realizimin e interesave politike per te pandehurin Ervin Salianji provojne lidhjen e drejteperdrejte shkakësore te veprimeve te bashkerenduara te seicilit prej te pandehurve me pasojen e ardhur ne fillimin e nje procedimi penal ligjrisht te pabazuar dhe te mbeshtetur ne prova te sajura e te rreme.

Eshte nje fakt i provuar nga aktet provuese, vecanerisht nga permbajtja e transkripteve te bisedave telefonike te siperevidentuara midis te pandehurve, ku evidentohet dhe vërtetohet pjesemarrja aktive e të pandehurit Ervin Salianji në të gjihte veprimtarine e kunderligjshme se bashku me te pandehurit e tjere Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi lidhur me planifikimin e veprimeve te tyre ne rend kronologjik e te miremenduar per realizimin e ketij audiopergjimi nga pergattja e kushteve, mjeteve, vendit, subjekteve e deri ne menyren e publikimit mediatic te tij dhe servirjen si krim i rende i kryer nga shtetasi Geron (Agron) Xhafaj.

Referuar rrethanave të faktit, provave të administruara në hetim e gjykim, paraqitja e ketij kallëzimi nga i pandehuri bashke me prova dokumentuese te sajura prej tij ne bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, kane vene ne levizje organin procedues per kryerjen e veprimeve hetimore dhe zbardhjen e ceshtjes (duke harxhuar burimet njerezore, vemendjen, kapacitetet investiguese dhe mjetet e nevojshme qe i sherbejne kesaj Prokurorie te Posacme per te hetuar me efektivitet e produktivitet veprimtarite konkrete kriminale dhe jo ato te sajura), por qe nga verifikimet dhe veprimet hetimore te kryera mbi bazen iniciuese te ketij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej te pandehurit nuk i pergjigjen te vertetes dhe jane kryer prej tij per te filluar ndjekje penale ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, per qellime fitimi shumash te caktuara monetare. I pandehuri Ervin Salianji ka cenuar marrëdhëniet juridike te vendosura me ligj per te siguruar veprimtarine e rregullt e normale te organeve te drejtësisë nga veprimet e kunderligjshme dhe per te siguruar te drejtat dhe liritë e njeriut objekt i procedimit penal si pasoje e veprimeve te paligjshme te personave qe abuzojne padrejtësisht me kallezimet e tyre per te inicuar fiktivisht ndjekje penale.

Sipas vendimit Nr.53 data 12.4.2019 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane eshte vendosur ; Pushimi i hetimeve te procedimit penal nr 95/1 te vitit 2018 per veprën penale te "Trafikimit te narkotikeve" parashikuar nga neni 283/a K.Penal, pasi nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë inkrimuese për shtetasin Geron (Agron) Xhafaj.

Por, Gjykata konstatoi se nga verifikimet dhe veprimet hetimore të kryera mbi bazën iniciuese të këtij kallëzimi, ka rezultuar se faktet e referuara prej të pandehurve nuk i përgjigjen të vërtetës dhe janë kryer prej tyre në bashkëpunim me vullnet e ndërgjegje të plotë se po kryenin një veprimtari të kundërligjshme duke paraqitur të dhëna të rreme për të iniciuar qëllimisht një procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Nga ana subjektive kjo veprë penale është kryer nga i pandehuri Ervin Salianji në bashkëpunim me bashkëpandehurit e tjerë Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Jetmir Olldashi me faj, në formën e dashjes direkte, me qëllimin e posacem për të shkakuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, i shtyre nga motive të dobta (për interesa politike e diskreditim të personalitetit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe cenim të reputacionit e imazhit të vëllait të tij, ish-ministrit të Brendshëm të kohës kur ka ndodhur fakti), veprime këto që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar prej të pandehurit, cka e bën të qartë se ky i fundit i ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij (sajimin e provave të rreme (audiopergjimi kompromentues i rreme) dhe kallëzimin e rreme duke e adresuar publikisht e mediatisht drejt organit procedues dhe iniciimin e procedimit penal ndaj shtetasit të kallëzuar Geron (Agron) Xhafaj) dhe njehoheshist ka dëshiruar ardhjen e ketyre pasojave (neni 15 i K.Penal), me qëllimin e posacem për të demtuar të drejtat e liritë e tij, reputacionin e tij publik dhe imazhin e reputacionin e vëllait të tij ish-Ministrit të Brendshëm të Republikës së Shqipërisë në kohën kur dhe është bërë publik ky kallëzim i rreme.

Në rastin konkret, të pandehurit kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin nepermjet marrëveshjes paraprake të tyre për castin e vulltshëm dhe menyrën e kryerjes se veprës penale si dhe ndarjen e roleve në këto bashkëpunim Albert Veliu dhe Ervin Salianji bashkeorganizatore, e njehoheshist i pari edhe ekzekutor e dy të pandehurit e tjerë njëri ekzekutor Fredi Alizoti dhe tjetri Jetmir Olldashi ndihmes (te katert kanë kryer veprime aktive në realizimin e audiopergjimit kompromentues të rreme me qëllim adresimin mediatisht e publikisht të një kallëzimi të rreme për kryerjen e një krimi që nuk është kryer ndaj një shtetasi shqiptar për të iniciuar proces penal ndaj tij e për të perfutur materialisht apo politikisht duke cenuar edhe reputacionin e vëllait të të kallëzuarit, me cilesinë e ish-ministrit të Brendshëm të kohës kur ky fakt ka ndodhur). Megjithatë ata e parashikonin se një kallëzim i tillë publik e mediatisht me një përmbajtje të tillë do të bënte që organet proceduese kompetente të viheshin në lëvizje për të hetuar dhe proceduar penalisht shtetasin Geron (Agron) Xhafaj, duke e dëshiruar këtë, kanë lejuar ardhjen e pasojës, pra regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale të "Trafikimit te narkotikeve" të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj.

Fajësia e të pandehurit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, veçanërisht nga: tabulatet telefonike të dërguar nga shoqëritë e telefonise celulare perkatëse, ku referuar analizës së tabulateve telefonike, shtetasi Albert Veliu ka kontaktuar për herë të parë me shtetasin Ervin Salianji në datë 20.10.2017 ndërsa më shtetasin Jetmir Olldashi në datë 21.10.2017 (disa dite para realizimit të vidiopergjimit).

Në tre biseda telefonike të përgjuara, qartësisht i pandehuri Fredi Alizoti pohon që është ai personi që ka bërë rolin e Geron (Agron) Xhafaj në audiopergjimin e publikuar. Këtë fakt ai e pranoi edhe në deklaratimet e dhëna përpara Gjykatës, duke shpjeguar edhe mekanizmin si ishte realizuar simulimi.

Referuar, analizës juridike si me sipër, Gjykata i gjen të pabazura pretendimet e mbrojtjes të të pandehurit Ervin Salianji për deklarin e pafajshëm të ketij të pandehuri, pasi vlereson se ndryshe nga sa mbrojtja pretendon, rezultatet e komunikimeve telefonike me të bashkëpandehurit e tjerë Albert Veliu e Jetmir Olldashi që implikojnë të pandehurin Ervin Salianji në kryerjen e veprimtarisë kriminale të sajimit e fabrikimit të provave të rreme me qëllim iniciimin e një procedimi penal të paligjshëm ndaj një shtetasi shqiptar, harmonizohen edhe me prova të tjera që janë detajuar me sipër nga Gjykata.

Gjykata gjen me rëndësi të theksosë se pikërisht për shkak të funksionit që ky i pandehur ka pasur në kohën kur ka ndodhur fakti penal në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sekretar për aksionin qytetar në Partinë Demokratike, duhet të reflektonte në veprimtarinë e tij kushtetuese parimet themelore kushtetuese e veçanërisht respektimin e Kushtetutës e ligjit, dhe kursesi kjo veprimtari e tij nuk mund të konsiderohet e kryer brenda fushës së ushtrimit të funksionit të tij politik apo të ushtrimit të lirisë së shprehjes, përdërisa sikundër Gjykata ka evidencuar me lart jurisprudencën e Gj.E.D.Nj-se në trajtimin e nenit 10 të Konventës, një veprimtari e tillë duke bashkëorganizuar me të pandehurit e tjerë për të krijuar një provë të rreme, një audiopergjim të sajuar, si themeli i një deklarin e kallëzimi publik mediatisht për kryerjen e një krimi të rëndë, për interesa politikë me qëllim iniciimin e ndjekjes penale e diskreditim të personalitetit të shtetasit Geron (Agron) Xhafaj dhe cenim të reputacionit e imazhit të vëllait të tij, ish-ministrit të Brendshëm të kohës kur ka ndodhur fakti, cenon të drejtat e liritë e individit, pengon dhe mbingarkon veprimtarinë e rregullt e normale të organeve të drejtësisë, si dhe shkakton një impakt negativ tek publiku përcimi mediatisht i provave të sajura dhe deklaratave të tilla disinformuese, ndaj dhe një veprimtari e tillë kriminale është e papranueshme në një shtet të së drejtës dhe si e tillë penalizohet nga K.Penal.

U provuan në gjykim të gjithë elementet cilesues se bashkëpunim të të pandehurit Ervin Salianji me bashkëpandehurit e tjerë në këte aktivitet kriminal që janë: pluraliteti i personave (kater), realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij material (kallëzimi i rreme që perben faktin penal është eazuara në teresinë e tij në të dy formata, atë të sajimit të një prove të rreme që është audiopergjimi dhe të adresimit mediatisht e publikisht të një kallëzimi të rreme që në themel ka një prove të rreme), seicili ka një kontribut relevant të qendrueshëm dhe deciziv në ardhjen e pasojës (motivet e ndryshme, dënjia, komunikimet telefonike, instruksionet e mundshme për realizimin e audiopergjimit të rreme, ndihma për të gjetur mjetin e pergjimit, venia në dispozicion e një gazetari, administrimi i proves se rreme, shfaqja e saj mediatisht dhe adresimi qëllimisht për të iniciuar procedim penal ndaj shtetasit Geron (Agron) Xhafaj, si dhe dënjia e vullnetit i manifestuar dukshëm i seicilit prej bashkëpunoretoreve për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin në kryerjen e faktit kriminal është evidente dhe e qarte në analizen e faktit penal si me sipër është shtjelluar.

Subjekt i kryerjes se kësaj veprës penale është i pandehuri Ervin Salianji, I cili, nga hetimi gjyqësor rezultoi të jete i përgjegjshëm para ligjit penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Në sintezë të sa më sipër, pas shqyrtimit të akteve provuese Gjykata konkludoi se i pandehuri Ervin Salianji ngarkohet me përgjegjësi penale dhe duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të "Kallëzimit të rremë të kryer në bashkëpunim", të parashikuar nga nenet 305 e 25 të Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Ervin Salianji, Gjykata bazuar në nenet 47, 49,50. të K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që i atribuohet të pandehurit përbën një krim dhe si e tillë paraqet rrezikshmëri shoqërore, rrezikshmërinë e të pandehurit, i cili rezulton i padënuar më parë por fakti që kjo veprë penale është kryer në bashkëpunim dhe që e pare lidhur edhe me funksionin e tij kushtetues si deputet i Kuvendit të Shqipërisë në kohën kur ka ndodhur fakti penal, që e lehtësoje arrijtjen e rezultati kriminal janë tregues i rrezikshmërie se tij, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprave penale (dashje direkte), moshën dhe nivelin arsimor të tij, motivin për interesa politike që e ka shtyrë në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal, si dhe rolin e tij në kryerjen e veprës penale si bashkeorganizator.

Gjykata vlerëson se për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të marrëdhënieve juridike të cenuara nga kjo veprë penale (veprimtaria e rregullt e organeve të drejtësisë dhe të drejtat e liritë e njeriut), si dhe faktit që i pandehuri e ka kryer këtë veprë nisur nga motive të dobta (politike), duke bërë që të eazuohen në kohë, në vëmendje dhe në veprime procedurale të panevojshme shërbimet e Policisë Gjyqësore e të organeve proceduese, lloji i dënimit me burgim i kërkuar nga organi i akuzës për t'u caktuar ndaj të pandehurit për akuzën e atribuar, është ligjërisht i bazuar në dispozitën përkatëse penale.

Gjithësesi, në një vlerësim të hollesishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, Gjykata e gjen të pabazuar ligjërisht kerkesenë një prej përfaqësuesve të akuzës për të aplikuar nenin 59 të K.Penal ndaj të pandehurit.

Gjykata për sa u argumentua, në rastin objekt shqyrtimi çmon që dënia dhe vuajtja fizikisht e sanksionit penal me burgim prej të pandehurit Ervin Salianji, në masën e dënimit të vlerësuar nga Gjykata në dispozitiv të këtij vendimi gjyqësor, i përgjigjet rëndësisë së faktit, veprës penale të kryer nga i pandehuri, si edhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, që të çmurojë në kompleksitet justifikojnë ligjërisht këtë masë dënimi dhe realizimin e qëllimit kompleks të dënimit penal lidhur me riedukimin dhe ndëshkimin e të pandehurit, por edhe qëllimin e parandalimit të përgjithshëm në shoqëri të kryerjes se kategorise se ketyre veprave penale që cenojnë e drejtat dhe liritë e individit dhe devijojnë veprimtarinë e organeve proceduese të drejtësisë për të luftuar kiminalitetin real dhe ekzistues, në vend të atij virtual e të sajuar.

Lidhur me provat materiale të sekuestruara e të pasqyruara në Procesverbalet përkatëse të sekuestrimit të sendeve të ndodhura në fashikullin hetimor (konkretisht: një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637, një aparat telefonik celular i markës "Samsung" me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091, Gjykata në mbështetje të nenit 190/1(ç) të K.Pr.Penale urdheron t'i kthehen pronarit të ligjshëm të pandehurit Fredi Alizoti.

Persa i perket percaktimit të llojit të sigurise të Institucionit të ekzekutimit të dënimit penal dhe konkretisht vendit të vuajtjes se dënimit penal me burgim për të pandehurit Albert Veliu, Fredi Alizoti dhe Ervin Salianji, në referim të dispozitave të Ligjit 8328 dt.16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim dhe të paraburgosurve" të ndryshuar, Gjykata çmon që vuajtja e dënimit penal me burgim nga tre të pandehurit të kryhet në një burg të sigurise se zakonshme.

Së fundi, persa i perket detyrimit ligjor për pagimin e shpenzimeve procedurale hetimore e ato gjyqësore të parapaguara nga shteti, në referim të neneve 392, 393 të K.Pr.Penale, këto të fundit i ngarkohen solidarisht të pandehurve.

PËR KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 297, 305, 25, 47, 49,63 të K.Penal dhe në nenet 379,383 dhe 384 të K.Pr.Penale,

VENDOSI:

1.Të deklaroje fajtor të pandehurin **Albert Veliu** për veprën penale “**Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror**”, dhe në bazë të nenit **297** të Kodit Penal, e dënon me **10(dhjetë) muaj burgim**.

-Të deklaroje fajtor të pandehurin **Albert Veliu** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** të Kodit Penal, e dënon me **2(dy) vjet e 10(dhjetë) muaj burgim**.

-Ne aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të denimeve, denimin e të pandehurit **Albert Veliu** me **3 (tre) vjet e 5 (pese) muaj burgim**.

-Afati i vuajtjes së dënimit për të pandehurin **Albert Veliu** fillon nga dita e kapjes së tij pasi ky vendim të marr formë të prere.

-Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Albert Veliu**, do kryhet në një nga burgjet e sigurisë së zakonshme.

2. Të deklaroje fajtor të pandehurin **Fredi Alizoti** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** të Kodit Penal, e dënon me **2(dy) vjet burgim**.

-Afati i vuajtjes së dënimit për të pandehurin **Fredi Alizoti** fillon nga data e masës shtrënguese personale “Arrest në burg”.

-Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Fredi Alizoti**, do kryhet në një nga burgjet e sigurisë së zakonshme.

3.Të deklaroje fajtor të pandehurin **Jetmir Oldashi** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** të Kodit Penal, e dënon me **6(gjashhtë) muaj burgim**.

-Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal, të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin e të pandehurit **Jetmir Oldashi** për të kryer **100(njeqind)** orë pune në interes publik.

-Detyrohet i pandehuri të mbaje kontakte me Zyren e Sherbimit të Proves të vendbanimit të tij.

-Heqjen e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe në vendimin **Nr.2103 Regj.Them datë 12.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tirane**.

4.Të deklaroje fajtor të pandehurin **Ervin Saliانji** për veprën penale “**Kallzimi i rremë**”, kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit **305 e 25** të K.Penal,e dënon me **1(një) vit burgim**.

-Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Ervin Saliانji**, fillon nga dita që ky vendim merr formë të prere.

-Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Ervin Saliانji**, do kryhet në një nga burgjet e sigurisë së zakonshme.

-**Provat materiale** të sekuestruar bazuar në nenin 190, pika 1, gërma “ç”, të K.Pr.Penale, konkretisht :
1.Një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 356456094429945, kartë SIM 0685579637

2.Një aparat telefonik celular i markës “Samsung” me nr.IMEI 35504904136882, kartë SIM 0676494091, t’i kthehen të pandehurit **Fredi Alizoti**.

-Shpenzimet procedurale të fazës së hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore, janë në ngarkim të të pandehurve në mënyrë solidarë.

-Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palet brënda 15(pesëmbëdhjetë) diteve në Gjykatën e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes së këtij vendimi. Një kopje e këtij vendimi t’i komunikohet përfaqësuesve të viktimes.

U shpall në Tirane, sot më datë 18.12.2019.

SEKRETARE
Ornela BALLA

GJYQTAR
Artan GJERMËNI